

Muham-med Mutevel-li Esh-sha' ravi

SHEJTANI DHE NJERIU



Prishtinë,
2008

Muhamed Mutevel-li Esh-sha' ravi

SHEJTANI
DHE
NJERIU

Prishtinë
2008

Muhamed Mutevel-li Esh-sha'ravi
SHEJTANI DHE NJERIU

Biblioteka Islame:
Nga veprat e Sharaviut

Titulli i origjinalit:
“Esh-shejtan vel-insan”

Botuar nga: Mues-setu Ahbar El-jevni

Botimi i parë në shqip më 1994

E shqipëruan: *Arif Emini dhe Burhan Hashani*

Recensent: *Bahri Simnica*

Lektor: *Hysen Kadriu*

Korrektor: *Arif Emini*

Përpunimi kompjuterik: *Pleurat Vokshi*

Botues: *Arif Emini*

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Në emër të Allahut, Bamirësit të Përgjithshëm, Mëshiruesit

Falënderimi qoftë Allahut, e bekimi dhe përshëndetjet i qofshin zotëriut tonë të Dërguarit të Allahut!

Lus Allahun, që këta libra, të cilët do të betohen nga biblioteka ime, të jenë një hap në rrugë të udhëzimit dhe dritë që ndriçon rrugën e besimit!

Lusim Allahun që të na udhëzojë në rrugë të drejtë dhe shtigjeve të sukseseve!

Muhamed Mutevel-li Esh-sha'ravi

MENDIMI I RECENSENTIT

Pas shembjes së komunizmit të rinjtë tanë kanë zënë me të madhe t'i kthehen fesë. Ndaj shtrohet nevoja për botimin e sa më shumë titujve me tematikë fetare islame, në mënyrë që të plotësohet boshllëku i madh që kishte mbretëruar për këtë literaturë në gjuhën shqipe një kohë të gjatë.

Libri “Shejtani dhe Njeriu” i shkruar nga mendimtari i shquar mysliman Muhamed Mutevel-li Esh-sha’ravi, të cilin e përkthyen në gjuhën shqipe Arif Emini dhe Burhan Hashani, e plotësoi në një mënyrë atë boshllëk të madh në lëmin e apologjetikës islame.

Ky libër trajton zanafillën e mëkatit, prek çdo pore të jetës dhe në të ngërthehen probleme të kësaj tematike.

Në të ardhmen shtrohet domosdoshmëri që të rinjtë tanë, e jo vetëm ata, të kenë sa më shumë kësi tituj të botuar që nga leximi i tyre t'i thellojnë njohuritë e veta për Fenë Islame në përgjithësi.

Lus Allahun xh.sh. që t'i shpërblejë përkthyesit për mundin që kanë bërë, se padyshim Allahu është Ai që shpërblen robin e Vet, e posaçërisht atë që e qet në dritë fjalën e Tij.

*Prishtinë, 27.3.1994
Bahri Simnica*

Kapitulli i parë

KUSH ËSHTË SHEJTANI

Kjo është pyetje, e cila na sillet prore ndër mend ... pa gjetur ndonjë përgjigje. Djalli është çështje sekrete për ne. Ai na sheh, e ne nuk e shohim atë...

Ai na pëshpërit në vesh, e në shpirtra tonë krijon vese pa e ditur se ku gjendet ai... as s'e dimë se çaka bën. Ndaj shtrohet pyetja: *"Kush është shejtani?"*

Allahu xh.xh. nga mëshira e që pati ndaj nesh, na mësoi se kush është djalli dhe si lindi armiqësia e tij ndaj njeriut, si filloi ajo, si orvatemi ta mposhtim atë dhe çdo fuqi tjetër të fshehtë apo të hapët që ekziston.

Allahu i madhëruar na udhëzon se si të mbrohemi nga ai, ngase Allahu i Plotfuqishëm është Mbizotërues për të gjitha krijesat e Tij... qofshin besimtarë apo jobesimtarë, respektues apo rebelë, të lirë në kryerjen e veprave apo të detyruar për të zbatuar urdhrin... Që të gjitha këta i nënshtrohen ligjit të Allahut të madhëruar. S'ka krijesë në gjithësi që mund të dalë jashtë vullnetit të Tij, s'ka Krijesë-gjë që del jashtë ligjit të Tij. Shi për këtë Allahu thotë:

{18} وَهُوَ الْقَاهِرُ فَوْقَ عِبَادِهِ وَهُوَ الْحَكِيمُ الْخَبِيرُ

"Ai është Mbizotërues ndaj robërve të Tij. Ai është i urtë dhe i Gjithëdijshëm."

(S.El-En'am: 18)

Pra në këtë gjithësi asgjë nuk mund të dalë jashtë synimit të vërtetë të Allahut të madhëruar, por nga ai dalin vetëm ata, të cilëve u është dhënë liria në zbatimin e ligjit të Allahut apo programit Tij, për të kryer apo mos kryer vepra të caktuara... Ata dalin nga ky program në saje të lirisë që atyre ua dhuroi Allahu i madhëruar, ngase Allahu është Ai që i krijoi ata, të cilët janë në gjendje për të kryer urdhrat e Tij apo me vullnetin e tyre për të mos kryer ato.

Po të kishte dashur Allahu, do të krijonte ata të detyruar për të zbatuar urdhra. Lidhur me këtë çështje Allahu i madhëruar thotë:

لَعَلَّكَ بَاخِعٌ نَفْسَكَ أَلَّا يَكُونُوا مُؤْمِنِينَ {3} إِنْ تَشَأْ نُزِّلْ عَلَيْهِمْ
مِنَ السَّمَاءِ آيَةً فَظَلَّتْ أَعْنَاقُهُمْ لَهَا خَاضِعِينَ {4}

“A do të shkatërrosh veten pse ata nuk besojnë. Po të dëshironim Ne do të dërgonim nga qielli një shenjë nën të cilën qafat e tyre do të përkuleshin me përulje.”

(Esh-shuara: 3-4)

Ky ajet kur'anor është këshillë për Muhamedin a.s., shpirti i të cilit shqetësohej se disa njerëz nuk besonin. Kjo për të ishte dëshpërim dhe brengë, ngase ai e dinte se çfarë dënimi i përhershëm do t'i presë ata në botën e ardhshme. Pasi ai ishte mëshirë për mbarë njerëzimin, dëshironte që ti shpëtonte nga ai dënim që i pret në botën e ardhshme.

Allahu i madhëruar na njofton këtu se njerëzit e tillë edhe nëse nuk e përfillin këtë ligj të caktuar të Allahut, të cilin Ai kërkoi nga ata t'i besojnë dhe ta zbatojnë, prapë ata njerëz nuk mund të dalin nga pikësynimi i Tij i caktuar. Ngase Allahu xh.sh. po të dëshironte, do t'i detyronte njerëzit (krijesat) që të besojnë...Mirëpo Allahu deshi që ata të jenë të lirë (në besim), të besojnë apo të mos besojnë. Të jenë përfillës (të udhëzimeve të Tij) apo mospërfillës... Ai atyre u dha liri të zbatojnë apo të mos zbatojnë ligjin e Tij. Kjo liri veprimi e njerëzve buron nga vullneti i Allahut xh.sh., se po të mos ishte ky vullnet i Allahut ata nuk do të ishin të lirë të zbatojnë apo mos zbatojnë ligjin e Tij. Prandaj, nuk ka asgjë në këtë gjithësi që mund të dalë nga vullneti i Allahut xh.sh.

PËRSHKRIMI I SHEJTANIT

Para se të fillojmë përshkrimin e shejtanit, patjetër duhet të bëjmë dallimin në mes cilësive të tije dhe të vet qenies së tij, se shejtani në përshkrimin e përgjithshëm, është ai i cili i largon njerëzit nga rruga e Allahut, i mashtron dhe i shtyn njerëzit të bëjnë vepra të këqija.

Çdo njeri që i ka këto cilësi është shejtan?

Duhet të dimë se ekzistojnë djaj nga xhindët dhe nga njerëzit, të cilët e kanë një përshkrim dhe që kanë një qëllim të përbashkët e të vetëm, e ai është përhapja e mëkatit dhe mbjellja e shkatërrimeve në rruzullin tokësor. Djajtë nga xhindët janë ata mëkatarë, që njeriun e largojnë nga e vërteta dhe e fusin në pabesim. Edhe djajtë nga radha e njerëzve e kryejnë po të njëjtën vepër. Megjithatë, këtu është fjala për përshkrimin e një cilësie të caktuar, e jo për ndonjë person të caktuar. Çdo njeri që thërret në mosbesim (kufër), në politeizëm (shirk) dhe në moskryerjen e urdhrave të Allahut, ai quhet “*shejtan*”.

Ndërsa Iblisi është djall nga “xhindët”, i cili ishte në një gradë të lartë, e supozohet se ai jetonte së bashku me melekët. Ky Iblis është njëri ndër krijesat e Allahut, i cili dallohet nga melekët, pasi që Allahu e la të lirë këtë. Mu për këtë ai nuk guxon ta thyejë urdhrin decidiv të Allahut, anipse Ai ia dhuroi lirinë.

Mirëpo, me lirinë që gëzonte, ai u bë i padëgjueshëm ndaj respektit të Allahut xh.sh. Andaj, veprimi i Iblisit ishte mosrespektim ndaj Allahut, e jo rebelim ndaj urdhrit decidiv të Tij. Sjellja e Iblisit ishte mosrespektim i dëshirës së Allahut të madhëruar, i cili me vullnetin e Vet deshi që Iblisin ta krijojë të lirë, që ai ta zgjedhë të mirën apo të keqen.

Nga ky vullnet-dëshirë doli Iblisi... por nga ky del çdonjëri që nuk respekton Allahun...

Në patjetër duhet të ndalemi ta shtjellojmë këtë çështje, para se të fillojmë shpjegimin e njeriut dhe të djallit, për t’i kuptuar më mirë disa gjëra.

Nuk ka asgjë në këtë gjithësi që mund të thyejë ligjin e Allahut xh.sh. Megjithatë, Allahu ka krijuar krijesat të detyruara për të adhuruar Atë, psh. melekët (engjëjt) . Por Allahu ka krijuar edhe krijesat të tilla, të cilat janë të lira në kryerjen e veprave, siç janë njerëzit dhe xhindët. Allahu, nga vullneti i Vet që pati, krijoi krijesat,

të cilat janë në gjendje të përfillin urdhrin e Tij apo mos ta përfillin atë... Mbi këtë bazë lindi mëkati.

Prandaj rreth mëkatisë u zhvillua një dialog i gjatë. Disa nga radhët e ateistëve dhe të tjerëve thonë se si të merret Iblisi në përgjegjësi pasi ai refuzoi t'u përkulet (bie në sexhde) krijesave të Allahut?

Atyre që thonë fjalë të tilla nga radha e ateistëve dhe të tjerëve u themi:

*“Ju nuk kuptoni ç’është **ibadeti** (adhurimi). Adhurimi është që krijesa të kryejë urdhrin e Krijuesit. Për atë, kur Allahu i madhëruar na urdhëron të falim 5 kohët e namazit gjatë ditës, ky namaz është **ibadet** dhe kryerje-zbatim i urdhrin të Tij. Gjithashu edhe zekati, agjërimi, haxhi dhe çdo gjë që Allahu e ka urdhëruar është adhurim apo përfillje e urdhrin të Tij. Ndërsa mosdëgjimi dhe mospërfillja e urdhrave të Allahut është mëkat.”*

Pasi që Allahu xh.sh. na e bën obligim namazin, ne nuk e kundërshtojmë urdhrin e Tij, por atë e zbatojmë. Ne nuk themi, p.sh. pse t'i falim 5 rekate, e të mos i falim 4,3 apo 2. Ne assesi nuk thyejmë; urdhrin e Allahut, anipse ne nuk e dimë vlerën-domethënien e tij, madje as shkakun e (zbritjes së) tij... ngase ai është urdhër i Allahut xh.sh.

Detyrë e jona është që të bindemi se çdo urdhër është nga Allahu, e shkakun i zbatimit të këtij urdhri qëndron në atë se Allahu është Ai që e ka dhënë këtë urdhër.

Pas këtyre fjalëve që u përmenden këtu nuk ka vend diskutimi. Detyrë e mendjes së njeriut është që të argumentojë se kjo gjithësi ka Krijuesin dhe Shpikësin e saj, e Ai është edhe krijues i yni. Ai kësaj gjithësie i hartoi një program të përpiktë dhe të përsosur.

Gjithësi kjo, e cila ka natyrë të mrekullueshme dhe nuk mund të ekzistojë pa Krijuesin Fuqiplotë.

Nëse arrijmë ta kuptojmë këtë çështje, atëherë veç kemi arritur të pikënisja e imanit(besimit).. E kur mendje e njeriut arrin në këtë shkallë, atëherë ajo nuk mund ta tejkalojë kufirin e saj (të njohjes) e të arrijë ta njohë, p.sh., këtë Krijues madhështor... ngase mendja e njeriut mundësitë njohëse i ka të kufizuara... A thua si quhet Ai? Çka kërkon Ai nga ne dhe përse na ka krijuar?

Pas kësaj që u përmend vjen në shprehje roli i të Dërguarve për të plotësuar çdo gjë... Allahu xh.sh. dërgoi të Dërguarin, të cilit ia dhuroi muxhizen (mrekullinë), e cila tejkalon ligjin e kësaj natyre. Ky i

Dërguar ua transmeton (bën me dije) njerëzve se Allahu është Ai, i cili krijoi këtë gjithësi.

E tërë kjo që e rrethon njeriun, e ndër to edhe qiejt, dielli, yjet, detet, të cilat ia tejkalojnë njeriut me fuqi me milionë herë, të gjitha janë të krijuara për shërbim të njeriut. Për shembull, dielli lind çdo mëngjes dhe nuk mund ta shkelë atë lig, e as nuk mund të thotë se nuk dua të dal,e as nuk mund të thotë: “*nuk dua të perëndoj*”.

Ndërsa oqeanet avullojnë ujin nga i cili avull zbret shiu. Ata asnjëherë nuk thyejnë ligjin e tyre duke thënë duke thënë se nuk do të avullohen, e as nuk mund ta ndalin avullimin e ujërave nga i cili avullimi, siç cekëm më lartë, bie shiu në tokë.

Pra detyrë e të dërguarve është të na mësojnë se Allahu tërë këtë ekzistencë e ka krijuar dhe e ka vënë në shërbim tonin.

Ndaj të gjithë e dimë se ato mrekullitë janë mbi forcën e njeriut çfarëdo njeriu qoftë. Ata i demonstrojnë mrekullitë gjersa të binden njerëzit se ata janë të dërguar nga Allahu,e të mos dalë një mashtrues ose djall të paraqitet si i Dërguar, për t’i larguar njerëzit nga rruga e vërtetë. Kur të mësojmë se çka kërkon prej nesh Allahu i madhëruar, ne duhet t’i kryejmë urdhrat Tij me përkushtim. Këta urdhra duhet kryer në mënyrë të tillë për shkak se ato i ka dhënë Zoti. Ai për këtë di çdo gjë, kurse ne nuk dimë. Në saje të urtisë që ka, Ai di çka i duhet kësaj Gjithësie. Ndërsa ne nga mosdija jonë bëjmë ndonjë të keqe duke menduar se është vepër mirë. Duke marr parasysh se Allahu i posedon të gjitha cilësitë e larta adhurimi ndaj Tij është i domosdoshëm.

Andaj, kur njeriu hyn në dialog me ndonjë njeri, lypset që në radhë të parë ta zhvillojë dialogun me atë person, i cili është në nivel të njëjtë të dijes së tij. P.sh. mjeku zhvillon dialog me mjekun, inxhinieri me inxhinierin, e të mos bëhet kundërta, që mjeku të zhvillojë dialog me latuesin apo me salduesin. Për këtë arsye kur të zhvillohet një dialog, ai duhet të jetë parimor dhe të zhvillohet mes dy personave të nivelit të njëjtë. Shtrohet pyetja: ” Kush prej nesh është i nivelit të Allahut në njohuri, fuqi apo në ndonjë shkencë që të mund të zhvillojë me Të dialog për ndonjë urdher që e ka dhënë apo ndonjë ndalesë-vepër që e ka ndaluar?! Allahu në Kur’an ka thënë:

وَمَا كَانَ لِمُؤْمِنٍ وَلَا مُؤْمِنَةٍ إِذَا قَضَى اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَمْرًا أَنْ يَكُونَ لَهُمُ الْخِيَرَةُ مِنْ أَمْرِهِمْ وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ ضَلَّ ضَلَالًا مُّبِينًا
{36}

“Kur Allahu dhe Profeti i Tij ka vendosur për një çështje, nuk i takon besimtarit as besimtares që të sillen sipas mënyrës së tyre”

(S.El-Ahzab: 36)

Pastaj, lexo më tutje fjalën e Allahut të madhëruar:

أَمَّنَ الرَّسُولُ بِمَا أُنزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ آمَنَ بِاللَّهِ
وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ

وَرُسُلِهِ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْ رُسُلِهِ وَقَالُوا سَمِعْنَا

وَأَطَعْنَا غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ {285}

“I dërguari besoi në atë që iu shpallë prej Zotit të tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i beson Allahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të Dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit të Tij dhe themi: I përgjigjemi thirrjes dhe respektuam (urdhrin), kërkojmë faljen Tënde, o Zot yni. Vetëm Ti është ardhmëria jonë.”

(S.El-Bekare 285)

ZANAFILLA E MËKATIT

Siç kemi cekur më parë “*ibadeti*” (adhurimi) manifestohet atëherë kur njeriu kryen urdhrat e Allahut të madhëruar, e mospërfillja e urdhrave të Tij është mëkat dhe largim nga rruga e drejtë. Kjo rrugë e gabuar njeriun e shpie gjer në mosbesim, ruana Zot! Nga kjo kuptojmë se mund të vëmë në pah se ibadeti (adhurimi) manifestohet atëherë kur krijesa i zbaton urdhrat e Krijuesit të saj. Ndërkaq Iblisi, për të cilin është fjala, theu urdhrin e Allahut, ky veprim i tij nuk është adhurim, por mëkat dhe mosbesim (kufër).

Allahu na njofton në Kur’anin fisnik për zanafillën e mëkatit të Iblisit:

وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا

لَادَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ أَبَى وَاسْتَكْبَرَ وَكَانَ مِنَ الْكَافِرِينَ

“Kur u thamë engjëjve: përluni Ademit, të gjitha melaqet i bën sexhde pos Iblisit, i cili refuzoi t’i bëjë, iu rrit mendja dhe u bë pabesimtar”.

(S.El-Bekare 34)

Ky ishte fillimi i mëkatit të Iblisit. Kështu ai refuzoi që ta kryejë urdhrin e Allahut xh.sh. Ai refuzoi t’i përkulet Ademit. Ky refuzim i tij nuk kishte të bëjë aq me përkuljen (rënien në sexhde) Ademit, si krijesë e Allahut, por ishte refuzim i urdhrin të Allahut me të cilin ishte urdhëruar. Këtu edhe qëndron dallimi, sepse moskryerja e urdhrin të Allahut është mëkat dhe mosbesim (kufër).

Disa veta pohojnë se ky urdhër u ishte dhënë vetëm melaqeve, e jo Iblisit, ndaj ata shtojnë.

“Si mundi Allahu ta marrë në përgjigje Iblisin për moszbatimin e një urdhri me të cilin nuk e ka urdhëruar?”

Ne në këtë pyetje përgjigjemi kështu: Edhe pse Iblisi ishte nga xhindët, ai refuzoi urdhrin e Allahut. Për këtë Allahu i madhëruar na njofton:

فَسَجِدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ كَانَ مِنَ الْجِنِّ فَفَسَقَ عَنْ أَمْرِ رَبِّهِ

“Ata i bënë sexhde pos Iblisit. Ai ishte nga xhindët, andaj edhe bëri mëkat ndaj urdhrin të Zotit të vet”.

(S. El-Kehf: 50)

Kur Allahu i drejtohet Iblisit i thotë:

قَالَ مَا مَنَعَكَ أَلَّا تَسْجُدَ إِذْ أَمَرْتُكَ قَالَ أَنَا خَيْرٌ مِنْهُ خَلَقْتَنِي مِنْ نَارٍ وَخَلَقْتَهُ مِنْ طِينٍ {12}

(Allahu) tha: Çka të pengoi ty që nuk iu përule, kur të urdhërova? (Iblisi) tha: unë jam më i vlefshëm se ai, mua më krijove nga zjarri e atë nga balta”.

(S. El-A’raf: 12)

Allahu i tha:

يَا إِبْلِيسُ مَا مَنَعَكَ أَنْ تَسْجُدَ لِمَا خَلَقْتُ بِإِيْدِي أَسْتَكْبَرْتَ أَمْ كُنْتَ مِنَ الْعَالِينَ {75}

“O Iblis! Ç’të pengoi të mos bësh sexhde para atij që kam krijuar me duart e Mia (pa ndihmën e askujt), a mos të është rritur mendja apo mbahesh se je nga më të lartit?”

(S. Sad: 75)

Me këto ajete kur'anore vihet në dukje se edhe Iblisi ishte i urdhëruar për të bërë sexhde dhe një urdhër i tillë ehe për të vlente. Për këtë çështje s'ka vend diskutimi. Pra, nuk mund të thuhet: si të merret në përgjegjësi Iblisi për një urdhër, i cili nuk e përfshiu atë.

E VËRTETA MBI IBLISIN

Pas tërë asaj që u cek më lart po fillojmë të shtjellojmë temën “kush është Iblisi”. Ai ishte nga xhindët e jo nga melaqet, sepse melaqet nuk thyejnë urdhrin e Zotit, ndërsa xhindët janë plotësisht të lirë në vepra ashtu siç është edhe vet njeriu.

Disa dijetarë, krijesat të cilat kanë lirinë për kryerjen e veprave të tyre i ndajnë në tri grupe:

1. Shejtanët,
2. Xhindët dhe
3. Njerëzit

Mirëpo, ne u themi atyre se kjo ndarje nuk është e qëlluar, sepse personat të cilët janë të lirë në veprat e tyre janë në dy grupe: Këtë e vërteton ajeti kur'anor:

{31} سَنَفْرُغُ لَكُمْ أَيُّهَا النَّاقِلَانِ

“Së shpejti, o ju njerëz dhe xhindë, ne do të merremi me llogarinë tuaj”

(S. Er-rahman: 31)

Dhe në suren El-xhinn Allahu i madhëruar thotë:

وَأَنَا مِنَ الْمُسْلِمُونَ وَمِمَّا الْقَاسِطُونَ فَمَنْ أَسْلَمَ فَأُولَئِكَ

تَحَرَّوْا رَشَدًا {14} وَأَمَّا الْقَاسِطُونَ فَكَانُوا لِجَهَنَّمَ حَطَبًا {15}

“Është e vërtetë se prej nesh ka sish që iu nënshtruan vullnetin tyre (Zotit) dhe asish që janë të padrejtë, e kush pranoi Fenë islame të tillët kanë zgjedhur rrugën e vërtetë, ndërsa ata që lëshuan rrugën do të bëhen lëndë djegëse të xhehenemit”.

(S. El-xhinn: 14,15)

Nga ky ajet vëmë në pah se në radhën e xhindëve, ka të mirë (besimtarë) dhe të prishur (mëkatar-të shturur), e ata të shtururit e xhindëve janë djajtë...

Ndërsa për ata të cilët pohojnë se ekziston grup përveç njerëzve dhe xhindëve, të cilët janë të lirë në vepra të tyre, e një gjë e tillë e pamë në ajetet e sipërpërmendura.

Pra, nga kjo kuptohet se Iblisi është nga xhindët. Ai i bëri mëkat Allahut xh.sh. duke refuzuar që t'i përkulet Ademit. Për këtë Allahu thotë:

“Të gjithë melaqet i bënë sexhde pos Iblisit, që ish nga xhindët dhe refuzoi, andaj bëri mëkat ndaj urdhrit të Zotit të vet”.

Kështu lindi mëkati i Iblisit duke refuzuar urdhrin e Allahut që t'i përkulet (bie në sexhde) Ademit. Por, a thua është kjo thyerje e urdhrit nga ana e Iblisit vetëm gabim i rastit apo gabim për të cilin duhej të pendohej, aapo është refuzim nga mendjemadhësia për shkak xhelozisë që iu shfaq në zemrën tij dhe një mendjemadhësi që ia përshkoi shpirtin?

Ishte ky mëkati i Iblisit i manifestuar nga zilia, mendjemadhësia dhe këmbëngulësia e tij në të. Ai nga mendjemadhësia dhe zilia e tij theu urdhrin e Allahut. Për këtë Allahu i madhëruar në Kur'an thotë:

{ 61 } أَسْجُدْ لِمَنْ خَلَقْتَ طِينًا

“A t'i përulem atij që e krijove nga balta?”

(S. El-Isra: 61)

Ai më tutje thotë:

{ 12 } أَنَا خَيْرٌ مِّنْهُ خَلَقْتَنِي مِن نَّارٍ وَخَلَقْتَهُ مِن طِينٍ

“Unë jam më i vlefshëm se ai, më ke krijuar nga zjarri e atë nga balta.”

(S. El-A'raf: 12)

Në këtë mënyrë Iblisi theu urdhrin e Allahut xh.sh. duke i thënë Allahut “*si dëshiron që t’i përulem një krijese, të cilën e krijoje nga dheu, ndërsa unë jam i krijuar nga zjarri* Me këtë ai dëshiron ta arsyetojë mëkatin dhe largimin nga rruga e drejtë duke menduar se zjarri është i tejdukshëm dhe se krijesa nga zjarri dallohet në shumë gjëra nga krijesa e cila është krijuar nga dheu. Ai, pra, dallohet për nga shpejtësia e tij e lëvizjes dhe nuk shihet. Kjo do të thotë se njeriu nuk i sheh xhindët. Iblisi gjithashtu dallohet se mund të ngritët në lartësi të larta dhe është në gjendje të depërtojë anë e përtej murit dhe mund të hyj në vendet e mbyllura në të cilat njeriu nuk mund të hyjë.

NUK KA PËRPARËSI ELEMENTI NDAJ ELEMENTIT

Në mbështetje të këtyre elementeve, e posaçërisht elementit të zjarrit duke shprehur mendjemadhësinë dhe duke u futur në mosbesim (kufër) Iblisi u “*arsyetua*” se është më i lartë se njeriu. Kësisoj ai shfaqti arrogancën e vet. Ai mendonte se ky element është më i vlefshëm dhe harroi se këto veçori ai nuk i arriti me qenien e vet dhe me forcën e tij, por Allahu është Ai që i vuri këto veçori në materien, nga e cila u krijuan xhindet.

Sikur të mos i kishte krijuar Allahu xh.sh. këto veçori në krijesën e zjarrit, ato nuk do të ekzistonin. Pra, elementi nga i cili u krijua Iblisi nuk është më me vlerë se ai nga i cili u krijua Ademi (a.s.), por merita është e Atij, që krijoi këto veçori. Po të donte Allahu, të gjitha këto veçori, e në veçanti ato të zjarrit, do t’i asgjësonte e Iblisi do ishte krijesa më e poshtëruar.

Kjo ishte shkalla e parë e vetëmashtrimit dhe e mendjemadhësisë së Iblisit, i cili ia atribuoi vetes meritat duke pandehur se ai është i krijuar nga një element më lartë sesa dheu, e ai është zjarri, i cili e goditi edhe Karunin kur tha:

قَالَ إِنَّمَا أُوتِيْتُهُ عَلَىٰ عِلْمٍ عِنْدِي

“Këtë e kam arritur në saj të dijes sime”

(S. Kasas: 78)

Si dënim për të, Allahu ia shafoi teposhtë shtëpinë dhe pasurinë e tij. Siç vë në pah Kur’ani fisnik Iblisi vazhdoi mëkatin e tij, duke mos u penduar fare:

قَالَ فِيمَا أُغْوِيْتِي لِأَقْعُدَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ {16}

“Pasi ti më humbe unë do t’u dal atyre në pritë dhe do t’i pengoj nga rruga Jote e drejtë”.

(S. El-A’raf: 16)

Në këtë ajet kur’anor ne duhet të ndalemi te fjala e Iblisit, cili thotë: “*Fe bi agvejteni...*”-pasi më bëre të jem i humbur, thua se humbja iu shkaktua nga Allahu i madhëruar. Sipas këtij mendimi të Iblisit “*si mund ta dënojë allahu Iblisin gjersa Ai vetë e ka bërë të humbur?*”

Për këtë ne pohojmë se Iblisi është ai, i cili meritoi humbjen me mëkatin që e bëri dhe nuk deshi të pendohet fare. Me këtë veprim në shpirtin tij lindje mendjemadhësia.

Mendoj se ai ishte pajisur me tërë atë që i duhet qoftë nga elementet përbërëse të qenies së tij apo me dijen që posedonte, por ai harroi s e nuk i kishte arritur vetë ato veçori, por ato i kishte krijuar Allahu dhe prej tyre edhe u krijuan xhindët.. Allahu e largoi nga mëshira e Vet dhe e bëri të humbur. Shkaku i këtij dëbimi të tij ishte nga vet shejtani, i cili me zilinë që pati ndaj Ademit (a.s.), njëkohësisht duke thyer urdhrin e Allahut, meritoi që të dënohet, e me këtë gjest të tij, ai u fut në mosbesim (kufër). Për këtë Allahu në Kur’an thotë:

وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ {108}

“Allahu nuk e udhëzon popullin e shfrenuar (të larguar nga rruga e vërtetë)”.

(S. Maide: 108)

dhe ajeti tjetër:

إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْكَافِرِينَ {67}

“Allahu nuk e udhëzon popullin që nuk beson”

(S. Maide: 67)

Me këtë veprim Iblisi u largua nga rruga e drejtë dhe u fut në kufër. Ai ra në kufër për shkak se e theu urdhrin e Zotit kur nuk i ra ne sexhde (nuk iu përkul) Ademit (a.s.).

Në gjuhën arabe fjala “fusuk” ka kuptimin largim nga rruga e vërtetë. P.sh. thuhet është larguar hurma kur është pjekur. Hurma e papjekur është e kuqe. Por kur hurma piqet, lëvozhga e saj fillon të ndahet nga fryti, e atëherë lëvozhga është lehtë të hiqet. Mu për këtë populli thotë “u nda hurma, respektivisht lëvozhga e saj”.

Pra fjala “fusuk” do të thotë largim nga rruga e drejtë. Allahu xh.sh. në Kur’an na njoftoi se Iblisi u largua nga rruga e drejtë dhe u fut në kufër:

فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ كَانَ مِنَ الْجِنِّ فَفَسَقَ عَنْ أَمْرِ رَبِّهِ

“... e ata iu përulën pos Iblisit. Ai ishte nga xhindët, andaj dhe bëri mëkat ndaj urdhrit të Zotit të vet”.

(S. El-Kehf: 50)

Allahu xh.xh. e la Iblisin të lirë, e ai u largua nga e vërteta duke bërë mëkat, me të cilin u fut në kufër...Allahu assesi nuk i bën padrejtësi askujt, por dënimin e sjell vet njeriu.

Kur individ i dëmton veten dhe dëshiron të zgjedhë rrugën e gabuar, Allahu e lë të lirë

atë, gjersa ai e zgjedhë atë rrugë (kufirin). Allahut asgjë nuk i shtohet e as i mungohet, se Allahu nuk ka nevojë për askënd.

RËNIA E IBLISIT NË NGASJE

(Të larguarit e Iblisit nga mëshira e Allahut)

Kur Iblisi e futi veten në ngasje dhe mësoi se u largua nga mëshira e Allahut për shkak të mosbesimit (kufirit) të tij, ai u dënua me ndëshkim të përjetshëm. Ai kërkoi nga Allahu që t’i shtyhet dënimi gjer në Ditën e Gjykimit dhe të mos ia marrë shpirtin e tij gjer atë ditë kur Allahu do t’i fryjë “surit” (t’i tubon shpirtat) siç thotë Kur’ani fisnik.

Ai tha:

قَالَ رَبِّ فَأَنْظِرْنِي إِلَى يَوْمِ يُبْعَثُونَ {79}

“Zoti im, më jep afat deri ditën kur të ngjallen”

(S. Sad: 79)

Këtu vihet re se Iblisi e ka përdorur shprehjen “O Zoti im” (*Rabb*- ar. ushqyes, mbizotërues etj.) e nuk e përdori shprehjen “*Ilahi*” (Zot që e adhuron dhe zbaton urdhrat e Tij). Ai iu drejtua Allahut të madhëruar ngase Ai është Zot i botërave, dmth.Zot i gjithë atyre që i krijoi qofshin besimtarë apo jobesimtarë.

Allahu i ka dy kompetenca, i njohur me emrin “*Rab-bun*” ngase është Zot i të gjithëve (ushqyes, mbikëqyrës). Ai i ka krijuar dhe i ka sjellë të gjithë në ekzistencë. Mu për këtë ai e quan veten “*Rabb*” me të cilin emër i drejtohet ai që beson dhe ai që nuk beson, ruana Zot!

Ky emër përdoret vetëm në këtë botë. Si besimtari ashtu edhe jobesimtari furnizohet (me gjëra të nevojshme). Fuqia e Zotit është shtrirë dhe është prezente në përdorimin e mjeteve për të arritur plleshmërinë e tokës, e ajo jep bereqet si besimtari ashtu edhe jobesimtarit. Çdo njeriu që i përvetëson ato mjeshtri, përdorë mjetet dhe bën punën si duhet i jep bereqet i mjaftueshëm. Ai që punon arën me mjete më të mira, ajo i jep atij rendimente të bollshme qoftë ai punëtor besimtar apo jobesimtar. Ai që synon të përparojë, studion dhe bën kërkime ... atij i jepen mundësitë që të punojë në atë drejtim

Këto mundësi i jepen njeriut vetëm në këtë botë. Ndërkaq kompetenca tjetër është e njohur me emrin “*Ilah*” që nga ky emër foljor rrjedh emri Allah (që meriton të adhurohet), se Ai është Një dhe i pashoq. Me këtë emër meritojnë ta thërrasin Atë besimtarët në këtë botë,e posaçërisht në botën e ardhshme. Kur të marrin fund motivet e botës dhe çdo gjë krijohet drejtpërdrejt nga Allahu xh.sh. për adhuresit e Tij besimtarë, çka t’u bie në mendjet e tyre e gjejnë përpara... pa kurrfarë mjetesh për ekzistencë (si të kësaj bote) pa kurrfarë pune.

Shejtan është çdonjëri që të fton të largohesh nga adhurimi i Allahut, nga logjika e rrugës së vërtetë, të cyt të futesh në mëkat pa marrë parasysh se çfarë lloji është. Iblisi është njëri nga krijesat e Allahut. Ai u largua nga rruga-planprogrami i Allahut në saje të lirisë së veprimit, të cilin ia dhuroi Allahu, me vullnetin e vet të adhuroj-respektojë (urdhrit e Tij) apo ta kundërshtojë. E pasi që ai nuk iu përgjigj urdhrat, të cilin e kishte dhënë Allahu i madhëruar, Iblisi me këtë mëkat që bëri u fut në mosbesim. Më pas ai vazhdoi mëkatin edhe më tej. Ai kërkoi nga Allahu ta presë atë gjer në Ditën e Gjykimit.

Por, athua përse e shtroi Iblisi këtë kërkesë?

Çka i sillej ndërmend atij sa i përket njeriut?

Kapitulli i dytë

MËKATI I SHEJTANIT

Para se ta shtjellojmë temën më armiqësinë e Iblisit ndaj Ademit (njeriut të parë) dhe pasardhësve të tij se si u bënë vesvese dhe i kandis të bëjnë vepra të këqija, duhet patjetër të elaborojmë mëkatin e “Iblisit”, mëkat ai, me të cilin e meritoi mallkimin e Allahut gjer në Ditën e Gjykimit.

Kur Iblisi refuzoi të zbatojë urdhrin e Zotit që t’i p;rulet Ademit, ai nuk tregoi shenj; pendimi apo t’i kthehet – drejtohet Allahut të madhëruar... Ai nuk tha “*O Zoti im, fjalat jote është e drejtë... edhe urdhri Yt është me vend dhe se un nuk munda ta përmbaj veten... e më fal.*”

Ai nuk erdhi në vete e t’i bjerë Allahut në sexhde, por, përkundrazi, mendjemadhësia kishte mbërri në pikë vlimi. Siç citohet në Kur’an, Allahu i madhëruar i tha atij:

قَالَ مَا مَنَعَكَ أَلَّا تَسْجُدَ إِذْ أَمَرْتُكَ قَالَ أَنَا خَيْرٌ مِنْهُ خَلَقْتَنِي مِنْ نَارٍ
وَخَلَقْتَهُ مِنْ طِينٍ {12}

“Çka të pengoi ty që të mos i bësh sexhde atij, kur të urdhërova, Iblisi i tha: Unë jam më i vlefshëm se ai, mua më ke krijuar nga zjarri e atë nga balta.”

(S. Al-A’raf: 12)

Në këtë mënyrë ai theu urdhrin e Allahut të madhëruar thua se Allahu xh.sh atë e ka dalluar (veçuar)kur e krijoi xhindin nga zjarri,e njeriun nga dheu. Kjo mjaftoi që Iblisi të largohet nga mëshira e Allahut dhe të dëbohet nga vendi ku po jetonte me engjëj. Me atë rast Allahu i madhëruar i tha:

قَالَ فَاهْبِطْ مِنْهَا فَمَا يَكُونُ لَكَ أَنْ تَتَكَبَّرَ فِيهَا فَاخْرُجْ إِنَّكَ مِنَ الصَّاغِرِينَ {13}

“Allahu (tha): Zbrit nga ai(xheneti), nuk të takon të sillesh me arrogancë ndaj tij,dil jashtë!Ti vërtetë je nga të poshtëruarit”.

(S.El-A’raf: 13)

Nga fjala e Allahut “*fehbut minha-zbrit*” nga ai do të thotë se Iblisi ka qenë në një pozitë të lartë para se të bënte mëkat,ngase zbritja nuk është gjë tjetër pos degradimit-rënies nga pozita e lartë në atë të ulët.

Disa njerëz me shprehjen degradim-zbritje nënkuptojnë largësinë. Por shprehja “*hubut*” mbase ka kuptim figurativ,ngase njeriu p.sh nëse e ushtron detyrën e kryetarit apo të sunduesit, pastaj shkarkohet nga funksionet e tija, për atë njeri thuhet se ka rënë nga pozita anipse ai jeton në shtëpinë ku jetonte më parë. Kjo do të thotë se ai nuk ka rënë nga lartësia poshtë në aspektin e largësisë,por nga ai i pozitës, pasi që pozita e tij ka qenë e lartë dhe është bërë aso krijese,e cila s’ka kurrfarë vlere.

Fjala “*hubut*” mund të nënkuptojnë vlerën dmth.njeriu beson se një njeri ka vlerë të lartë,e vë re se si nderon veten dhe të tjerët, as thotë gjë tjetër pos të vërtetës,është i madhërishëm. Kur ai njeri papritmas bën ndonjë vepër të pandershme, ai veprim i tillë të shtyn që ai njeri të të dalë prej hatri, pas saj ti as e nderon as e çmon.

Pra, shprehja “*hubut*” assesi nuk ka kuptimin e rënies së një trupi fizik nga lartësia, por kjo fjalë nënkupton rënien nga aspekti i vlerës apo pozitës. Shi për këtë assesi nuk ka të ngjarë që Iblisi të ketë jetuar në xhenet e të jetë larguar nga ai, siç thonë disa komentatorë.

Është e mundur që shprehja “*hubut*” këtu ka kuptimin figurativ sipas të cilës domethënie Iblisi humbi vlerën që e kishte dhe u bë hiçasgjë.

MENDJEMADHËSIA E DJALLIT NDAJ ALLAHUT

Allahu i madhëruar kur i tha Iblisi dil prej atyhit, Ai na e tregoi shkakun e këtij degradimi me fjalën: “Këtu nuk të takon të bëhesh arrogant”.Kjo do të thotë se Iblisin e kishte kapluar mendjemadhësia dhe vetëmashtrimi-xhelozia. Allahu i madhëruar nuk i do mendjemëdhenjtë, se të gjithë ata i kaplon mendjemadhësia dhe mendojnë se ata vetë mund ta realizojnë ndonjë gjë pa fuqinë e Allahut të madhëruar, atëherë si pasojë e tillë ndaj atyre njerëzve do të pasojë zemërimi i Allahut. A thua pse?

Ngase kryerja e veprave në këtë gjithësi mund të arrihet vetëm me ndihmën e Allahut xh.sh Asnjëri nuk posedon fuqi (të njaftueshëm) për të kryer vepra, pos Allahut. Çdo vepër e krijuar (kryer) ka konceptin e kohës, por edhe koncepti i hapësirës duhet ti përshtatet .

Njeriu as mbijeton kohën as e zotëron hapësirën. S’ka njeri që ka fuqi të lëvizë nga një vend në tjetrin pa lejen dhe vullnetin e Allahut, se mbase vdekja mund ta kaplojë atë para se të lëvizë ai, ndoshta e kaplon sëmundja për ta paralizuar fuqinë e tij të Allahut kur s’ka energji as fuqi pa vullnetin e Allahut.

Allahu i madhëruar e largoi Iblisin nga pozita në të cilën ishte ngase ai u bë mendjemadh dhe u mashtrua kur mendoi se posedon fuqi dhe energji të veten. Mu për këtë Allahu i madhëruar thotë:

“ Dil se ti je prej të poshtëruarve”.Kjo do të thotë se nëse ai ka mendjemadhësi,fuqi dhe mëvetësi, atëherë do të qëndronte në pozitë aty ku ishte, por ai s’i ka ato asnjë, ndaj edhe do të largohet i pashtruar.

Ai do të dalë prej saj përkundër vullnetit të vet. Ai nuk mund të hiqet mendjemadh as mund të pohojë se ka fuqi për t’u mbrojtur apo që të mund të thyejë urdhrin e Zotit. Por ai do të dalë i nënçmuar dhe i poshtëruar.

Kur Iblisi kuptoi se mendjemadhësia e cila e kishte kapluar shpirtin e tij ishte e pabazuar dhe në të vërtetë ai nuk vlen asgjë me qenien e tij...

Zemra e tij u mbush përplot mëri ndaj Ademit(a.s)duke qenë i bindur se Ademi ishte shkaktar për tërë atë që i ndodhi atij: largimi i tij nga mëshira e Zotit xh.sh.,dhe hidhërimi i Zotit ndaj tij.

Mllefi i cili e ndrydhte zemrën-shpirtin e Iblisit, atë e shtyri që të hakmerret ndaj Ademit (a.s.) dhe pasardhësve të tij. Iblisi tentonte që t'i hakmerret Ademit a.s. mu ashtu siç u hodh në zjarr për shkak të mospërfilljes së urdhrit të Allahut xh.sh. ai dëshiron që edhe Ademi dhe pasardhësit e tij të hidhen në zjarr në shenjë hakmarrjeje për atë që i ndodhi më parë.

Pasi Iblisi u largua nga mëshira e Allahut, për atë ai dëshiron që Ademi (a.s.) dhe pasardhësit e tij gjithashtu të largohet nga mëshira e Allahut. Ai dëshiroi t'i hakmerret Ademit, pasi mendon se Ademi ishte shkaktar i tërë asaj që ndodhi, si mallkimi, largimi i tij nga mëshira, dhe çdonjërit që ndjek rrugën e tij. Ai nuk dëshiron të hyjë në zjarr vetëm, por dëshiron të grumbullojë sa më shumë ithtarë nga njerëzit, të cilët t'i mashtrojnë.

Prandaj, pasi u largua Iblisi i poshtëruar dhe i nënçmuar nga pozita në të cilin ishte, drejtua Allahut xh.sh. me këto fjalë:

قَالَ فَأَنْظِرْنِي إِلَى يَوْمِ يُبْعَثُونَ {14}

“Më jep afat gjer në ditën kur të ngjallen “

(S.El-A'raf: 14)

Iblisi në këtë mënyrë iu nënshtua Allahut duke kërkuar nga Ai që të lërë të gjallë deri në Ditën e Gjykimit. Mendjemadhësia e kishte kapluar atë. E sikur kjo mendjemadhësia e tij të ishte e bazuar e jo e pabazuar (e rreme) e të kishte pasur forcë të veten, ai nuk do të kërkonte nga Allahu që ta lërë të gjallë gjer në Ditën e Gjykimit.

Sikur të kishte forcë të veten një gjë të tillë ai do ta bënte vetë (duke e lënë veten të gjallë-të lirë në mashtrimin e njerëzve deri në ringjallje). Por ai nuk pati energji as forcë, pos asaj që ia dha Zoti. Ai iu drejtua Allahut të madhëruar që ta lërë të gjallë gjer në Ditën e Gjykimit.

Por a thua pse iu përgjigj Allahu i madhëruar lutjes së Iblisit...

Kur Ai mund ta shkatërronte atë menjëherë?

Për këtë Allahu i madhëruar në Kur'an thotë:

قَالَ فَإِنَّكَ مِنَ الْمُنْظَرِينَ {37} إِلَى يَوْمِ الْوَقْتِ الْمَعْلُومِ {38}

“Ti je prej atyre që ju është shtyrë afati, gjer në ditën e caktuar”.

(El-Hixhër: 37,38)

Allahu iu përgjigj lutjes së Iblisit anipse është larguar nga mëshira e Tij, ngase urtia e krijimit të kësaj bote plotësohet vetëm me këtë, se Allahu i madhëruar këtë botë e ka krijuar si vend sprovimi, ndërsa botën e ardhshme si vend për ndarjen e shpërblimeve. Allahu xh.sh dëshiron që robërit e tij t'i nënshtrohen sprovimit gjatë jetës së kësaj bote dhe të provohet para se të shpërblehet (a dënohet), të jetë dëshmitar i vetes Ditën e Gjykimit për atë që ka bërë. Për këtë, lexo fjalën e Allahut të madhëruar:

أَمْ حَسِبْتُمْ أَنْ تُتَّخَلَّوْا الْجَنَّةَ وَلَمَّا يَعْلَمِ اللَّهُ الَّذِينَ جَاهَدُوا
مِنْكُمْ وَيَعْلَمَ الصَّابِرِينَ { 142 }

“A mos keni menduar ju se do të hyni në xhenet pa e ditur (vërtetuar në praktikë) Allahu se kush prej jush kanë luftuar dhe të cilët prej jush ishin të durueshëm”

(S.El-Imran: 142)

وَلِيُنَبِّئَ اللَّهُ مَا فِي صُدُورِكُمْ وَلِيُمَحَّصَ مَا فِي قُلُوبِكُمْ
وَاللَّهُ عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ { 154 }

“...Që Allahu t’u provojë ç’keni në kraharorët tuaj dhe të pastrojë se ç’keni në zemrat tuaja. Allahu i di të fshehtat e zemrave tuaja”.

(S.El-Imran: 154)

Po të dëshironte Allahu i madhëruar një krijesë të detyruar për zbatimin e urdhrave të Tij, siç janë melaqet, Ai me siguri do të mund ta krijonte. Po të donte Allahu i madhëruar që të gjithë banorët e tokës të zbatojnë planprogramin e Tij dhe që të gjithë të jenë prej atyre që e madhërojnë dhe e adhurojnë Atë, Ai do të mund ta bënte një gjë të tillë

Por Allahu xh.sh. zgjodhi lloje krijesash që ti drejtohen Atij detyrimisht, siç janë melaqet dhe krijesat e tjera. Ndërsa njerëzit dhe xhindët i zgjodhi, për ndryshim nga llojet e tjera të krijesave, që t’i drejtohen Atij me vullnetin e tyre të lirë. Ata. Pra, janë në gjendje të bëjnë mëkate, por ata nuk e bëjnë atë nga dashuria që kanë ndaj Allahut. Ata janë në gjendje edhe të mospërfillin urdhrat e Allahut, por ata i zbatojnë urdhrat e Tij me dëshirë që t’i afrohen Allahut, ngase Ai e do një krijesë që Atij i drejtohet (afrohet) me vullnetin e saj të lirë, në kohën e sprovimit gjatë jetës së njeriut.

Ne do t'i jemi të nënshtruar vullnetit të Allahut të madhëruar ngase kur ndërrojmë jetë edhe vullneti ynë njerëzor përfundon tërësisht. Njeriu nuk do të ketë vullnet të lirë as për trupin e vet për arsye se vullnetin ai e ka pasur vetëm gjatë jetës së kësaj bote.

Ndërkaq, në çastin e vdekjes, jetës në varreza-në mes vdekjes dhe ringjalljes, ditën e kiametit (kataklizmës) askush nuk do të ketë vullnet të lirë. Jobsimtarin do ta fusin në zjarrin e xhehenemit. Ai orvatet të ndalë këmbët e veta të mos ecin, por nuk mundet. Tenton që ta shtyjë zjarrin me dorë, por nuk mundet. Orvatet të ikën që të mos i dalë Allahut përpara dhe t'i ikë dënimit, por nuk arrin dot...Çdo gjë që e ka poseduar në këtë botë nga energjia dhe fuqia ka marrë fund.

KJO BOTË ËSHTË VEND SPROVIMI

Me qëllim që njeriu të vihet në sprovë në jetën e kësaj bote duhet patjetër të ketë gjëra që e kandisin dhe e shpijnë në rrugë të gabuar.

Nga ky këndvështrim Allahu xh.sh. e ka shejtanin në mashtrimin e njerëzve, si pjesë e gjërave kandisësh, të cilave do t'u ekspozohet njeriu gjatë jetës së tij, sprovim ky i Allahut që do ta bëjë në zemrat e besimtarëve se sa e duan Atë, e ai që e do Atë, Ai e mbron nga mashtrimi i shejtanit.

Ai njeri që e do mëkatin dhe kufirin, Zoti na ruajt!, Allahu u jep dorë të lirë djajve që t'i fusin njerëzit sa më shumë në mëkate dhe mosbesim.

Shih ajetin kur'anor

أَلَمْ تَرَ أَنَّا أَرْسَلْنَا الشَّيَاطِينَ عَلَى الْكَافِرِينَ

تَوْرُهُمْ أَزًّا {83} فَلَا تَعْجَلْ عَلَيْهِمْ إِنَّمَا نَعُدُّ لَهُمْ عَدًّا {84}

“A nuk e di ti se Ne i kemi lëshuar djajtë kundër jobsimtarëve e ata i nxisin pa ndërprerë në vepra të këqija. Pra ti mos u ngut kundër tyre! Atyre Ne ua numërojmë ditët e caktuara”.

(S.Mejrem: 83,84)

Kështu Allahu xh.sh. njeriun e bashkon me atë kë e do njeriu.

Nëse ai e do Allahun, ai do të jetë nën mbrojtjen e Allahut. Ai do ta mbrojë nga e keqja, do t'ia largojë djajtë, do ta mbrojë nga sherri i

tyre dhe do t'ia hapë dyert e mirësisë. E, nëse njeriu e do shejtanin, atëherë Zoti e lë njeriun t'u bashkohet djajve, të cilët janë armiq të tij, të cilët e çojnë në mëkate dhe jetën e tij e shpijnë në pakënaqësi të përhershme duke ia shtruar mëkatet. Me në fund, asgjë nuk i mbetet e shejtani ndaj njerëzve është e domosdoshmen mënyrë që Allahu t'i sprovtojë robërit e Vet, në besim të vërtetë dhe të vërë në dukje se çka fshihet në zemrat e tyre.

Për këtë arsye, njeriu në këtë botë duhej patjetër t'i nënshtrohet sprovimit të vërtetë (praktik) e jo vetëm një sprovim teorik, ngase sprovimi teorik është diçka në vete, ndërsa ai praktik diçka tjetër. Njeriu thotë se do të veprojë kështu e kështu, mirëpo kur të vijë momenti për ta kryer veprën mbase atë nuk mund ta kryejë.

Njeriu kur e mori amanetin nga Allahu, ai i premtoi se këtë do ta kryejë me përkushtim të thellë (të madh), mirëpo kur erdhi momenti që atë ta kryejë, njeriun e kandisi dhe e mashtroi jeta e kësaj bote. Kështu ai ndoqi rrugën e shejtanit, harroi premtimin që ia kishte dhënë Allahut dhe harroi urdhrat e Tij.

Prandaj, mos të mendojë askush nga njerëzit se Allahu iu përgjigj lutjes së shejtanit, por Allahu tërë atë program që e kishte përgatitur për njerëz dhe të gjitha sprovat e provimet në jetën e njeriut dëshiroi që t'i jetësojë.

Allahu iu përgjigj shejtanit me një qëllim të caktuar, e jo lutjes së tij me të cilën kërkonte nga Zoti që të jetë i lirë në mashtrimin e njerëzve deri në ringjallje, e njeriut vazhdon gjer në ditën e kiametit (kataklizmës).

Kur Allahu i madhëruar vendosi që Iblisi të mbesë i lirë gjer në ditën e gjykimit, shpirtin e tij prapë e kaploi zilia dhe vuri re se ky ishte rast për t'iu hakmarrë Ademit dhe pasardhësve të tij. E për këtë Allahu xh.sh., siç na mëson Kur'ani fisnik thotë:

قَالَ فِيمَا أُغْوِيْتَنِي لِأَفْعُدَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ { 16 }

“(Iblisi) tha: Pasi Ti më humbe mua, unë do t’u dal atyre në pritë dhe do t’i pengoj nga rruga Jote e drejtë”

(El-A’raf: 16)

Si arriti shejtani të mashtrojë njeriun? Në çfarë mënyre?
Këtë përgjigje njeriu mund ta gjejë kur ta lexojë fjalën e Iblisit drejtuar Zotit:

قَالَ فَبِعَرَّتِكَ لَأُعَوِّبَهُمْ أَجْمَعِينَ {82}

“ Beto hem në madhërinë Tënde-tha ai, kam për t’i shmangur që të gjithë nga rruga e drejtë”.

(S.Sad: 82)

Pra, prej kësaj fjale lexuesi mëson se si arriti shejtani ta mashtrojë njeriun.

Siç le të kuptohet ky ajet kur’anor Iblisi arriti qëllimin e tij me ndihmën e fuqisë së Allahut të madhëruar ngase Allahu është i Plotfuqishëm. Ai nuk ka nevojë për ndihmën e askujt. Kjo do të thotë se Iblisi iu drejtua Allahut duke i thënë O Zot sikur Ti të dëshiroje që ata të jenë përfillës të urdhrave të Tu, unë nuk do të arrija që t’i mashtroj asnjërin nga ta. Por pasi që ti je i Plotfuqishëm ndaj tërë asaj që e krijove dhe se adhurimi i tyre ndaj Teje asgjë nuk shton në sundimin Tënd, edhe mosdëgjimi i tyre ndaj urdhrave të Tu asgjë nuk pakëson. Unë me forcën Tënde do t’i mashtroj që të gjithë, do t’ua hijeshoj atyre mëkatën dhe do t’i pengoj që të gjithë që të mos ndjekin rrugën e vërtetë. E sa u përket rrugëve të gabuara shejtani s’ka nevojë që ata t’i shmangë prej tyre. Për shembull, ai nuk ua zë pritën atyre te vendet ku konsumohet alkooli, as në ato vende ku bëhet amoraliteti.

Personat të cilët i dëshirojnë vendet e tilla janë ushtria e shejtanit dhe nuk kanë nevojë për mashtrimin dhe vesvesen e tij.

TË PENGUARIT E NJERIUT PËR TA FALUR NAMAZIN

Shejtani gjithmonë bën përpjekje për ta penguar njeriun që të mos hyjë në xhami. Ai gjithashtu e pengon atë të hyjë në vendet ku adhurohet Allahu. Orvatet ta mashtrojë njeriun që të mos falë namazin. Kur të thirret ezani për namaz ai përpiket që ta mashtrojë njeriun, çfarëdo mënyre qoftë, që të mos t’i përgjigjet asaj thirrjeje. Ia përkujton ndonjë send-obligim të pakryer në mënyrë që ai të mos shkojë për ta falur namazin. Ia përkujton ndonjë çështje jetësore, i bën

vesvese dhe e frikëson se nëse shkon në xhami për ta falur namazin, ai do ta humbasë rastin të zhvillojë tregti, do të humbasë pasuri apo ndonjë të mirë duke i thënë atij se edhe puna është namaz. E me këtë ai mundohet që njeriun ta largojë nga adhurimi dhe namazi.

Lidhur me këto do të rrëfejme tregimin e Imamit Ebu Hanife, i cili ishte i njohur për dhënien e këshillave juridike islame për çështjet islame.

“Një ditë erdhi një njeri tek ai dhe i tha: Më kanë humbur të hollat, ato i kam futur në një vend në dhe. Vërshimi i shiut i ka zhdukur gjurmët ku i kam fshehur të hollat. E, gurin të cilin e kam vënë si shenjë(orientimi) e ka bartur uji. Unë nuk di se ç’ të bëj?!”.

Ebu Hanifja i tha: E çfarë fetfaje do të të jap për këtë çështje?

Mirëpo, njeriu e luti Ebu Hanifen duke i kërkuar udhëzime.

Ebu Hanife i tha: “ *Pasi ta falësh namazin e jacisë në xhami shko në shtëpi e adhuroje Zotin tërë natën gjer në mëngjes, e pastaj më njofto se çka ndodhur*”. Të nesërmen në mëngjes erdhi njeriu i ngazëllyer dhe i tha Ebu Hanifesë: “*I kam gjetur të hollat*”.

Ebu Hanifja e pyeti se si i kishte gjetur ato. Njeriu tha:

“ Veprova si më porosite e duke u falur mu kujtua vendi i të hollave, si erdhi – u bë vërshim, dhe si ndodhi e tërë kjo. Në këtë mënyrë e përcaktova dhe e gjeta vendin e të hollave”. Ebu Hanifeja buzëqeshi dhe tha:

Për Zotin e kam ditur se njeriu do t’ia kushtojë atë natë Allahut, nxitoi t’ia përkujtojë vendin në të cilin i kishte fshehur të hollat dhe në këtë mënyrë ta pengojë nga namazi dhe adhurimi i Zotit.

Ky rrëfim na lë të kuptojmë edhe ajetin kur’anor ku Allahu thotë:

قَالَ فَبِمَا أَغْوَيْتَنِي لَأَقْعُدَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ { 16 }

“Pasi më humbe (çove në rrugë të gabuar), unë do t’u dal atyre në pritë dhe do t’i pengoj nga rruga Jote e drejtë”

(S.A’raf: 16)

Këtë çështje do ta shtjellojmë në hollësi, në dashtë Zoti, në kapitullin vijues kur të flasim për mënyrat e shejtanit se si i mashtron njeriun, se si e pengon atë të mos shkojë në xhami dhe në vendet ku adhurohet Allahu, ai i largon vëmendjen dhe e ndalon nga namazi dhe adhurimi.

Të vazhdojmë e të lexojmë se ç’thotë Kur’ani fisnik për këtë:

ثُمَّ لَا تَلْبَسْنَهُمْ مِنْ بَيْنِ أَيْدِيهِمْ وَمِنْ خَلْفِهِمْ وَعَنْ أَيْمَانِهِمْ وَعَنْ شَمَائِلِهِمْ
وَلَا تَجِدُ

{ 17 } أَكْثَرَهُمْ شَاكِرِينَ

“Pastaj do t’i godas ata para, prapa, nga e djathta dhe nga e majta, shumica prej tyre nuk do t’i kesh falënderues”

(S.El-A’raf: 17)

Kur e studiojmë këtë ajet të Kur’anit ne vërejmë se shejtani ka përkufizuar vetëm katër anët nga të cilat vjen te njeriu, e ato janë: ana e djathtë, e majtë, e përparme, dhe e prapme. Dihet se anët janë gjashtë e jo katër këto që i përmendëm ajo e larta dhe e poshtme. Pse shejtani i qaset njeriut për ta mashtruar e bërë vese nga katër anët, ndërsa të lartën dhe të poshtmen fare nuk e përmend? Në këtë pyetje përgjigjemi si vijon:

Ana e lartë është ajo anë nga e cila ngritet lutja e njeriut te Allahu e gjithashtu edhe veprat e mira. Ndërsa ana e poshtme është vendi në të cilin bëjmë sexhde dhe i përkulemi Allahut. Prandaj, shejtani nuk mund të afrohet nga këto dy anë, se vendi ku bëjmë sexhde dhe ku i përkulemi Allahut është vend i Allahut në të cilën shejtani nuk mund të afrohet. Gjithashtu edhe ana nga e cila drejtohet lutja edhe veprat e mira te Allahu as këtu nuk mund të afrohet.

Këto dy anë janë më bekuara për çdo besimtar, të cilat i përfshijnë melaqet, e shejtani assesi nuk mund të afrohet te to.

Mirëpo, ne patjetër duhet të ndalemi te ajeti kur’anor ku Allahu thotë:

“Shumica e tyre nuk do të jenë falënderues”.

Këtu shtrohet pyetja: Kush e njoftoi dhe e mësoi shejtanin se shumica e tyre nuk do të jenë falënderues ndaj Allahu për dhuntitë dhe begatitë e Tij?

Për këtë Allahu thotë:

وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَشْكُرُونَ { 243 }

“Por shumica e njerëzve nuk janë falënderues”

(S.Bekare: 243)

A thua nga mund t’i dijë fshehtësitë shejtani... Kush e mësoi atë se shumica e njerëzve nuk do të falënderues? Mos ishte ai vetë i bindur plotësisht ne vete për t’i thënë këto fjalë...Shejtani nuk di

fshehtësi (*gajb*) e as që i është dhënë njohuri e tillë që të thotë “*se shumica e njerëzve nuk do të jenë falënderues*”.

Ai assesi nuk kishte dije definitive dhe të përpiktë se do të ndodhë ajo që i kishte thënë Zotit.

Allahu në Kur'an thotë:

وَلَقَدْ صَدَقَ عَلَيْهِمْ إِلِيلِسُ ظَنُّهُ فَاتَّبَعُوهُ إِلَّا قَرِيْبًا مِّنَ الْمُؤْمِنِيْنَ {20}
“**Vërtetë Iblisi vërtetoi mendimin e vet ndaj tyre, kur ata shkuan pas tij, por një grupi besimtarësh**”.

(S.Sebe: 20)

Pra, ajo që e tha Iblisi është vetëm një hipotezë e jo njohje e fshehtësive (*gajbit*). Ai nuk di se çka do të ndodhë në të ardhmen.

Allahu ia ka shqiptuar (caktuar) dënimin Iblisit dhe atyre që e ndjekin rrugën e tij. Në Librin e Tij fisnik Allahu i Plotfuqishëm thotë:

أَخْرَجَ مِنْهَا مَذْمُومًا مَّدْحُورًا لِّمَن تَبِعَكَ مِنْهُمْ لِأَمْلَأَنَّ جَهَنَّمَ مِنْكُمْ أَجْمَعِيْنَ {18}

“**Zbrit nga ai i poshtëruar dhe i urretur dhe me ata që e ndjekin rrugën tënde do ta mbush xhehenemin**”.

(S.EIA'raf: 18)

Në këtë mënyrë u dëbua Iblisi nga mëshira e Allahut, xheneti dhe nga një vend i lartë (afër Zotit). Me këtë u bë i poshtëruar dhe i mallkuar, e jo vetëm ai por çdonjëri që ndjek rrugën e tij qoftë ai nga xhindët apo nga njerëzit. Dënimi i tyre është qëndrimi i përhershëm në zjarr.

Allahu xh.sh. ka përgatitur për çdo rob të Tij qoftë nga njeriu apo xhindët, nga një vend të caktuar në xhenet dhe në xhehenem (ferr). Nëse të gjithë njerëzit janë ata të cilët janë mëkatar do të futen në xhehenem e për të gjithë do të ketë vend. E nëse meritojnë të gjithë që të hyjnë në xhenet, prapë do të ketë vend për të gjithë.

Ditën e Gjykimit banorët e xhenetit do të kenë më shumë vende në xhenet se sa u ka premtuar Allahu, e ato janë vendet e mëkatarëve të cilët kanë hyrë në xhehenem.

Pasi Allahu e la të lirë Iblisin gjer në Ditën e Gjykimit për t'i mashtruar njerëzit, Ai dëshiroi që Ademin ta mbrojë dhe ta njoftojë me provën e cila e pret. Allahu e njoftoi atë se shejtani është armik i

tij dhe se ai do të tentojë ta mashtrtojë për ta futur në mëkat, dhe se ai do t'i kurdis gënjeshtër, të cilën nuk do ta mbajë-realizojë.

Allahu xh.sh. me këtë vuri në sprovë Ademin dhe Havën...pas së cilës ata zbritën në tokë.

Allahu i madhëruar u tha:

وَيَا آدَمُ اسْكُنْ أَنْتَ وَزَوْجُكَ الْجَنَّةَ فَكُلَا مِنْ حَيْثُ شِئْتُمَا وَلَا تَقْرَبَا
هَذِهِ الشَّجَرَةَ فَتَكُونَا مِنَ الظَّالِمِينَ {19}

“O Adem, ti dhe gruaja jote banoni në xhenet dhe hani ç’të doni, por kësaj peme mos i afroshi se bëheni mëkatarë (zullumqarë)”.

(S.El-A’raf: 19)

Në këtë mënyrë Allahu vuri në sprovë Ademin dhe Havën në xhenet i cili ishte i pajisur me të gjitha nevojat për jetë, pa ndërë lodhje as pa dhënë mund. Ai u kishte përgatitur atyre ushqim të bollshëm nga pemë të ndryshme.

Në atë xhenet kishte edhe ujë të mjaftueshëm e në të ua kishte bërë të mundur t’i gëzojnë të gjitha begatitë që ata i dëshirojnë.

Atyre ua kishte lejuar të hanë nga të gjitha pemët e xhenetit me përjashtim të një peme. Allahu kërkoi nga Ademi dhe Hava që asaj peme të caktuar të mos i afrohen. Ajo

ishte një jetë e rehatshme me plot begati, të cilat ishin të lejuara përveç një peme. Allahu i këshilloi ata të dy që të mbrohen nga shejtani se ai është armiku i tyre. Ai i porositi që të mos e dëgjojnë atë, sepse ai ua dëshiron të keqen e jo të mirën. Çka ndodhi më pas?

Përkundër kësaj këshille të Zotit dhe përkundër gjithë asaj që ishte lejuar në xhenet pos një peme. Shejtani prapë arriti që Ademin dhe Havën t’i mashtrtojë dhe t’i fusë në mëkat. Disa nga komentatorët e Kur’anit thonë se Hava është e para e cila ra nën ndikimin e shejtanit, pastaj e tërhoqi edhe Ademin dhe se ajo është shkaktare për daljen e Ademit nga xheneti. A është kjo vërtetë?

A thua është Hava ajo,e cila e bart përgjegjësinë për mëkatin e parë për shkak të cilit Ademi u largua nga xheneti, apo ndonjë gjë e tillë është e pavërtetë? Ku qëndron e vërteta dhe çka ndodhi?

Para se të përgjigjemi në këto pyetje, do të përmbledhim shkurtimisht gjithë atë që thamë në këtë kapitull. Iblisin e kishte kapluar mendjemadhësia, e cila e mashtrroi atë pasi theu urdhrin e Allahut kur i tha: “Unë jam më i mirë se ai, mua më krijove nga zjarri, ndërsa atë nga dheu”. Me këtë ai deshi ta thyej (refuzoj)

urdhrin Allahut, e për këtë shkak Allahu e mallkoi, e largoi nga mëshira e Vet dhe e bëri prej banorëve të zjarrit atë dhe të gjithë të tjerët që e ndjekin rrugën e tij.

Por Iblisi shfrytëzon një shteg (mundësi) që ta mashtrojë Ademin deh pasardhësit e tij... Ky shteg qëndron në atë se Allahu i madhëruar është

i Gjithëfuqishëm dhe më i pasur se të gjitha krijesat e Veta. Ai që e humb rrugën e drejtë nuk i sjell kurrfarë dëmi Atij, e as ai që beson nuk i sjell kurrfarë të mire.

Duke shfrytëzuar këtë mundësi Iblisi arriti t'i mashtrojë bijtë e Ademit. Allahu e ka bërë këtë vend sprovimi. Andaj patjetër duhej të pasonte mashtrimi një mënyrë që Allahu t'i njohë ata që janë besimtarë të sinqertë.. (verifikimi praktik)... që të jenë dëshmitarë të vetes Ditën e Gjykimit.

Deshi vullneti i Allahut që Ademi të vihet në provë praktike në mashtrimet e djallit që ta paralajmërojnë dhe ta mësojë se çka do ta presë në jetën e kësaj bote. A thua si u krye ky sprovim?

Kapitulli i tretë

ADEMI DHE SHEJTANI

Allahu i madhëruar e largoi shejtanin nga mëshira e vet dhe nga ajo pozitë ku ishte.

Fjala “dalje” këtu ka domethënie largim nga vendi. Shejtani doli i dëbuar, i mallkuar dhe i qortuar. Allahu u ka premtuar të gjithë atyre që ndjekin rrugën e shejtanit se do t’i presë dënim në zjarr të xhehenemit.

Allahu xh.sh., siç përmendëm, ka përgatitur vende në xhenet për çdo krijesë të Vet prej kohës së krijimit të Ademit gjer në Ditën e Gjykimit. Pra, sikur tërë krijesat t’i përfillin urdhrat e Allahut, që të gjitha do t’i priste begatia e Allahut në xhenet. E po t’i kundërshtonin urdhrat e Tij të gjitha krijesat, që të gjitha do të merrnin dënimin e tyre në zjarrin e xhehenemit.

Allahu dëshiroi që Ademi dhe Hava t’i nënshtrohen sprovës praktike duke u ballafaquar ata të dy dhe pasardhësit e tyre me vesvesen e shejtanit, që të jenë të mbrojtur nga ajo dhe të mësojnë se shejtani është rrenacak në të gjitha ato që premtton dhe se nga ai nuk pritet kurrfarë e mire pos të keqes, dëmtimit dhe zhdukjes së të mirave (shthurjes së moralit).

Allahu thotë:

وَيَا آدَمُ اسْكُنْ أَنْتَ وَزَوْجُكَ الْجَنَّةَ فَكُلَا مِنْ حَيْثُ شِئْتُمَا وَلَا تَقْرَبَا
هَذِهِ الشَّجَرَةَ فَتَكُونَا مِنَ الظَّالِمِينَ { 19 }

“O Adem, ti dhe gruaja jote banoni në xhenet dhe hani ç’të doni, por kësaj peme mos iu afroni se bëheni zullumqarë”.

(S. El-A’raf: 19)

Nga ky ajet kur’anor kuptojmë se Ademi dhe Hava kanë qenë në një xhenet. Mirëpo, shumë dijetarë kanë thënë se me fjalën “xhenet” në ajetin kur’anor nënkuptohet xheneti i përhershëm në botën e ardhshme, gjë që orientalistët dhe studiuesit të tjerë i shtyri të shtrojnë një varg pyetjesh: Për shembull, si mund të hyj Iblisi në xhenetin e atyre që i përfillin urdhrat e Allahut, për ta ngalur Ademin dhe Havën dhe t’i

Mashtrojë që të dy?!

Si mund që Iblisi, duke qenë mospërfillës i urdhrat të Allahut dhe i largua nga mëshira e Tij, i dënuar me zjarr të xhehenemit, të hyjë në xhenet?

Si mund të hyjnë Ademi dhe Hava në xhenetin përhershëm pastaj të dalin prej tij, megjithëse Allahu i madhëruar i ka njoftuar se ai që hyn në xhenet mbetet (qëndron) përgjithmonë në të?

Personave të tillë mund t’u themi se ata nuk e kanë kuptuar domethënien e fjalës “xhenet” në Kur’anin fisnik.

Në gjuhën arabe është një shprehje që quhet “galebetul isti’mal”, e cila ka shumë kuptime, por zakonisht mund të përdoret me një kuptim të caktuar.

Kur njeriu e thotë atë atëherë mendja e tij përqendrohet në të. Prandaj, kur dëgjojmë fjalën “xhenet” mendja jonë na shkon në xhenetin botës së ardhshme, ngas se ai është xheneti i amshueshëm. Por Allahu xh.xh. fjalën “xhenet” e ka përdorur në Kur’anin fisnik në shumë kuptime. Fjala “xhenet” në kuptimin gjuhësor ka domethënien e një vendi ku ka pemë të shumta dhe të llojllojshme, e kur njeriu shkon në atë vend, ato pemë i bëjnë perde me degët e tyre të dendura. Ata që janë jashtë tij atij kopshti nuk e shohin atë njeri, njëkohësisht ai njeri gjen në të, të gjitha mjetet për jetesë. Ndaj ai nuk ka nevojë të dalë prej tij. Ky është kuptimi gjuhësor i fjalës “xhenet”.

AI NUK ËSHTË XHENET I PËRHERSHËM

Kur të studiojmë këtë fjalë në Kur'anin fisnik, vërejmë se kjo fjalë është përdorur në shumë kuptime, në kuptimin gjuhësor (vend i mbuluar-perde) dhe në atë fetar-”xheneti botës së ardhmes “. Lidhur me këto dy kuptime hasim ajete kur'anore ku Allahu xh.sh. thotë:

وَاضْرِبْ لَهُم مَّثَلًا رَّجُلَيْنِ جَعَلْنَا لِأَحَدِهِمَا جَنَّتَيْنِ مِنْ أَعْنَابٍ
وَحَفَفْنَاهُمَا بِنَخْلٍ وَجَعَلْنَا بَيْنَهُمَا زُرْعًا {32}

“ Dhe jepu atyre një shembull: të dy njerëzve, njërit prej tyre i dhamë dy kopshte të mbjellura me hardhi të rrethuara me hurma e në mes tyre bëmë ara”.

(S.El-Kehf: 32)

Dhe në ajetin tjetër:

أَبَوْدُ أَحَدُكُمْ أَنْ تَكُونَ لَهُ جَنَّةٌ مِّن نَّخِيلٍ وَأَعْنَابٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا
الْأَنْهَارُ لَهُ فِيهَا مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ

“A dëshiron kush prej jush që të ketë një kopsht me hurma e rrush në të cilin rrjedhin lumenj dhe ku ka fruta të ndryshme...”

(S.El-Bekare: 266)

Pastaj në ajetin vijues:

لَقَدْ كَانَ لِسَبَإٍ فِي مَسْكَنِهِمْ آيَةٌ جَنَّتَانِ عَن يَمِينٍ وَشِمَالٍ
كُلُوا مِن رِّزْقِ رَبِّكُمْ وَاشْكُرُوا لَهُ بَلَدَةٌ طَيِّبَةٌ وَرَبُّ غَفُورٌ

{ 15 }

“Populli Sebe kishte një shenjë në vendbanimin e vet: dy kopshte nga të dy anët, nga e djathta dhe e majta, ahni u thanë, nga begatitë e Zotit dhe falënderoju Atij! Sa ven i mirë dhe Zot që fal!”

(S.Sebe: 15)

Që në të gjitha këto ajete kur'anore Allahu xh.sh. e ka përdorur fjalën “xhenet” me domethënie të “xhenetit-kopshtit të kësaj bote”.

Disa dijetarë thonë se Allahu xh.sh. i ka dalluar xhenetit(kopshtet) e kësaj bote dhe ato të botës së ardhshme, ndërsa fjala “xhen-neh” (në trajtën pashquar) pa shkronjën “elif” dhe “lam” nënkupton xhenete të kësaj bote. Pra, kjo hipotezë e tyre nuk është e qëlluar kur e argumentojmë në këtë duke ia bashkuar fjalës “xhenet” shkronjën “elif” dhe “lam”, dmth. e përdorin në trajtën shquar, siç shihet nga fjala e Allahut të madhëruar:

إِنَّا بَلَوْنَاهُمْ كَمَا بَلَوْنَا أَصْحَابَ الْجَنَّةِ إِذْ أَقْسَمُوا
لَيَصْرِمُنَّهَا مُصْبِحِينَ وَلَا يَسْتُنْتُونُ

“Ne i sprovuam ata siç i sprovuam pronarët e kopshtit kur u betuan se do ta vjelin në agim. Por nuk thanë me rezervë-”në dashtë Zoti”.

(S.El-Kalem: 17,18)

Në këto dy ajete është fjala për një xhenet ose kopshte të kësaj bote. Pra, nyja shquese që është përdorur këtu nuk lë të kuptohet-xheneti i botës së ardhshme. Këtu duhet të ndalemi që t’i analizojmë disa fjali sipas të cilave vihet në dukje se Ademi dhe Hava kanë jetuar në xhenetin amshueshëm, e kur ata të dy bënë mëkat, Allahu i dëboi nga xheneti dhe i zbriti në tokë si njerëz jo-fatlum.

Edhe kjo hipotezë është absolutisht e paqëndrueshme, ngase Allahu i madhëruar para se ta krijojë Ademin atij ia caktoi rolin në këtë botë. Lexo fjalën e Allahut të madhëruar:

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً

“Kur Allahu u tha melaqeve: Unë do ta krijoj (e përcaktoj) një zëvendës në tokë”.

(S.El-Bekare: 30)

Pra, para se të krijohet Ademi, qëllimi i krijimit të tij ishte që ai të jetojë e gjallërojë në tokë gjersa të vdesë.

Si pikë e dytë shqyrtimi është çështja se po të dëbohej Ademi nga xheneti për shkak mëkatit që bëri, atëherë çfarë faji kemi ne që të bartim përgjegjësinë e atij mëkati dhe atij njeriu kur një gjë e tillë bie ndesh me fjalën e Allahut të madhëruar:

وَلَا تَزِرُ وَازِرَةٌ وِزْرَ أُخْرَى

“Askush nuk bart përgjegjësinë e tjetrit .”

(S.Fatir: 18)

Çdo njëri përgjigjet vetëm rë atë që ka bërë. Ai nuk merret në përgjegjësi për atë që bënë prindërit, gjyshërit apo fëmijët e tij, se njeriu nuk shpërblehet për asgjë tjetër pos për mirësitë që i ka bërë. Prandaj, nuk ka të ngjarë që Ademi të ketë jetuar në xhenetin e përhershëm, pastaj të jetë larguar pre tij për shkak të mëkatit të bërë. Mbi atë bazë ne të bartim pasojat e atij mëkati, kinse ne kemi trashëguar atë dhe për shkak të tij ne jemi larguar nga xheneti, se ndryshe po të mos bënte mëkat Ademi, gjoja, ne do të jetonim në xhenet. Personave që mendojnë kështu ua bëjmë të ditur se një hipotezë e tillë bie në kundërshtim me drejtësinë e Allahut xh.sh., e cila hedh poshtë mundësinë e trashëgimit të mëkatit (pasojave të tij).

Por, a thua çka e shtyri Allahun xh.sh. që t'i lejojë Ademin dhe Havën në xhenet pasi i krijoi?

Për një veprim të tillë ekziston një qëllim...Ademi u krijua që të marrë planprogramin nga Allahu, për të punuar dhe mos punuar...Ky program përmban këshilla themelore për jetë.

Ajo që i tha Allahu i madhëruar njeriut ta punojë, nëse njeriu nuk e punon, atëherë në tokë bëhet rrëmujë. Por ai nuk e ka thënë se nëse punohet ajo që e ka ndaluar po ashtu bëhet rrëmujë në tokë (sillen të liga).

Allahu i madhëruar i ka vendosur Ademin dhe Havën në këtë xhenet që t'i nënshtrohen sprovës praktike duke zbatuar programin e Allahut, të marrin këshilla-udhëzime konkrete... për punën e shejtanit që e bën ai për të prishur programin e Allahut, ngase puna e shejtanit është që Ademin dhe pasardhësit e tij t'i cytë për të bërë vepra, të cilat Allahu ua ka ndaluar dhe të mos i kryejnë ato obligime, për të cilat Allahu i ka urdhëruar për t'i kryer. Nëse Allahu u thotë atyre të dyve mos e pini verën, shejtani i nxit e i josh ta pijnë atë. Nëse Allahu u thotë faleni namazin, ata shejtani i nxit ta lënë pa e falur namazin, kështu me radhë...

Sprova e bërë ishte e thjeshtë nga aspekti-mënyra se si u bë, por ishte e madhe për nga rëndësia që kishte. Ajo ishte një ushtrim për Ademin a.s të mësojë se çfarë do të ndodhë nëse e zbaton urdhrin e Allahut dhe çfarë do t'i ndodhë (do ta gjejë) nëse e ndjek rrugën e shejtanit. Kështu Allahu e krijoi Ademin dhe krijoi me bollëk çdo

mjet të nevojshëm për jetë në bjë vend të cilin e quajti “xhenet”.
Allahu xh.sh. i tha Ademit:

وَيَا آدَمُ اسْكُنْ أَنْتَ وَزَوْجُكَ الْجَنَّةَ فَكُلَا مِنْ حَيْثُ

شِئْتُمَا وَلَا تَقْرَبَا هَذِهِ الشَّجَرَةَ فَتَكُونَا مِنَ الظَّالِمِينَ { 19 }

“O Adem, ti dhe gruaja jote banoni në xhenet dhe hani ç’të doni por kësaj peme mos iu afro ni se bëheni zullumqarë”

(S.El-A’raf: 19)

PROGRAMET E PARA HYJNORE

Allahu i madhëruar e njoftoi Ademin për të mirat që do t’i fitojë në atë vend, në të cilën do të banojë.Allahu xh.sh. tha:

وَأَنَّكَ لَا تَظْمَأُ فِيهَا وَلَا تَصْحَى . إِنَّ لَكَ أَلَّا تَجُوعَ فِيهَا وَلَا تَعْرَى

“Aty i ke të gjitha: nuk do të jesh i uritur, as do të mbetesh i zhveshur. Aty nuk do të kesh etje as nuk do të kesh vapë.

(S.Taha: 118,119)

Nga këto dy ajete kur’anore kuptojmë se Allahu i tha Ademit se në atë vend-xhenet ka ushqim të mjaftueshëm, rroba për t’u veshur- mbuluar trupin, ujë që do ta gjesht gjithnjë, e s’do të ndjesh etje e nuk do të lodhesh.

Pemët e atij xheneti janë të lejuara për ty, por edhe çdo gjë është e lejuar pos një peme, e ti mos iu afro asaj peme as mos ha frutat e saj”.

Ky është programi i Allahut i përgatitur për këtë botë... Allahu i madhëruar na e lejon shumë gjëra dhe na i ndalon shumë pak gjëra. Ai e këshilloi Ademin dhe Havën që të ruhen nga armiku i tyre Iblisi.

Ndaj tha:

فَقُلْنَا يَا آدَمُ إِنَّ هَذَا عَدُوٌّ لَكَ وَلِزَوْجِكَ فَلَا يُخْرِجَنَّكَمَا

مِنَ الْجَنَّةِ فَتَشْقَى { 117 }

“Ne i thamë: O Adem ky është armik yti dhe i gruas sate, mos lejoni kursesi që t’ju nxjerrë nga xheneti, e pastaj të vuash”.

(S.Taha: 117)

Ky paralajmërim (i Allahut drejtuar Ademit...) ishte i mjaftueshëm për t’ia tërhequr vërejtjen Ademit për armiqtë e Iblisit ndaj tij.

Ai i tha që të mos ua vërë veshin vesveseve të shejtanit as t’u besojë gënjeshtrove të tij.

Allahu i madhëruar krijoi me bollëk të gjitha gjërat e nevojshme për jetë, ushqim, i jep çka ka nevojë trupi i tij pa ndërë nevojë fiziologjike, se Allahu i madhëruar e ushqen fetusin në bark të nënës aq sa i mjafton për ta zhvilluar atë pa ndërë nevojë fiziologjike (për ta nxjerrë jashtë mbeturinat e tij,) ngase ushqimi i jepet as sa ka nevojë për t’u zhvilluar trupi. Edhe ushqimi i Ademit ka qenë aq sa ishte zhvilluar ai vetë.

Duhet vënë re se xheneti ku jetoi Ademi nuk është xheneti i përhershëm, ngase në xhenetin e përhershëm jeta fillon vetëm pas jetës në këtë botë. Jeta në këtë xhenet, pra, është si shpërblim për ata që kanë çuar jetën e tyre në këtë botë sipas programit të Allahut. Jeta në të (xhenet), pra, nuk pason para jetës në këtë botë, por pas jetës së kësaj bote.

Andaj, xheneti në të cilin jetoi Ademi është vendi në të cilin kishte gjithçka që ishte e nevojshme për jetën e tij dhe që kërkonte...

Ne duhet medoemos të vëmë re se Allahu i madhëruar “mos hani...” atëherë do t’ua lejonte Ademit dhe Havës që t’i afrohen asaj peme, të ulen pranë saj dhe të mendojnë për frutat e saj, pastaj t’i joshë forma frytit të saj, ngjyra ose aroma e saj dhe më në fund të hanë prej saj.

Po Allahu i madhëruar deshi që Ademi të ruhet vetë nga e keqja, ngasja-mashttrimi i atij që mund t’i ekspozohet që mbase është më i dobët me atë që ballafaqohet... Kjo mbrojtje të cilën Allahu deshi t’ia sigurojë Ademit dhe pasardhësve të tij më vonë...

Kjo, pra, është mbrojtje e vërtetë që të mos bjerë njeriu në mëkat, ngase po t’i afrohet njeriu një gjëje që e ka ndaluar Allahu, shpirti i lëngon për të. Mbase kjo afri e cyt ta shijojë atë.

Nga ajeti kur'anor që po e citojmë në vazhdim, ne vërejmë se Allahu i madhëruar kërkon prej nesh që të mos u afrohemi shtigjewe që shpijnë në mëkate:

ذَلِكَ وَمَنْ يُعْظَمْ حُرْمَاتِ اللَّهِ فَهُوَ خَيْرٌ لَهُ عِنْدَ رَبِّهِ وَأَجَلَتْ
لَكُمْ الْأَنْعَامُ إِلَّا مَا يُتْلَى عَلَيْكُمْ فَاجْتَنِبُوا الرِّجْسَ مِنَ الْأَوْثَانِ
وَاجْتَنِبُوا قَوْلَ الزُّورِ {30}

“Ky është urdhër. E kush madhëron vendet e shenjta të Allahut është mirë për tek Zoti i vet. Për ju janë të lejuara (si ushqim në Haxhillëk) kafshët pos atyre të përmendura (si përjashtim- të ndaluara). Andaj, largohuni nga ndotësitë e idhujve dhe largohuni nga fjalët e rrejshme”.

(El-haxh: 30)

Allahu xh.sh. nuk na ka thënë “mos i adhuroni idhujt” se po të thoshte ashtu (njeriu do të kuptonte se shkuarja te vendet ku adhurohen idhujt është e lejuar, madje edhe të ulemi te ata. Nëse e bëjmë një veprim të tillë mbase ne do ta bënim shprehi atë ndejë, Allahu na ruajt! t’i adhurojmë idhujt. Lidhur me këtë lexo fjalën e Allahut xh.sh.

“ O ju besimtarë! S’ka dyshim se vera (pijet alkoolike), bixhozi, idhujt dhe heshtja e shigjetës së fallit janë vepra të ndyta të shejtanit, pra largohuni...”

Kjo do të thotë mos iu afro vendeve të tilla. Njeriu habitet kur të hasë në njerëz të cilët orvaten të grinden me ty duke thënë kinse Allahu nuk i ka ndaluar pijet alkoolike dhe i thonë: “na sjell një ajet nga Kur’ani fisnik në të cilin Allahu thotë se janë ndaluar pijet alkoolike.”

Këtyre personave të dyshimtë iu përgjigjemi kështu:

Vërtet urdhri i cili ndalon çdo shteg që shpie në konsumimin e tij është më i fuqishëm se vet urdhër-ndalimi i konsumimit... ngase po të thoshte Allahu xh.sh. “u ndaluan për ju pijet alkoolike” atëherë si veprim i ndaluar do të ishte vetëm konsumimi i pijeve alkoolike, por me atë rast ne do ta prodhoni dhe do zhvillonim tregti me to. Do të përgatitnim vendet për deponimin e tyre pasi që me to do t’u shërbenim atyre që pinë dhe do të uleshim me ta, ani pse ne nuk e pjmë atë... gjersa, gjoja, për të ka zbritur vetëm urdhri i ndalesës... Megjithatë, parapengimi është vënë si masë preventive që parimisht të

mos afrohem i në vende ku pihet alkooli, të mos e prodhojmë, as ta shesim, as të ulemi me ata që e pinë.

Pra, siç shihet mënjanimi nga të gjitha shtigjet që shpijnë kah alkooli,

është më i fuqishëm se vetë ndalesa. Prandaj, Allahu xh.sh. kërkoi nga Ademi dhe gruaja e tij që të mos i afrohen asaj peme të ndaluar, përndryshe do të bëjnë mëkat.

SI BËNË ADEMI DHE HAVA MËKAT

A thua çka bëri shejtani? Ai deshi që Ademi dhe Hava të bien në mëkat. Ç'bëri shejtani?

Allahu i madhëruar thotë:

فَوَسْوَسَ لَهُمَا الشَّيْطَانُ لِيُبْدِيَ لَهُمَا مَا وُورِيَ عَنْهُمَا مِنْ سَوْءَاتِهِمَا
وَقَالَ مَا نَهَاكُمَا رَبُّكُمَا عَنْ هَذِهِ الشَّجَرَةِ إِلَّا أَنْ تَكُونَا مَلَكَينِ أَوْ تَكُونَا
مِنَ الْخَالِدِينَ {20}

“Shejtani u pëshpëriste sugjestionë që t’ua zbulojë vendet e turpshme, që i kanë pasur të mbuluara, e u tha: “Nuk jua ka ndaluar Zoti këtë për asgjë tjetër vetëm sa që të mos bëheni ju të dy engjëj ose të pavdekshëm”.

(S.El-A’raf: 20)

Siç thotë Allahu xh.sh. “dhe u pëshpëriti”-jep të kuptojmë se dialogu mes shejtanit dhe Ademit e Havës u zhvillua në formë pëshpëritje me një zë të ngjirur. Vesvesja-pëshpëritja është ngasje e shejtanit. Ajo është ngasje për të bërë vepër e keqe.

Ai që flet për të bërë vepra të mira nuk ngurron që të flasë me zë të lartë. Ndërkaq, këshilla që jepet për të vepruar keq dhe për të bërë mëkat nuk jepet ndryshe përveq në formë të pëshpëritjes me zë të ngjirur.

Vesvesi në gjuhën arabe ka domethënien e një tingëllimi të ëmbël dhe të këndshëm. Ai zë, pra, i josh njerëzit, i mashtron dhe ua tërheq vëmendjen.

Në vesvese patjetër duhet të ketë qëllime të mashtrimit, ngase nëse njeriu dëshiron ta largojë njeriun nga rruga e Allahut atë e bën duke e mashtruar me një interes material të kësaj bote e të cilin dë të bëjë për vete.

Ne doemos duhet ta studiojmë fjalën e Allahut të madhëruar “dhe u pëshpëriti atyre dyve shejtani” ngase teza e përhapur, sipas të cilës shejtani e mashtroi Havën, e gjoja Hava është ajo që e mashtroi Ademin, e cila ia shishmoi mëkatin gjersa ai hëngri nga pema e ndaluar. Sipas kësaj teze “mos të ishte Hava Ademi do të mbetej në xhenet”!

Atyre personave që lansojnë hipoteza të tilla po ua përkujtojmë se Allahu e arsyetoi Havën nga kjo ngasje, se në Kur’an thotë: ” Shejtani u bëri vesvese-pëshpëriti atyre dyve” Kjo është dëshmi se shejtani është ai që ua hijeshoi mëkatin Ademit dhe Havës. Kjo do të thotë se shejtani është ai që e mashtroi Ademin dhe Havën.

Pra, Hava nuk është ajo që e nxiti Ademin të bëjë mëkat, por ata të dy i nxiti shejtani për të bërë mëkat.

A thua ç’është qëllimi i shejtanit me këtë pëshpëritje?

Qëllimi i tij ishte që Ademi dhe Hava të mashtrohen dhe të mos e përfillin këshillën e Zotit, pastaj të dënohen ashtu siç u dënua shejtani kur u largua nga mëshira e Allahut. Si dënim për mëkatin që bëri Ademi dhe Hava ishte shpallimi i vendeve të marres (turpiti) të Ademit dhe të Havës... E ato pjesë të trupit njeriut ia vrasin sytë, se karakteri moral i bashkëlidur i njeriut njeriun e bën të skuqet nga syri i njerëzve-botës nëse i duken ato pjesë të turpshme të trupit.

Para se të hanin Ademi dhe Hava nga pema, ata nuk ia kanë parë njëri tjetrit “*avretin*” (pjesën e turpshme të trupit). As s’e ka parë Ademi avretin e vet, as Hava atë të saj. Që të dyve Allahu i vuri perde (i mbuloi) që të mos ia shohin njëri tjetrit këto pjesë të trupit.

Mendimtarët janë lodhur duke menduar se si kanë qenë të mbuluara “*avretit*” i Ademit dhe i Havës. Disa prej tyre thonë se ata kanë qenë të mbuluar me rrobe, ndërsa disa të tjerë se thonjtë e Ademit dhe të Havës kanë qenë aq të mëdhenj, sa arrinin gjer te gjunjët. Ata me këta i mbulonin avretet e tyre. Pastaj këta thonj hiqen kur këta bëjnë “mëkat”.

Por një pohim i tillë nuk duhet të na vrasë mendjen, se Allahu i madhëruar ua ka mbuluar avretin e Ademit dhe Havës me një lloj mbulese që ka dashur ... me dritë të fuqishme të Tij, ngase nëse drita është e fortë, atëherë është e pamundur të shikosh gjëra përmes saj.

E kur drita është e dobët, njeriu mund t'i dallojë gjërat, e kur ajo është e fuqishme ato janë të padukshme.

Mbulesa e Ademit dhe e Havës e bërë nga Allahu i madhëruar qoftë me rroba. Thonj apo nga drita e Vet, është me rëndësi se avretet e tyre kanë qenë të mbuluara nga sytë e të dyve.

SI U SHFAQ AVRETI (VENDTURPI I NJERIUT)

Shtrohet pyetja, ”përse shqetësohemi kur të shpalohe avretet tona/?” Avretet janë pjesë të trupit prej nga dalin mbeturinat e ushqimit. Ne kemi dëshirë t'i tregojmë organet prej nga hyn ushqimi dhe pijet p.sh gojën. Por njëkohësisht jemi tejet të kujdesshëm që mos t'i shpalojmë ato pjesë trupi prej nga dalin mbeturinat e ushqimit.

Disa dijetarë e arsyejnë këtë kështu: “Avreti na e përkujton mëkatit që Ademi e ka bërë kur hëngri nga pema e ndaluar”. Kur u bë ai mëkat u vu në dukje avreti. Andaj, ne duam që ato pjesë të trupit t'i mbulojmë ngase ato janë simbole të mëkatit. Edhe mëkati është një lloj “avreti” të cilin njeriu gjithmonë orvatet ta fshehë dhe turpërohet për shkak të tij, kujdeset që të mos e shohë askush. Për këtë qëllim ata ndër marrin masat e nevojshme...

Kur njeriu posedon mall “hallall” (të fituar në mënyrë të ligjshme) del krenar pata të gjithë njerëzve, s'ka frikë për asgjë, por njeriu që posedon pasuri të vjedhur, orvatet ta fshehë atë nga e gjithë bota.

Andaj, mëkati në të gjitha rastet është një “avret”, të cilin njerëzit orvaten ta fshehin dhe ta mbulojnë. Por si e bëri shejtani ngasjen ndaj Ademit dhe Havës dhe si i futi në mëkat?

Lidhur me këtë lexo fjalën e Iblisit që e citon Allahu në Kur'an:

وَقَالَ مَا نَهَاكُمَا رَبُّكُمَا عَنْ هَذِهِ الشَّجَرَةِ إِلَّا أَنْ تَكُونَا مَلَكَتَيْنِ أَوْ تَكُونَا
مِنَ الْخَالِدِينَ {20}

“Nuk ua ka ndaluar Zoti juaj këtë për asgjë tjetër vetëm që të mos bëheni ju të dy engjëj ose të pavdekshëm”.

(S.El-A'raf: 20)

Shejtani iu afrua atyre me një stil, duke i ngazëllyer ata, stil të cilin njeriu e do dhe e preferon. Fjala është, pra, për mundësinë për të çuar jetë të amshuar në të cilën pasuria kurrë nuk harxhohet

Andaj, kur deshi të mashtrtojë Ademin dhe Havën duke i nxitur të hanë nga pema ndaluar, siç thotë Kur’ani fisnik, shejtani tha:

قَالَ يَا آدَمُ هَلْ أَدُلُّكَ عَلَى شَجَرَةِ الْخُلْدِ وَمُلْكٍ لَّا يَبُلَىٰ {120}

“O Adem, a do të ta tregojë pemën e pavdekshmërisë dhe pushtetin e përhershëm”.

(S.Taha: 120)

Shejtani çka flet gënjen, ngase po të ishte ajo pemë vërtet e amshuar, shejtani vetë do të hante prej saj dhe do të bëhej i amshuar e s’do të vdiste. Por në anën tjetër ai kërkoi nga Allahu ta lërë të lirë gjer në Ditën e Gjykimit, ngase ai është i sigurt se Allahu është Krijues i jetës dhe vetë Ai është që jep dhe merr jetë...

Në doemos duhet të përqendrojmë vëmendjen tonë në mënyrën e mashtrimit të shejtani. Shejtani orvatet ta mashtrtojë njeriun duke i thënë se programi i Allahut të madhëruar, nëse e zbaton atë njeriu, ai do të dëmtojë njeriun dhe s’do të ketë kurrfarë dobie prej tij dhe se dobia e vërtetë që mund të ketë njeriu mund të gjejë nëse bën mëkat. Si për këtë ai u tha Ademit dhe Havës se kjo është arsyeja përse Allahu ua ka ndaluar të hanë nga ajo pemë që ata mos të kenë pasur dhe mos të jenë të amshuar.

Dihet mirëfilli se njeriu e urren varfërinë dhe vdekjen. Ai dëshiron të jetë i pavdekshëm. Për këtë arsye shejtani erdhi e u tha:

“Nëse e doni amshimin dhe pasurinë... ju kenë pemën”, dhe siç citon Kur’ani fisnik ai u betua:

وَقَاسَمَهُمَا إِنِّي لَكُمَا لَمِنَ النَّاصِحِينَ

“Dhe ju betua atyre dyve duke u thënë se: unë jam këshilluesi i juaj i vërtetë”.

(S.El-A’raf: 21)

Nga ky ajet vihet në dukje se Iblisi është betuar se dëshiron t’i këshillojë ata. Ata i besuan betimit të shejtanit duke menduar se ai ua do të mirën. Për këtë arsye Allahu i qortoi Ademin dhe Havën pse i besuan betimit të shejtanit, ani pse Ai i kishte njoftuar se Iblisi është armiku i tyre, e pra nuk ia do të mirën. Allahu i madhëruar në Kur’an thotë:

وَنَادَاهُمَا رَبُّهُمَا أَلَمْ أَنهَكُمَا عَن تِلْكَ الشَّجَرَةِ وَأَقُل لَّكُمَا إِنَّ

الشَّيْطَانَ لَكُمَا عَدُوٌّ مُّبِينٌ {22}

“...Dhe i thirri ata të dy Zoti i tyre: A nuk ua kam ndaluar ju të dyve atë pemë dhe a nuk ju pata thënë se shejtani është armik i hapët i juve të dyve?!”

(S.El-A'raf: 22)

Por Ademi dhe Hava u penduan shumë. Ata nuk kishin besuar se një krijesë e Allahut betohet rrejtshëm në Allahun. Lidhur me këtë Katadir.a ka thënë: “Besimtari i Zotit mashtrohet, dmth. kur të kontaktosh(të hyjsh në shpirtin e besimtarit, e ke lehtë ta mashtrosh”. Abdullah Ibën Omer, kur ndonjë rob i tij mësohej mirë të falet, ai e lironte. Kur e shihnin atë robërit fillonin të faleshin me frikë (përkulje).

Ndaj një ditë njerëzit i thanë:

“Robërit po të mashtrojnë që t’i lirosh ata.... Ai u tha:

“Kush na mashtron neve duke u betuar në Allahun e ka mashtruar veten”.

Allahu i madhëruar thotë:

فَدَلَاهُمَا بِغُرُورٍ فَلَمَّا ذَاقَا الشَّجَرَةَ بَدَتْ لَهُمَا سَوْءَاتُهُمَا وَطَفِقَا
بِخُصْفَانٍ عَلَيْهِمَا مِنْ وَرَقِ الْجَنَّةِ

“...Ata i mashtroi me dinakëri. Kur e shijuan pemën u zbulua vend-turpi i tyre, ndaj ata filluan të mbulohen me gjethe të xhenetit”

(S.El-A'raf: 22)

Kjo ishte një dredhi me lajka siç është litari i kovës që hedhet në pus për të marrë ujë... Vetëmashtrimi është një lloj ngasjeje, e cila njeriun e shpie të bjerë në kundërshtim me ligjin

Të ndalemi te kjo çështje për ta shtjelluar në hollësi.

Asnjë njeri nuk mendon se Iblisi i ka futur Ademin dhe Havën në mëkat me të parën herë, por një qëllim të tillë ai e kishte arritur gjatë disa fazave. Iblisi, së pari i mashtroi ata të dy që t’i afrohen pemës, pastaj ua hijeshoi frutat, shijen, ngjyrën dhe aromën e saj. Më pas ai i mashtroi të hanë prej saj! Kjo do të thotë se mëkati është bërë në disa faza, e jo me të parën herë. I Dërguari i Allahu a.s. ka thënë:

“Zemra ngaset pjesë-pjesë “si hasra”. Andaj, duhet vënë re se afrimi afër vendit të mëkatit na fut në të. A thua ç’ndodhi? A e përsëritën mëkatin Ademi dhe Hava duke ngrënë disa herë nga pema? Allahu i madhëruar në Kur’an thotë: “Kur shijuan pemën, dmth posa kërkuan shijen e saj, ata nuk vazhduan të bëjnë edhe më tej mëkat”. Me të shijuar pemën atyre iu shaluan avretet dhe filluan t’i fshehin e t’i mbulojnë me gjethe të pemëve të xhenetit. Kjo do të thotë se ata kishin nevojë për shumë gjethe që t’i mbulojnë avretet e tyre...

Këtu vihet në dukje drejtësia e Allahut të madhëruar, ngase Ai së pari ua tërhoqi vërejtjen që të mos i shkelin urdhrat e Tij. I njoftoi për ndëshkimin apo dënimin që do t’i presë, në mënyrë që gjykimi të jetë i drejtë. Mu për këtë. Në ligjin hyjnor, nuk ka aso nominacione siç quhen ligje të plotfuqishme me veprime retroaktive. S’ka inkriminim në drejtësinë e Allahut drejtuar Ademit dhe Havës që të mos i afrohen asaj peme. Ai i njoftoi se shejtani është armik i tyre. Allahu i madhëruar thotë:

“A nuk ua kam ndaluar ju të dyve atë pemë...”

Qëllimi i kësaj sprove praktike nga Allahu i madhëruar ishte që t’i imunizojë-mbrojë Ademin, Havën dhe pasardhësit e tyre nga shejtani.

Allahu i njoftoi ata të dy se shejtani gënjen në çdo fjalë që flet dhe se ai ua do të keqen... Kur ai paraqitet se ua dëshiron të mirën, qëllimi i shejtanit është që të përdorë të gjitha metodat dhe çdo dredhi... për të mashtruar Ademin dhe Havën dhe pasardhësit që të bëjnë mëkat, dhe të shfrytëzojë çdo dinakëri që Ademi dhe pasardhësit e tij të punojnë atë që e ka ndaluar Allahu. Por athua a mbaroi ajo betejë? Jo, ajo nuk mbaroi, por vazhdoi edhe më tutje dhe do të vazhdojë gjer në Ditën e Gjykimit.

Kapitulli i katërt

MËKATI I ADEMIT DHE MËKATI I IBLISIT

Në kapitullin e kaluar folëm se si Iblisi arriti të ngas Ademin a.s. dhe Havën duke i shfrytëzuar një mundësi në saje të faktit, se Allahu është Fuqplotë, i Pavarur dhe s'ka nevojë për krijesat e veta (vepruan ato drejt a nuk vepruan). Allahu i madhëruar thotë lidhur me këtë në një hadith kudsij:

يا عبادي لو أن أولكم و آخركم و إنسكم و جنحكم كانوا على أتقى قلب رجل واحد منكم ما زاد ذلك في ملكي شيئاً، و لو أن أولكم و آخركم و إنسكم و جنحكم كانوا أفجر قلب رجل واحد منكم ما نقص ذلك من ملكي شيئاً... و لو أن أولكم و آخركم و إنسكم و جنحكم كانوا قاموا في صعيد واحد فسألوني فأعطيت كل إنسان مسأله ما نقص ذلك عندي إلا كما ينقص المحيط إذا أدخل البحر.

“O adhurues të Mi! Sikur njeriu i parë, i fundit, njerëzit(banorët) tuaj dhe xhindët të ishin me zemër të drejtuar si të një njeriu nga ju, ata asgjë nuk do t'i shtonin pushtetit Tim, po edhe sikur i pari, i fundit njerëzit tuaj dhe xhindët të ishin me zemër të prishur si një njeri nga mesi juaj asgjë nuk do t'i mungonte pushtetit Tim. Sikur i pari, i fundit, njerëzit tuaj dhe xhindët të qëndronin në një fushë e të më lutnin Unë do t'ia jepja secilit atë që kërkon, e Mua nuk do të më

mungonte asgjë ashtu siç nuk i mungon a i shtohet oqeanit gjë kur derdhet deti në të”.

Pra, në saje të fuqisë së Allahut, shejtani arriti ta mashtrojë dhe të bindë Ademin se kinse Allahu ua ka ndaluar të hanë nga pema për arsye se Ai nuk po ua donte të mirën”. Ai vepron ashtu gjersa të kuptojmë rrugën mashtruese

të Iblisit... Por dihet se s’ka asnjë të mirë prej të mirëve që të shpie në zjarr të xhehenemit, as ka të keqe nga të këqijat që të shpie në xhenet dhe në adhurimin e Zotit.

Shejtani përpiket t’ia zbukurojë njeriut të keqen duke i thënë se ajo është e mirë për të. Kësisoj i zbukuroi mëkatin Ademit duke i thënë se ai (mëkati) është i mirë. Kur Ademi hëngri nga pema dhe bëri mëkat, atëherë Iblisi iku! Pyetja që shtrohet këtu është: “Pse Allahu ia fali mëkatin Ademit, ndërsa Iblisit jo? Ademi bëri mëkat, po edhe Iblisi bëri mëkat. Ademi iu pendua Allahut dhe iu pranua pendimi, e Iblisi u mallkua dhe do të dënohet përgjithmonë në zjarr të xhehenemit. A thua ku qëndron dallimi mes dy mëkateve?

Përgjigjja është kjo: Ademi dhe Hava kur bënë mëkat nuk ishin këmbëngulës ta përsërisin atë më tej, as tentuan ta thyejnë më urdhrin e Allahut. Ata nuk i thanë “O Zot, gjykimi yt nuk është i drejtë siç veproi shejtani kur tha: “Unë jam më i mirë se ai, mua më krijove nga zjarr, e atë nga balta”. Ata të dy nuk vepruan ashtu siç veproi Iblisi, por pranuan gabimin e tyre duke kërkuar nga Allahu që t’i falë dhe t’i mëshirojë. Lidhur me këtë Allahu i madhëruar thotë:

قَالَ رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنفُسَنَا وَإِن لَّمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ

الْخَاسِرِينَ {23}

“Ata dy thanë: O Zoti Ynë, kemi bërë mëkat ndaj vetes, nëse nuk na fal dhe nuk na mëshiron me siguri do të jemi prej atyre të humburve”.

(S.El-A’raf: 23)

Këto ishin fjalët me të cilat iu drejtuan Allahut Ademi dhe Hava pasi bënë mëkat. Ata thanë: O Zot fjalët Tua janë të vërteta dhe urdhri Yt kur na këshillove që të mos i afrohem pemës së caktuar ishte e drejtë, por ne nuk mundëm t’i përmbajmë shpirtat tonë të dobët që t’u përmbahemi këshillave Tua... ndaj bëmë mëkat, dmth. ne shkuam rrugës së shkatërrimit, nga Ti kërkojmë që të na falësh mëkatin dhe të

kesh mëshirë ndaj nesh. E nëse Ti nuk na i përgjigjesh lutjes sonë ne do të jemi prej atyre që janë të humbur Ditën e Gjykimit.

Në këtë mënyrë Ademi dhe Hava kërkuar nga Allahu që t'ua pranojë pendimin, e për këtë Allahu i madhëruar thotë:

{ 37 } فَتَلَوَىٰ أَدَمُ مِنْ رَبِّهِ كَلِمَاتٍ فَتَابَ عَلَيْهِ إِنَّهُ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ

“Ademi i mësoi disa fjalë (të shpalljes) nga Zoti i tij, prandaj Zoti ia pranoi pendimin. Ai është pranues pendimi dhe Mëshirëplotë”.

(S.El-Bekare: 37)

Pendimi është bërë në tri faza:

1)Faza e parë. Allahu i madhëruar e bëri obligim pendimin për robërit e Tij.

2)Faza e dytë. Kur ata pendohen Ai ua pranon pendimin dhe

3)Faza e tretë. Pendimi i vërtetë është ai që personi që ka gabuar mos të bëjë më mëkat.

Disa njerëz nuk e kuptojnë fjalën e Allahut të madhëruar:

{ 118 } ثُمَّ تَابَ عَلَيْهِمْ لِيَتُوبُوا إِنَّ اللَّهَ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ

“Pastaj Ai u kthye kah ata(nga mëshira e Vet) që ata të pendohen. Vërtetë Allahu është Pranues pendimi dhe Mëshirëplotë”.

(S.Et-tevbe: 118)

Disa njerëz mund të pyesin: Pasi Allahu e pranon pendimin nga njerëzit, pse atëherë e bëri pendimin obligim? Në këtë pyetje përgjigjemi kështu:

Caktimi i Allahut të madhëruar për pendim bëhet gjithsesi para se të bëhet pendimi... Këtë e dëshmon fjala e Tij “*tabe alejhim*” që do të thotë se Ai ua bëri obligim pendimin...

Ai u kishte thënë atyre se po të bëjnë gabim ose mëkat le të pendohen gjersa Allahu i madhëruar ka kërkuar prej tyre të pendohen. Ndaj ata i drejtohen Atij me pendim, e Allahu ua pranon atë.

Ligji-obligimi i pendimit nuk nënkupton mëshirë vetëm ndaj njeriut që ka bërë mëkat, por ndaj tërë bashkësisë shoqërore, ngase Allahu i madhëruar po të mos jepte mundësi pendimi, atëherë çdo njeri bën që bën mëkat do t'i shtonte mëkatit të bërë mëkate të tjera. Gjersa nuk shprehet asnjë pendim, mëkati të shpie në xhehenem të përhershëm. Atij njeriu që bën një mëkat jeta i mbushet mëkate... Pra,

ai s'ka shpresë se do të hyjë ndonjëherë në xhenet, pra le ta marrë atë që i takon prej kësaj bote. Me një veprim të tillë ai do të trazonte bashkësinë shoqërore, ngase çdo mëkatar ndjell mëkate...

Nga përhapja e mëkatit nuk vuan vetëm individ, por edhe bashkësia shoqërore. Por Allahu i madhëruar, me afrimin e mundësisë së pendimit, shfaq mëshirën e Vet ndaj bashkësisë njerëzore që të mos përhapen më tej mëkatet... Mëkati i parë nuk e shpie njeriun në dënim të përhershëm në zjarr të xhehenemit, nëse mëkatori pendohet dhe i kthehet Allahut. Si për këtë njeriu nuk vazhdon të bëjë mëkate, por ai përmirësohet dhe i pendohet Allahut. Ai shpejton të bëjë sa më shumë vepra të mira, ndaj edhe i falet gabimi i bërë. Me këtë atë e mban shpresa se do të hyjë në xhenet. Ai fiton vullnetin për të bërë vepra të mira. Ndaj edhe pendimi është mëshirë për bashkësinë shoqërore.

Iblisi nuk përfill urdhrat e Allahut dhe vazhdoi më tutje duke menduar ta mashtronte njeriun që të bëjë mëkat. Siç na mëson Kur'ani fisnik ai tha:

قَالَ فَبِمَا أَغْوَيْتَنِي لَأَقْعُدَنَّ لَهُمْ صِرَاطَكَ الْمُسْتَقِيمَ {16}
ثُمَّ لَأَتَّبِعَهُمْ مِّن بَيْن أَيْدِيهِمْ وَمِنْ خَلْفِهِمْ وَعَنْ أَيْمَانِهِمْ وَعَنْ شَمَائِلِهِمْ
وَلَا تَجِدُ أَكْثَرَهُمْ شَاكِرِينَ {17}

(Iblisi)tha: Pasi që më çove në rrugë të gabuar (më humbe) atyre do t'u dal në pritë dhe do t'i pengojë nga rruga Jote e drejtë. Pastaj do t'i godas para, prapa, në anën e djathtë dhe të majtë të tyre, nuk do T'i kesh falënderues".

(S-El-A'raf: 16-17)

Iblisi nuk pranoi mëkatin e vet që e bëri, por vendosi që të veprojë edhe më tutje... duke thënë se do të bëj kështu e kështu, me këmbëngulje për të bërë mëkate. Ndërkaq, Ademi dhe Hava pranuan gabimin e tyre. Kjo është një gjë me rëndësi të cilës duhet kushtuar vëmendje që t'ua tërheqim vërejtjen të gjithë atyre që bëjnë mëkate, që të mos e arsyetojnë mëkatin duke thyer urdhrin e Zotit (Allahut), siç thotë: Rrethanat kishin ndryshuar apo koha ishte e tillë. Si për shembull: Të gjithë atyre që i afatizojnë mjetet e tyre revizore në bankë me fajde-kamatë e një punë e tillë është e ngjashme me fajdenë, ne u themi që të mos pandehin se fajdeja nuk është haram. Kamata në

mjete financiare të afatizuara është bërë sistem botëror dhe e tërë bota punon në këtë mënyrë. “Koha ka ndryshuar...”e fjalë të tjera që dëgjohen këto ditë. Njerëzit që i thonë këto fjalë dalin jashtë shtegut të mëshirës së Zotit gjersa largohen nga mëshira e Tij, madhëruar goftë Ai.

Por thoni O Zot, nuk kemi mundur ta përmbajmë (ndalim) veten, na i fal gabimet dhe na mëshiro. Në këtë rast ata e akuzojnë veten se janë të dobët, neglizhentë (mospërfillës-të shkujdesur) dhe mëkatar edhe në këtë mënyrë mbesin në shtegun e besimit. Por nëse i hedhin poshtë urdhrin e Zotit dhe thonë se kamata-fajdeja nuk është haram, me këtë rast ata dalin prej besimi dhe thonë se kamata-fajdeja nuk është haram, me këtë rast ata dalin prej besimi dhe hyjnë në mosbesim, Zoti na ruajt!

Kur njeriu bën mëkat, mos të tentojë që ta arsyetojë e ta mbrojë atë duke i thënë se ai është i lejuar. Mos të thotë se rrethanat kanë ndryshuar... e patjetër është kërkuar që të merret një vendim i kundërt... se një pohim i tillë do të thotë thyerje e urdhrin të Allahut se me të njeriu del nga besimi dhe futet në kufër (mosbesim), largohet nga mëshira e Allahut dhe mallkohet. Ky është, pra, dallimi mes mëkatit të Ademit dhe mëkatit të Iblisit...

Iblisi bëri mëkat dhe iu rrit mendja. Ademi bëri mëkat, por pranoi gabimin e vet. Kur Ademi dhe Hava pranuan gabimin e tyre Allahu ua mësoi mënyrën se si bëhet pendimi. Po të mos i mësonte Allahu xh.sh. ata nuk do të dilnin se si të pendohen. Ky pendim u bë në saje të inspirimit të Allahut. Kur ta studiojmë fjalën e Allahut të madhëruar vërejmë se Ai i citon fjalët e tyre në Kur’an kështu:

“Ata të dy thanë: ” O Zoti i yni! Kemi bërë mëkat ndaj vetes”. Këtu vërehet se ata i janë drejtuar Zotit në trajtë të shumësit... Ata nuk thanë “O Zot! kemi bërë ndaj dy shpirtrave tanë”, ngase në këtë fjali nuk përfshihen vetëm Ademi dhe Hava, por edhe pasardhësit e Ademit. Atëherë Allahu xh.sh. u tha të dyve:

قَالَ اهْبِطُوا بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ وَلَكُمْ فِي الْأَرْضِ مُسْتَقَرٌّ وَمَتَاعٌ إِلَىٰ حِينٍ .

“Allahu u tha: Zbritni (prej atyhut)! Jeni armik i njëritjetrit, në tokë keni vendbanimin dhe mjetet për të jetuar për një kohë”.

(S.A’raf: 24)

Ne duhet të përqendrojmë vëmendjen në ajetet që na shpjegojnë se si është kryer procesi i zbritjes. Në një ajet kur'anor Allahu i madhëruar thotë:

قُلْنَا اهْبِطُوا مِنْهَا جَمِيعًا.

“Allahu tha: “Zbritni (prej atyhit)! jeni armik i njëri-tjetrit”

e në një ajet tjetër thotë:

“Zbritni prej tij të gjithë “.

(S. El- Bekare: 38)

Këto fjalë u janë drejtuar Ademit, Havës dhe Iblisit. Pra, armiqësia ndodhi mes njeriut dhe shejtanit. Mirëpo, fjala e Allahut të madhëruar “Zbritni prej tij të gjithë, jeni armik i njëri-tjetrit”, na shpjegon se armiqësia është hapur mes dy grupeve, Ademi dhe Hava një anë dhe Iblisi në anën tjetër, apo thënë më mirë Ademi, Hava dhe pasardhësit e tyre në njërin anë dhe Iblisi dhe pasardhësit e tij në anën tjetër.

Ne duhet të kuptojmë se kur Allahu përdor “shprehjen-jeni armik i njëri-tjetrit” kjo do të thotë se do të ketë konflikt dhe armiqësi mes pasardhësve të Ademit dhe pasardhësve të Iblisit. Ky konflikt do të vazhdojë vetëm gjer sa të jetë kjo jetë dhe nuk do të zgjasë në botën e ardhshme. Sa i përket shejtanit dhe njeriut konflikti-lufta ndërmjet tyre do të zgjasë gjatë javës së tyre në këtë botë, e jo gjatë tërë jetës së kësaj bote. Se kur të vdesë shejtani apo njeriu mbaron konflikti-lufta mes tyre, e sa i përket jetës së xhindit ajo është shumë më e gjatë se e njeriut. Lexo për këtë fjalën e Allahut të madhëruar:

“Ata thanë: ” O populli ynë, ne dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton atë para tij, Ai udhëzon (njerëzit) në të vërtetën dhe në rrugën e drejtë”

Nga ky ajet kur'anor vihet në dukje se ata xhindë që e dëgjuan Kur'anin jetuan që nga koha e Musait a.s. dhe mbetën të gjallë gjersa zbriti Kur'ani famëlart dmth. gjithsej 3000 vjet. Por nuk ka njeri që jeton që nga koha e Musait a.s., as njeri nga koha e Muhamedit a.s. që jeton sot.

LUFTA MES NJERIUT DHE SHEJTANIT GJATË JETËS SË TYRE NË KËTË BOTË

Siç kemi cekur më parë lufta mes njeriut dhe shejtanit zgjat për një kohë të caktuar, vetëm gjatë jetës së tyre. Ajo nuk vazhdon pas vdekjes... as në botën e ardhshme...

Allahu xh.sh. këshillon, pas asaj që ndodhi, bijtë e Ademit që t'i mbrojnë nga shejtani dhe thotë:

يَا بَنِي آدَمَ لَا يَفْتِنَنَّكُمُ الشَّيْطَانُ كَمَا أَخْرَجَ أَبَوَيْكُم مِّنَ الْجَنَّةِ
يَنْزِعُ عَنْهُمَا لِبَاسَهُمَا لِيُرِيَهُمَا سَوْآتِهِمَا

“O bijtë e Ademit, mos t’ju mashtrojë shejtani assesi ashtu siç i nxori prindërit tuaj nga xheneti, zhveshi prej tyre petkun dhe t’u dalë në shesh vendmarrja (lakuriqësia) e tyre”.

(S.El-A’raf: 27)

يَا بَنِي آدَمَ قَدْ أَنْزَلْنَا عَلَيْكُم لِبَاسًا يُؤَارِي سَوْآتِكُمْ وَرِيشًا وَلِبَاسَ
التَّقْوَى

“O bijtë e Ademit, ne krijuam për ju petk për të mbuluar vendturpin tuaj, petk zbukurues dhe petk devotshmërie...”.

(S.El-A’raf: 26)

Kjo fjalë i është drejtuar çdo personi nga bijtë e Ademit, ngase i tërë njerëzimi rrjedh prej bijve të Ademit dhe çdonjëri prej tyre është në luftë dhe armiqësi me pasardhësit e Iblisit.

Allahu xh.sh. na e tërheq vëmendjen duke na treguar se për ne ka dërguar-caktuar një ligj në bazë të të cilit ne duhet t’i mbulojmë pjesët e turpshme. Fjala *“inzalë”* që në gjuhën shqipe do të thotë zbritje (dërgim) do të thotë se diç zbriti nga lart. E, çdo e mirë që gjendet në tokë, ka zbritur nga qielli. Prandaj, rrobat me të cilat mbulojnë trupin prodhohen prej asaj gjëje që mbin nga toka, e ajo që kultivohet nga toka nuk mund të zhvillohet ndryshe pos në saje të shiut që bie nga qielli.

Duhet ta dimë se Allahu i madhëruar ka caktuar një ligj sipas të cilit duhet t’i mbulojnë pjesët e turpshme të trupit të njeriut, të bashkësive shoqërore.

Nëse ne i përmbahemi atij ligji, atëherë ne nuk do të na duken vendet e turpshme as mëkatet, bashkësia shoqërore do të ishte e një

cilësie-natyre dhe e bashkuar... Siç është një dhuratë që Allahu e ka zbrit-dërguar nga qielli, e në saje të cilit toka na sjell material (për rroba) me të cilin mbulojmë vendet e turpshme të trupit dhe rrobat (lëndë) të vlefshme me të cilat mbulojmë turpet tona në aspektin ideor, ashtu Zoti madje edhe më tepër na furnizoi me rroba elegance (pendla të zogjve) dhe me begati dhe kënaqësi të tjera.

Siç na ofroi Allahu i madhëruar luksin e jetës, të cilin na e lejoi, Ai na e caktoi ligjin me të cilin nëse i përmbahemi do të mbulojmë turpet tona në aspektin ideor. E, ku rroba nga materiali e mbulon vendturpin e trupit në këtë botë, petku i devotshmërisë na i mbulon veprat e këqija-të turpshme në botën e ardhshme. Por, petku i devotshmërisë me të cilin kërkojmë nga Allahu i madhëruar që të mos shpërthejë zemërimi i Tij ndaj nesh është më i mirë se petku nga materiali. Për këtë Allahu xh.sh. thotë:

{26} وَلِبَاسُ التَّقْوَىٰ ذَٰلِكَ خَيْرٌ ذَٰلِكَ مِنْ آيَاتِ اللَّهِ لَعَلَّهُمْ يَذَّكَّرُونَ

“... por petku i devotshmërisë, ai është më i miri. Këto janë nga argumentet e Allahut, që ndoshta ata të kujtohen”

(S.El-A'raf: 26)

Prandaj, nga sa u pa më lart petku i devotshmërisë është më i mirë se petku i kësaj bote, ngase ai na mbron që të mos i shpërthejë mllefi i Allahut xh.sh. Ai është njëri nga argumentet që na lë të kuptojmë se ne jemi të përbërë nga një materie dhe vlera... Si turp fizik që jemi siç kemi vende të turpshme të cilat duken nëse i heqim rrobat... gjithashtu edhe vlerat kanë pjesët e tyre të trupit dhe vihen në dukje për shkak të jodevotshmërisë.

Allahu i madhëruar na paralajmëron si vijon:

يَا بَنِي آدَمَ لَا يَفْتِنَنَّكُمُ الشَّيْطَانُ كَمَا أَخْرَجَ أَبَوَيْكُم مِّنَ الْجَنَّةِ يَنزِعُ عَنْهُمَا لِبَاسَهُمَا لِيُرِيَهُمَا سَوْآتِهِمَا .

“O bijtë e Ademit, mos t’ju mashtrojë shejtani assesi ashtu siç i nxori prindërit tuaj nga xheneti, zhveshi prej tyre petkun për t’u dalë në shesh vendturpi i tyre”.

(S.El-A'raf: 27)

Allahu i madhëruar na e tërheq vërejtjen për ngasjen e shejtanit e ajo ngasje është sprovë... Nëse atë sprovë e kalojmë me sukses, atëherë nuk largohemi nga rruga e drejtë. Por nëse biem në atë

sprovë... e cila as është e mirë e as e keqe, por është një provim, i cili të sjell të mira nëse ke sukses apo të sjell të këqija nëse bie në të.

Kështu ishte paralajmërimi nga shejtani për sprovë praktike që do t'ua bënte Shejtani Ademit dhe Havës para se të zbritnin në tokë. Kjo është sprovë për të kryer apo mos kryes ndonjë gjë. Sprova ishte në porosinë... e cila ka të bëjë me urdhrin për të bërë-vepruar diç apo me një ndalesë... Ademi e kishte të lejuar të hajë çdo gjë që kishte në xhenet ku jetonte, por e kishte të ndaluar t'i afrohej një peme të këtij xheneti...

Allahu i madhëruar e ka njoftuar Ademin se Shejtani është armik i tij dhe se ai do ta fusë në mëkat... Por përkundër këtij paralajmërimi Ademi dhe Hava hëngrën prej asaj peme dhe u dolën në shesh vendturpet e tyre. Kjo do të thotë se nga asnjë respektim që ia bën shejtanit njeriu nuk ka kurrë asnjë të mirë. Allahu i madhëruar nga ne dëshiron që të mësojmë se Ademi përbëhej nga dy elemente. Elementi njerëzor i cili pëson dhe gabon pa qëllim, thyen ligjin e pendohet, dhe elementi profetik, i cili është i gabueshëm.

Andaj, për këtë të studiojmë-mësojmë ajetin kur'anor:

وَعَصَى آدَمُ رَبَّهُ فَغَوَى.

“...dhe kështu Ademi theu urdhrin e Zotit të vet dhe gabo!”.

(S.Taha: 121)

Kjo është natyra e njeriut... Allahu i madhëruar thotë:

ثُمَّ اجْتَبَاهُ رَبُّهُ فَتَابَ عَلَيْهِ وَهَدَى { 122 }

“Pastaj Zoti e zgjodhi atë, ia pranoi pendimin dhe e udhëzoi në rrugë të drejtë”.

(S.Taha: 122)

Ky është udhëzimi që do ta sjellin të dërguarit (El-enbija') nga pasardhësit e Ademit. Mu për këtë nuk duhet të themi si e theu urdhrin e Zotit Ademi duke qenë i dërguari (i Tij), ngase mëkati i Ademit ndodhi para misionit profetik”.

Pasi u bë mëkati erdhi misioni profetik dhe udhëzimi. Pra, njerëzimi ndahet në dy grupe:

a)Të dërguar të Zotit që të transmetojnë ligjin e Allahut(Tij) e ata janë të pagabueshëm dhe

b)Njerëz që u transmetohet ligj i Allahut, e ata e respektojnë, e thyejnë dhe pendohen. Mos të thotë askush se Ademi ka zbritur tokë për shkak të mëkatit, ngase Allahu e ka krijuar atë dhe pasardhësit e tij që të jetojnë në tokë. Ai ua ka ndaluar, dhe i ka paralajmëruar për ngasjen e shejtanit, siç thotë në fjalën e Vet:

“O bijtë e Ademit, mos t’ju mashtrorë shejtani...”

Kjo vërejtje i është drejtuar njeriut e jo shejtanit, ngase Allahu xh.sh. nuk i tha shejtanit që të mos i mashtrorë bijtë e Ademit se po të thonte kështu shejtani do të largohej nga roli që ka në këtë botë. Atëherë kjo jetë nuk do të ishte vendsprovimi siç deshi Allahu i madhëruar... që në saje të asaj sprove që e bënë krijesat e Tij të zgjedhura, ose ta meritojnë xhenetin ose xhehenemin-zjarrin e xhenehemit, Allahu na ruajt!

Mu për këtë ngasja e shejtanit është pikërisht ajo që Allahu e deshi të jetë sprovë gjatë jetës së kësaj bote. Por disa njerëz shtrojnë pyetje për fjalën e Allahut xh.sh. në të cilën thuhet:

وَوَصَّىٰ بِهَا إِبْرَاهِيمُ بَنِيهِ وَيَعْقُوبُ يَا بَنِيَّ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ لَكُمُ الدِّينَ
فَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ {132}

“Këtë fe ua la trashëgim Ibrahimijë bijve të vet, e edhe Jakubi (i cili tha): O bijtë e mi, Allahu ua zgjodhi fenë (e vërtetë) juve, pra mos vdisni ndryshe pos si myslimanë (të vërtetë)”.

(S: El-Bekare: 132)

Kjo ndalesë vlen për njeriun... Këtu shtrohet pyetje: A kanë mundësi këtu njerëzit ta zgjedhin ... mënyrën vdekjes? A thua munden ata të caktojnë çastin, kohën dhe vendin e të mos vdesin ndryshe pos si myslimanë?

Në këtë pyetje ne ju përgjigjemi duke thënë se Allahu i madhëruar dëshiron që të na e tërheqë vëmendjen në atë se vdekje njeriut i vjen papritmas dhe në çdo çast. Pra, të jeni gjithnjë në Fenë islame që të mos t’ju befasojë vdekja, e të mos jeni tjerë pos myslimanë...

Allahu i madhëruar dëshiron që ne ta dimë se ngasja e shejtanit na bën të dalim nga mburoja obligative, e cila na shpie në xhenetin e amshueshëm në botën e ardhshme. Pastaj Allahu xh.sh. thotë:

إِنَّهُ يَرَاكُمْ هُوَ وَقَبِيلُهُ مِنْ حَيْثُ لَا تَرَوْنَهُمْ

“Vërtetë ai dhe shoqëria e tij ju sheh anipse ju nuk i shihni.”

(S. El-A'raf: 27)

Kjo do të thotë se shejtani na sheh e ne nuk e shohim atë. Andaj kjo i jep mundësi atij të na ngasë, ngase gjersa nuk e shohim ne nuk e dimë se nga e cila anë vjen... as të vëmë re se ai do të na bëjë vesvese. Por a thua na ka lënë ne Allahu i madhëruar në mëshirën e shejtanit që të na mashtrojë dhe të ngasë, apo ka caktuar masa mbrojtëse për ne?

Allahu xh.sh. ka dëshmuar drejtësinë e Vet caktoi masa mbrojtëse nga ky vesves i shejtanit dhe nga gjithë ajo e keqe. Masa mbrojtëse nuk bëhet ndryshe vetëm duke iu përmbajtur ligjit të Allahut dhe t' i përkushtohet atij... Nëse njeriu vepron ashtu, shejtani kurrë nuk mund t' i afrohet, a s ta mashtrojë. Si dëshmi për këtë po citojmë ajetin kur'anor:

“Pasha madhërinë Tënde! Do t' i mashtroj ata të gjithë pos adhuresit e Tu të sinqertë”.

Siç vihet në dukje nga ky ajet kur'anor shejtani pranoi se ai nuk mund t' i afrohet ...

Në këtë ajet kur'anor Allahu i madhëruar thotë:

إِنَّ عِبَادِي لَيْسَ لَكَ عَلَيْهِمْ سُلْطَانٌ إِلَّا مَنْ اتَّبَعَكَ مِنَ الْغَاوِينَ {42}

“Ti nuk ke kurrfarë kompetence ndaj robërve të Mi të sinqertë pos atyre të humburve që vijnë pas teje”.

(S.El_Hixhër 42)

Allahu i madhëruar ka siguruar mbrojtje për çdo rob-mysliman që ka besimin sinqertë në Zotin, që i bën adhurim Atij me dashuri të sinqertë.

Mu për këtë Allahu xh.sh. besimtarët e Vet të sinqertë i ruan nga ngasjet e shejtanit. Ai për këtë e përshkruan besimtarin (e sinqertë) me këto fjalë:

إِنَّ الَّذِينَ اتَّقَوْا إِذَا مَسَّهُمْ طَائِفٌ مِّنَ الشَّيْطَانِ تَذَكَّرُوا

فَإِذَا هُمْ مُبْصِرُونَ {201}

“Vërtet ata që i kanë drojën Allahut kur ndonjë sugjestion, i shejtanit i nxit ata, ata përkujtojnë (udhëzimin e) Allahut dhe atëherë shohin (të vërtetën)”.

(S.El-A'raf: 201)

Kjo do të thotë se shejtani nëse i prek besimtarët e sinqertë të njëmendët të Allahut, Allahu ata nuk i le të vetmuar, por ua përkujton ligjin e Tij. Atëherë ata shohin të vërtetën dhe fillojnë përsëri ta zbatojnë ligjin... Ai që ndjek rrugën e shejtanit është sikur i verbëri, i cili nuk sheh gjë, përpëlitet të ecën, merr në thua, rrëzohet e ngritët.

Shejtani rropatet që njeriut t'ia verbojë sytë të mos e shohë të vërtetën, argumentet e Allahut në gjithësinë e Tij dhe të mos shohë asgjë.

Allahu i madhëruar na e jep shembullin duke përshkruar-cituar fjalën e shejtanit kur do t'i thotë Allahut: në botën e ardhshme:

قَالَ رَبِّ لِمَ حَشَرْتَنِي أَعْمَى وَقَدْ كُنْتُ بَصِيرًا {125}

قَالَ كَذَلِكَ أَنْتَ آيَاتُنَا فَنَسِيئَهَا وَكَذَلِكَ الْيَوْمَ تُنْسَى {126}

“Ai do të thotë: O Zot! Pse më ke ngjallur të verbër kur më parë i kisha sytë? (Allahu) i thotë: ashtu siç i ke harruar (ca) argumente Tona ashtu je i harruar sot”

(S.Taha: 125,126)

Siç u vu në pah nga ajeti i sipërpërmendur detyra-rolit i shejtanit është që njeriut t'ia verbojë sytë e të mos i shohë argumentet e Allahut në Gjithësi, mos ta shohë madhështinë krijuese, as fuqinë e Allahut-Krijuesit të madhëruar. E atë që nuk i sheh këtë, ky veprim e bën që ai ta harrojë ta adhurojë Allahun, e bën që këtë botë ta trajtojë si qëllim kryesor të krijimit të njeriut e jo si urë kaluese për botën tjetër. Mu për këtë njeriu i tillë rropatet që të marrë nga kjo botë gjithçka, qoftë ajo gjë e lejuar apo e ndaluar, ngase gjersa për të nuk ka gjë primare pos kësaj bote, synim i tij është që nga kjo të rrëmbejë çdo gjë që i jepet rasti, në mënyrë ligjore apo kundërligjore. Për atë njeri kryesore është që standardin e tij të arrijë ta ngritë me epshe, dhunë... vjedhje, rryshfet etj.

Këto lloj të njerëzve kur të vijnë në botën e ardhshme Allahu do t'i ngjallë të verbër e s'do të shohin asgjë, përpëlitën dhe marrin në thua dhe rrëzohen. Kur të pyesin për shkakun e verbimit të tyre, ata më parë i kishin sytë në këtë botë, Allahu u thotë:

“Ishe i verbër në jetën e kësaj bote, në të vërtetë i kishe dy sytë, por t’i nuk shihje argumentet e Allahut në Gjithësi”. Kështu ti zure të mos zbatosh ligjin dhe të futesh në mosbesim. Andaj, ashtu siç i harrove argumentet e Allahut në këtë botë, po ashtu të harron Allahu i madhëruar në botën e ardhshme dmth. nuk do ta arrish mëshirën e Tij në këtë ditë...

وَمَنْ كَانَ فِي هَذِهِ أَعْمَى فَهُوَ فِي الْآخِرَةِ أَعْمَى وَأَضَلُّ سَبِيلًا
{72}

“Kush ka qenë i verbër në këtë (botë), ai do të jetë i verbër edhe në botën e ardhshme dhe më i humburi nga rruga e drejtë”.

(El-Isra: 72)

Fjala “I verbër” këtu nuk e ka kuptimin humbje e dritës së syve, por e shikimit (fuqisë së shikimit) me të cilën njeriu i sheh argumentet e Allahut të cilat e shpijnë në iman (besim) dhe zbatim të ligjit të Allahut...

Nga mëshira e Vet që pati, Allahu i madhëruar na i ka eksponuar-treguar ne mënyrat e shejtanit... se si ai e mashtron njeriun. Na e ka sqaruar mënyrën e shejtanit... se si ai e mashtron njeriun. Na e ka sqaruar mënyrën se si ai hyn në shpirtin e njeriut, mënyrën se si njeriu bie në mëkat. Ai na i ka shpjeguar të gjitha këtë në mënyrë që të kemi kujdes ndaj shtigjeve përmes të cilave shejtani i afrohet shpirtit të njeriut... në mënyrë që t’ia presim këto shtigje dhe të mos depërtoj shejtani në shpirtin tonë.

A thua cilat janë këto shtigje?

Kapitulli i pestë

SHTIGJET E SHEJTANIT... KAH NJERIU (MËNYRAT SE SI SHEJTANI I AFROHET NJERIUT)

Allahu i madhëruar na ka njoftuar se ekziston ngasje djallëzore, shtytje djallëzore, vesves shejtani dhe prekje shejtani. A thua ku qëndron dallimi mes këtyre? Cila është mënyra me të cilën shejtani hyn në shpirtin e njeriut? Si e shtyn ai njeriun të bëjë mëkat? Si ikën dhe e lë njeriun që ka bërë mëkat të vetmuar, pastaj si i arsyetohet atij?

Para se të fillojmë të përgjigjemi në këto pyetje, duhet medoemos të cekim se ka vesvese djallëzore edhe njerëzore dhe shtytje të tjera që njeriun e shpijnë në mëkat. Ndaj Allahu i madhëruar na ka njoftuar në Kur'anin famëlartë se individët shpirtrat i ndryshojnë. Ka shpirtra-individë me sjellje të mira, individë-shpirtra qortues dhe shpirtra me prirje për të bërë keq.

Shpirtrat e mirë (me veti të mira) janë ata që bëjnë vetëm vepra të mira. Shpirti qortues është ai i cili e fut trupin e vet në mëkat, por ai atë e qorton dhe e përmirëson që të bëjë prapë vepra të mira... Mbase njeriu i tillë bën mëkat disa herë...

Ndërkaq, shpirti me prirje për vepra të këqija, është ai që njeriut ia ka bërë shprehi të bëjë keq. Njeriu me atë shpirt (moral) nuk ka shenjë pendimi as denoncimi, por përkundrazi ai jeton me të keqen, u flet të tjerëve të bëjnë keq dhe tashmë e ka bërë shprehi atë, ashtu që ai nuk bën tjetër vepër pos të keqes dhe kënaqet me të!

Ka dy lloje vesveses:

1. Vesvesja e shejtanit drejtuar njeriut dhe
2. Vesvesja e vetë njeriut.

A thua si mund ta dallojmë vesvesen e shejtanit dhe atë të njeriut?

Në këtë pyetje mund të përgjigjemi si vijon:

Shejtani dëshiron që njeriu të jetë mëkatar në të gjitha fushëveprimet e tij... Atij nuk i intereson lloji i mëkatit, por mënyra se si ta shkaktojë atë. Për shembull, nëse orvatet ta mashtrojë njeriun me mall të fituar jo në mënyrë të ligjshme (haram) e nuk gjen përdalje (zina) dhe amoralitet. Por nëse dështon në atë drejtim, atëherë ai shpejton ta hijeshojë-shishmojë pirjen e alkoolit. Ai tenton ta mashtrojë me të, por nëse i mbyllet të gjitha shtigjet që shpijnë në mëkate, ai orvatet ta krijojë shprehinë e mosdëgjueshmërisë, ta bëjë atë, p.sh. të mburret se po jep sadaka dhe kështu t'i humbë "sevapet" (shpërblimet) e tij. Kur të vijë koha e namazit orvatet që ta ndalojë mos ta falë atë.

Duhet ta dimë se kjo ngasje (ky mashtrim) as vjen në mënyrë të detyrueshme e as të imponuar, ngase shejtani nuk është mbizotërues ndaj njeriut. Por, p.sh., kur thirret ezani për namaz ai e mashtron atë që të mos e fal namazin. Ai nuk e fal atë gjersa të mbarojë filmi, ia kujton punët që duhet t'i kryejë. Duhet t'i telefonojë një shoku të tij apo së pari të hajë darkë, ose ta bëjë një vizitë që e ka harruar... apo marifete (makinacione) të tjera të shejtanit.

Nëse njeriu është treguar, ai ia shtinë frikën në palcë se nëse njeriu falet do të humbë ca raste shitblerjeje e me to edhe profitin...

Ai në këtë mënyrë vazhdon ta fusë njeriun prej një problemi (telasheve) në tjetrin gjersa t'i kalojë koha e namazit apo ta largon atë nga një obligim i tillë në mënyrë graduale. Por nëse dështon në përpjekjet e tij, atëherë ai e bën "vesvese" në abdes dhe në namazin që e bën. I thotë: "*nuk ke marrë mirë abdes, merr edhe një herë*". Ai vazhdon ta vërë në dyshim për abdesin që e ka marrë gjersa të marrë abdes disa herë Pastaj ai e bën të dyshojë në namazin që e bën gjersa ta shtyjë ta falë atë disa herë.

Ai e bën njeriun të dyshojë në vet qenien-unin e tij... Njeriu nuk di se sa ka falur dhe se a ka marrë abdes mirë apo jo.

Prandaj, siç u vu në dukje, shejtani nuk zgjedh llojin e mëkatit, por ai përpiket për të bërë ndonjë mëkat.

Sa i përket vesveses së shpirtit, ai përshkruhet kështu: Vesvesja e shpirtit shprehet duke qenë këmbëngulës në kryerjen e një mëkati të caktuar. Vesvesja e shpirtit nuk do tjetër mëkat pos atij të caktuar dhe njeriun e shtyn- cyt që ta bëjë vetëm atë mëkat të caktuar dhe ta përsërisë atë disa herë. Ai nuk e cytë njeriun në mëkate tjera.

DALLIMI MES DY VESVESEVE

Në mënyrë që të njihemi me dallimin mes dy vesveseve po ia përkujtojmë lexuesit se atij që i pëshpërit njeriut nuk i intereson tjetër, gjë pos që njeriu të bëjë mëkat pa marrë parasysh llojin tij. Ai, pra është shejtani. Por nëse insistohet gjithnjë të bëhet një mëkat i caktuar në të cilin njeriu e përqendron vëmendjen, ajo lloj vesveseje është, pra, nga veta (egoja e njeriut).

Iblisi vjen gjithmonë nga shtegu në të cilin sheh përcaktim të dobët. Nëse ai has n[një njeri që është shumë i vendosur në një gjë të caktuar, atëherë ai afrohet nga ana tjetër ku njeriu është i dobët dhe jo i qëndrueshëm. P.sh. nëse njeriu është i vendosur –i përpiktë në namaz, e ruan kohen e tij dhe e kryen si duhet, Iblisi atij njeriu i afrohet nga aspekti i mallit. Ai i zë t'i pëshpëritë –bëjë vesvese njeriut që të mos japë zeqatën dhe të bëhet koprrac; të shfrytëzojë pasurinë e të tjerëve duke mos punuar; të krijojë në vete iluzione se kjo mënyrë e veprimit ia shton pasurinë, se do ta bëjë atë të pasur dhe do t'a largojë varfërinë.

Por e vërteta qëndron ndryshe siç thotë Pejgamberi i Allahut (Muhamedi a.s.) “*Malli nuk pakohet nëse jepet sadaka*”, përkundrazi sadakaja është ajo që e shton pasurinë, sjell bereqetin-begatinë e Allahut xh.sh., të shtohet e të rritet ajo. Pasuria është e Allahut dhe çdonjëri prej nesh atë pasuri e lë pas kur largohet nga kjo botë. Por atë që është jobesimtarë e bënë të pavëmendshëm ndaj kësaj të vërtete.

Kur Iblisi has në njeri, i cili është tejet i përpiktë në faljen e namuzeve e që e do pasurinë, ai i vjen atij nga ana e dobët,e ndalon njeriu të mos japë shakanë dhe lëmosha,pastaj e mashtron njeriun që të merret me mall të fituar në mënyrë jo të ligjshme (haram). Mëkatet fillojnë t'i vardisen në shpirtin tij si thura për t'a për ta përfshirë tërë zemrën dhe ta ndalojë atë të mos e përmend-falënderon Allahun xh.sh.

Lidhur me këtë po e përmendin rastin e Tha'lebesë, i cili kërkoi nga i Dërguari i Allahut që ai t'i lutet Allahut ta bëjë Tha'lebesë të pasur. I Dërguari Allahut xh.sh.i tha: *“Ti pak e falënderon Atë, e nëse Ai të çon shumë të mira, ti nuk do të mund ta falënderosh Atë (fare)”*.

Megjithatë Tha'lebe vazhdoi me këmbëngulësi të kërkojë... I Dërguari i Allahut xh.sh. iu lut Allahut për të. Atij (Tha'lebesë) iu shtua bagëtia

aq shumë sa që rrugët e qytetit mezi i nxinin atë kur kalonin... Ndaj, ai doli jashtë qytetit... Tha'lebe zuri të mungojë nga të falurit e namazit që e bënte me të Dërguarin e Allahut xh.sh. Një herë vinte për t'u falur me të, e herat tjera nuk vinte gjersa të falurit e kufizoi vetëm në namazin xhumasë (ditës së premtë). Më pas nuk vinte as në namazin e xhumasë. Më vonë hoqi dorë nga pagimi i zeqatit duke pandehur se ajo pagesë është tagër gjersa erdhi urdhri i Allahut të madhëruar:

وَمِنْهُمْ مَّنْ عَاهَدَ اللَّهَ لَئِن

آتَانَا مِنْ فَضْلِهِ لَنَصَّدَّقَنَّ وَلَنَكُونَنَّ مِنَ الصَّالِحِينَ {75}

{76} فَلَمَّا آتَاهُمْ مِنْ فَضْلِهِ بَخُلُوا بِهِ وَتَوَلَّوْا وَهُمْ مُعْرِضُونَ
فَأَعْقَبَهُمْ نِفَاقًا فِي قُلُوبِهِمْ إِلَى يَوْمِ يَلْقَوْنَهُ بِمَا أَخْلَفُوا

اللَّهِ مَا وَعَدُوهُ وَبِمَا كَانُوا يَكْذِبُونَ {77}

“Ka prej tyre sish që ia patën dhënë besën Allahut. Nëse u dhuron Allahu nga mirësia e Tij (me bollëk), ata do të japin lëmoshë (me të madhe) dhe vërtetë do të bëhen njerëz të mirë. Kur Ai u dhuroi prej dhuntive të Veta, ata u bënë koprracë ma atë(që u dha), e thyen besën dhe u larguan nga respekti ndaj Allahut. (Si pasojë e veprimit të tyre) Ai ua lidhi hipokrizinë në zemrat e tyre deri në atë ditë kur do të dalin para Tij), për shkak se ata thyen besën që ia kishin dhënë Allahut dhe për shkak se gënjyen.”

(Et-tevbe: 75-77)

Kur zbriti ky ajet kur'anor Tha'lebe-ja u shqetësua shumë; dhe shpejtoi ta dërgojë

përqindjen e zeqatit te i dërguari i Allahut xh.sh., por ai nuk e pranoi atë. Në kohën e Ebu Bekrit Tha'lebe-ja shpejtoi ta dërgojë

zeqatin te Ebu Bekri, por edhe Ebu Bekri refuzoi ta pranojë atë duke thënë:

“Nuk do të mund ta pranojë atë që e ka refuzuar i Dërguari i Allahut xh.sh”. Kur erdhi koha e sundimit të Omer Ibn Hattabit, Tha'lebe-ja ia ofroi zeqatin Omerit r.a. Edhe Omeri refuzoi ta pranoi atë. Tha'lebe-ja vdiq në kohën e sundimit të Omerit r.a.

Ky rrëfim vë në dukje se si shejtani ka shfrytëzuar pasionin që e ka një adhurues i Allahut në zemrën vet, për at bërë mospërfillës të urdhrave të Allahut xh.sh. dhe për ta larguar nga rruga e Tij; për ta futur në mëkate e mosbesim, Allahu na ruajt! Shembuj për gjëra të tilla ka mjaft... Shejtani kërkon ndonjë pikë të dobët te njeriu për të depërtuar në të përmes saj. Ai nuk heq dorë nga ajo gjersa ta hedhë njeriun në rrjetin e vet dhe ta largojë nga rruga e Allahut.

HULUMTIMI I PIKËS SË DOBËT

Kështu radhitën mënyrat e mashtrimit. Kur Iblisi has në robin besimtar, i cili është i përpiktë në kryerjen e namazit dhe në dhënie ne zeqate, e i dobët nga aspekti moralit. Ai për shembull i afrohet në këtë pikë të dobët dhe ia hijeshon një grua të shfrenuar dhe i bën vesvесе gjersa të bjerë njeriu në përdalje (zina) me atë grua, e njeriu me këtë veprim futet në mëkate të mëdha.

Por nëse robi besimtar është i vendosur që mos të bie në të gjitha këto gracka, atëherë Iblisi ia hijeshon pijet alkoolike, bixhozin, përgojimin ose përfolje. Ajo që është me rëndësi për Iblisin është synimi i tij që njeriun ta lërë rehat në çështje ku është i vendosur e t'i afrohet në ato ku është i dobët. Njeriu duhet të ketë kujdes se shejtani kur e nxit atë, i afrohet nga rruga e një të keqeje ndaj të cilës njeriu ka version, por Iblisi kësaj të keqeje ia mvesh një maskë mashtruese dhe e bën të dashurohet në vete (t'i hyjë vetja në huj), e bën të papërtueshëm dhe të dashuruar për të.

Nëse njeriu vuan nga një vështirësi ekonomike (problem financiar) atij i afrohet dhe ia hijeshon hajninë. Shejtani së pari e bën vesvесе atë që do ty cytë të vjedhë, duke bindur se ajo punë është shumë e thjeshtë (e lehtë) dhe kryhet lehtë e nuk do të zbulohet... Për shembull, i thotë shtyje të bjerë për tokë, këtë njeri të pasur pastaj

bëhu kinse po i ndihmon... njëherë të ngritët në këmbë duke i ndihmuar në mënyrë të pavërejtur vidhja portofolin.

Iblisi ia paraqet atë punë si të thjeshtë dhe të keqen ia mvesh me petk mashtrues, ia maskon. P.sh. ai zë ta mashtrojë një njeri që ta vjedhë një valixhe. I bën me dije se ku gjendet një plak, i cili ka një valixhe të rëndë. I thotë: *”Thuaj që ta japë për t’ia bartur për tu kujdesur për të ngase plaku është i dobët. E kur ta bartë valixhen... e bën vesvese duke i thënë: ”Shfrytëzoje pakujdesinë e tij (merrja atë) dhe ik!”*.

Shejtani e mashtron njeriun që ta marrë mallin e fituar në mënyrë jo të ligjshme. P.sh. ai person është stërshitës i të hollave (diler). Ai e bën vesvese se ka nevojë për para që i ka në arkë plaku, se ai do t’i marrë ato vetëm si hua. Ai vazhdon prapë të marrë kur i paraqitet nevoja e ngutshme, bankieri (arkëtari) merr paratë në mënyrë jo të ligjshme, por ato nuk mund t’i kthejë.

Shejtani nuk është i marrë që të paraqitet në figurën e së keqes, të duket se është keqdashës, as t’ia përkujtojë njeriut se do t’i nënshtrohet dënimit në këtë botë dhe në botën e ardhshme, por i qepet pas duke iu paraqitur se ai është ndjellamirë... se shejtani qarkullon në mendjen e njeriut siç qarkullon gjaku në trup.

Allahu nga mëshira e Vet që pati na e ka treguar stilin e shejtanit në mënyrë që ne të mund ta heqim qafe atë.

Shejtani kurrë nuk e lë njeriun të qetë gjersa ai vazhdon t’i përfillë urdhrat e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, por orvatet që në të depërtojë nga një pikë e dobët në tjetrën gjersa ta bëjë atë njeri për vete. Por, gjithmonë, nëse njeriu kërkon mbështetje dhe ndihmë nga Allahu, atëherë ai nuk mund të depërtojë në njeriun as mund ta mbizotërojë.

VESVESJA E SHEJTANIT NË NAMAZ

Allahu i madhëruar na ka paralajmëruar për metodën, të cilën shejtani gjithmonë e aplikon për të futur krijesën e Allahut në mëkat:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنَّمَا الْخَمْرُ وَالْمَيْسِرُ وَالْأَنْصَابُ وَالْأَزْلَامُ رِجْسٌ
مِّنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ فَاجْتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ { الآية 90 سورة المائدة }

“O ju që keni besuar, nuk ka dyshim se pijet alkoolike, bixhozi idhujt dhe shigjetat për fall janë vepra të ndyta që i nxit shejtani, pra largohuni prej tyre që të shpëtoni”.

(S.El-Maide: 90)

Kështu, pra, çdo njëri që jepet pas alkoolit apo pas lojës së bigjazit apo adhurimit të idhujve, përpjekjes për hedhjen e gurëve të fatit a leximit të fletëve apo ndonjë lloj mashtrimi për të njohur të fshehtat, njeriu i tillë kryen një vepër, të cilën ia hijeshon shejtani për ta larguar nga ibadeti (adhurimi) i Allahut dhe të kryejë punë jo të ligjshme (haram).

Allahu i madhëruar na ka paralajmëruar për një veprim të tillë duke thënë:

وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَاحْذَرُوا

“Binduni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe ruajuni (nga e keqja)...”

(S.El-Maide: 92)

Ky paralajmërim i Allahut ka për qëllim që të na mësojë se shejtani nuk do të na lërë të qetë të përfillim urdhrat e Allahut dhe porosinë e të Dërguarit të Tij... Ai do të tentojë në mënyrë intensive që të na pengojë në kryerjen e obligimeve. Nëse shejtanit ia mbyllim të gjitha shtigjet atëherë ai provon të na mashtrojë kur të marrim abdes, na bën të harrojmë se a i kemi larë duart apo jo... a kemi abdes apo jo. Më pas pasojnë përpjekjet e tij në kohën e namazit.

Na bën të harrojmë numrin e reqateve apo sexhdeve, mirëpo kjo nuk është shenjë e keqe, por shenjë për të mirën tonë: ngase shejtani nuk hyn kurrë “ngushtë”. Sikur namazi (lutja) ynë të ishte i papranuar, ai nuk do të na afrohej në të. Por afrimi i tij le të kuptohet se ai është i pranuar dhe se shejtani dëshiron ta prishë atë. Si për këtë posa të fillojë njeriu të falet, shejtani ia përkujton gjërat që i ka harruar dhe i pëshpëritë pandërprerë duke u përpjekur t’ia prishë namazin njeriut.

Si vesvese e shejtanit është gjithashtu ajo se ai orvatet që besimtarët të nxitë të mos i përfillin porosinë e të Dërguarit të Allahut a.s. dhe u thotë: “Për këtë çështje nuk është bërë fjalë në Kur’an pra, mos e përfill këtë”. Megjithatë, Allahu xh.sh. ka thënë:

فَلْأَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ

“Thuaju: Respektojeni-Binduni Allahut dhe të Dërguarit të Tij...”

(S.En-nur: 54)

Allahu i madhëruar e ka autorizuar të Dërguarin e Vet a.s.për të dhënë-caktuar ligje dhe porosi duke thënë:

وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمُ عَنْهُ فَانْتَهُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ {7}

“Atë që ua porosit i Dërguari i Allahut merreni, e çka jua ndalon përmbahuni...”

(S.El-Hashër: 7)

I Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: ”

“Njeriu shejtan, i mbështetur në kolltuk, duke biseduar për fjalën e një hadithi tim dyshon në të dhe thotë se ne dhe ju, kemi përpara Librin e Allahut xh.sh. çka hasim në të që e ka lejuar e punojmë, e çka e ka ndaluar të mos e punojmë, ngase ajo që e ka ndaluar i Dërguari i Allahut nuk është sikur ta ketë ndaluar Allahu xh.sh.”

Metodat që shejtani i shfrytëzon për ta mashtruar njeriun janë të ndryshme. Në to bëjnë pjesë: ngasja, futja në zemër me dhëlpëri, vesvesja dhe “prekja” (të bërit për vete).

Fjala “nezg” nënkupton nxitje dhe dallohet nga fjala “lemes” që do të thotë prekje ngase mes nxitësit (shtytësit) dhe të nxiturit është një largësi, ndërsa prekja e lehtë bëhet drejtpërdrejt, aty nuk ka largësi, por njeriu nuk ndjen as e heton ngrohtësinë e të prekurit. Ndërkaq, kontakti nënkupton ngrohtësinë e prekses.

Pra, siç shihet, janë tri faza të kontaktit: ngasja, prekja dhe të bërit për vete. Ngasja e shejtanit manifestohet kur ai hyn në zemrën e njeriut në mënyrë shqetësuese dhe stimuluese dhe shkakton mllëfin. Njeriu e bën që të mllëfoset dhe të sillet në mënyrë aq të marrë, sa që ajo as përputhet me logjikën e tij, e as me parimet fetare.

Mu për këtë i Dërguari i Allahut, e ka pyetur Allahun duke i thënë:

“Si, o Zot, ta evitohet zemërimin”. Allahu i madhëruar i ka thënë:

وَأِمَّا يَنْزِعَنَّكَ مِنَ الشَّيْطَانِ نُرْعُ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ إِنَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ {200}

“Nëse shejtani të godet me ndonjë vesvese kërkohet strehim nga Allahu...”

(S.El-A'raf: 200)

Ne këtu nuk po e shtjellojmë këtë çështje lidhur me të Dërguarin e Allahut a.s. Përndryshe e dimë se ka njerëz që shtrojnë pyetje të tilla p.sh. “A mund ta nxisë shejtani të Dërguarin e Allahut a.s....”

Personave të këtyllë mund t’u themi se në ajetin e sipërm kur’anor nuk thuhet “kur”por”nëse” që do të thotë se mund të ngjajë një veprim i tillë (që shejtani ta nxisë të Dërguarin), por mund të mos ngjajë.

Pra, këtu kjo çështje ka ngjallë një dyshim dhe nuk është e sigurt se në të ardhmen një gjë e tillë nuk do t’i ndodhë të Dërguarit e Allahut a.s. Po supozojmë se ka ndodhur një gjë e tillë, atëherë shtrohet pyetja: “Pse t’i ndalojë Allahu të Dërguarit të Vet që të ballafaqohet me shejtanin ta godasë dhe ta mposhtë atë?”

I Dërguari i Allahut ka thënë:

“Çdo njëri prej jush ka dy shejtanë”. Ata i thanë

“Edhe unë i kam, - tha i Dërguari i Allahut, *por Allahu më ka ruajtur nga njëri, i cili është bërë mysliman dhe tash ai nuk më cytë të bëj tjetër pos vepra të mira*”.

Një ditë, kur i Dërguari i Allahut a.s. po shkonte në xhami iu paraqit shejtani. Për këtë rast i Dërguari i Allahut ka thënë:

“*Dy afrita të xhindeve dje mu paraqitën-duke ma tërhequr vëmendjen për të më penguar ta fal namazin, por Allahu më ndihmoi e mposhta (ngulfata) dhe desha t’i lidh për një shtyllë të xhamisë që t’i shihni që të gjithë. Mu kujtua fjala e vëllait tim Sylejmanit a.s. kur kishte thënë:*

-O Zot, më fal mëkatet dhe më jep pushtet që të mos ketë kush dëshirë më të madhe pas meje”, e Allahu e bëri atë (shejtanin) të poshtëruar...

Pra, siç vihet në dukje, ballafaqimi mes të dërguarve dhe shejtani ka ngjarë dhe me ç’rast ka pasuar humbja e menjëhershme e shejtanit. Allahu i madhëruar nga i Dërguari i Vet a.s. ka kërkuar që ai t’i kërkojë mbështetje Allahut, e të kërkojë mbështetje do të thotë të kërkojë ndihmë. Njeriu nuk kërkon ndihmë prej askujt pos prej Atij që është më i fuqishëm se ai dhe më i fuqishëm se ai që tenton ta sulmojë njeriun.

MBIZOTËRIMI I ELEMENTIT DJALLËZOR

Shejtani ka karakteristika të shumta me të cilat dallohet nga njeriu. Ndër to është lëvizja e tij e fshehtë, pamundësia e njeriut për të parë atë, mundësia e tij për të depërtuar në mendjet tona... Pra, prej nesh lypset që të kërkojmë ndihmë nga Ai që është më i fuqishëm, e s'ka gjë më të fuqishme ndaj shejtanit pos Krijuesit të Gjithësisë[. Allahu dëgjon gjithçka dhe është i gjithëdijshëm. Ai dëgjon kërkesat tona që ia drejtojmë Atij dhe e di për çka lutemi – kërkojmë mbështetje...

Duhet vënë re se Allahu xh.sh. ndryshe i është drejtuar të Dërguarit të Vet a.s., e ndryshe “ummetit” (komunitetit) të tij. Kur i foli të Dërguarit të Vet i tha:

“Nëse shejtani të nxit për diç, ti kërko mbështetje nga Allahu se Ai dëgjon dhe është i gjithëdijshëm”. Por kur iu drejtua “ummetit” të Dërguarit a.s. tha:

إِنَّ الَّذِينَ اتَّقَوْا إِذَا مَسَّهُمْ طَائِفٌ مِّنَ الشَّيْطَانِ تَذَكَّرُوا

فَإِذَا هُمْ مُبْصِرُونَ { 201 }

“Vërtetë ata që i frikësohen Allahut, kur i prek ndonjë mendje (e keqe) e shejtanit, ata përkujtojnë Allahun dhe atëherë shohin (të vërtetën)”.

(S.El-A'raf: 201)

Pra, kur Allahu i madhëruar foli për besimtarët, Ai foli për “prekjen” (*el-lemesu*). Por nga mëshira e Vet, Ai nuk foli për fazën e mëshirimit, ngase shejtani nuk mëshirohet me njeriun besimtar... por ai qëndron në një largësi të afërt. A thua ç'ndodhi në këtë rast?

Besimtarit mysliman i kujtohet fuqia e Allahut që e ka ndaj shejtanit... Besimtarëve u kujtohet fakti se zbatimi i urdhrave të Allahut i mbron ata nga shejtani. E, dihet mirëfilli se shikimi i Zotit asnjëherë nuk është i pavëmendshëm ndaj robërve të Tij... Për këtë Allahu i madhëruar thotë në hadithin kudsij:

يا عبادي إن كنتم تعتقدون أنني لا أراكم فالخلل في إيمانكم، و إذا كنتم تعتقدون أنني أراكم فلم جعلتموني أهون الناظرين اليكم

“O robër të Mi, nëse mendoni se Unë nuk ju shoh atëherë keni zbrazëti në besimin tuaj, e nëse besoni se Unë ju shoh, atëherë përse më konsideroni se unë shumë pak ju shoh (se çka veproni)?”

Thamë se shejtani ka aftësi ngasjeje, shtytjeje, vesveseje dhe prekjeje. Kemi folur për mënyrën e ngasjes, e cila, siç thamë, shejtani me të hyn në zemër të njeriut, e ngacmon atë, ngjallë zemërimin, ia merr mëndët dhe e nxit të bëjë diç nga i cili veprim Allahu mlllefoset shumë.

Sa i përket shtytjes, shejtani e manifeston atë përmes një zëri të butë e të ngjirur në përpjekje që ta përgatisë njeriun që ai të bëjë atë që është mëkat. Ndërkaq vesvesja e shejtanit është përpjekje e përhershme e tij, që shfaqet në pikat e dobëta të njeriut duke u përpjekur që të mbjellë dashuri te ai dhe të bëhet mospërfillës i urdhrave të Allahut. Ky pra, është edhe synim i përhershëm i shejtanit, por edhe mision i tij.

Por a thua ç’është “prekja”, respektivisht si manifestohet prekja e shejtanit? Allahu i madhëruar për ata që punojnë me kamatë-fajde thotë:

الَّذِينَ يَأْكُلُونَ الرِّبَا لَا يَقُومُونَ إِلَّا كَمَا يَقُومُ الَّذِي
يَتَخَبَّطُهُ الشَّيْطَانُ مِنَ الْمَسِّ

“Ata që e hanë kamatën nuk ngritën ndryshe por si ngritët i çmenduri nga të prekurit e djallit...”

(S.El-Bekare: 275)

Pasi që shejtani ka prekur qenien e njeriut ai ka prishur integritetin e talentit-aftësisë së tij. Qenia e njeriut ka një integritet të talenteve-dhuntive, kështu që çdo lëvizje koordinohet me lëvizjen tjetër.

Kur shejtani e prek ndonjë njeri, ai njeri humb harmoninë e lëvizjeve të gjymtyrëve të trupit të vet. Talentet-dhuntitë e tij humbin njëra tjetrën dhe lëvizjet e tij bëhen të çrregulluara dhe alogjike. Nëse duam ta përshkruajmë këtë veti në botën e ardhshme, ajo, pra, është një veti e cila i dallon ata që merren me kamatën. Pos nëse e përshkruajmë atë në këtë botë, atëherë ajo është veti e lëvizjeve të palogjikshme të njeriut, kështu që karakterizohet me historinë. Kur sot meditojmë për botën se çka po ndodh, atëherë shohim se në të

mbretërojnë trazira dhe lëvizje hysterike... kur njeriu i rritur të hyjë në shkollën e fëmijëve, kur as s'e njuh kënd as ka armik që gjendet në të... Ai vret çdo fëmijë pa asnjë arsye... apo njeriu vjen te njeriu që nuk e njuh dhe me të bie nën rrotat e Metrosë, siç po ndodh këto ditë në Nju-Jork.

INTEGRIMI NUK ËSHTË PËRSËRITJE

Allahu i madhëruar e ka krijuar botën në formë të integruar e jo në formë të përsëritjes. Mu për atë u dalluan dhuntitë dhe potencialet... njeriu u rrit u zhvillua në këtë botë. Logjika e tij kërkonte që të jetojë në këtë botë në mënyrë të rehatshme dhe të qetë, ngase qytetërimi i ka sjellë frytet më të mëdha me mund më të vogël dhe për një kohë mjaft të shkurtër.

Por a thua është bota në të cilën jetojmë botë e logjikshme në këtë realitet?

Jo, sepse ne hasim vende sot më të pasura në botë, ekonomisht më të zhvilluara. Në ato vende të tilla njerëzit, megjithatë, vuajnë nga sëmundjet shpirtërore, shqetësimi, mjerimi, depresioni, dëshpërimi, tronditja, çoroditja dhe vetëvrasja. Kjo botë, në të cilën po ankohe mi sot nuk shkon sipas programit të caktuar të Allahut, por sipas epshit dhe ngasjes së shejtanit. Për këtë arsye këtë botë e ka kapluar histeria, kontradiktat-mospajtimet, tronditja, çrregullimi dhe kaosi. Bota sot po ecën shtigjeve... në përputhje me paralajmërimin e Allahut:

الَّذِينَ يَأْكُلُونَ الرِّبَا لَا يَقُومُونَ إِلَّا كَمَا يَقُومُ الَّذِي يَتَخَبَّطُهُ الشَّيْطَانُ
مِنَ الْمَسِينِ

... dhe nuk ngritët ndryshe pos si ngritët i çmenduri nga të prekurit e djallit..."

(S.El-Bekare: 275)

A thua pse nuk e kanë hulumtuar studiuesit fshehtësinë e kësaj jete plot vuajtje?

A nuk kanë mundur studiuesit t'i shtrojnë pyetje vetvetes pse vuajmë kështu?

Përparimi që e kemi arritur në të mirat materiale nuk siguron mirëqenien njerëzore. Pse ata nuk e kanë studiuar këtë çështje? Ata duhej ta bënin këtë.

Në qoftë se kjo sprovvë është e përgjithshme, siç thamë më parë, pra ajo nuk i kursen as vendet e pazhvilluara (të prapambetura). Kjo sprovvë-vuajtje i përfshin të gjitha vendet. Mu për këtë duhet të jetë një shkas i përbashkët. Një studim i mirëfilltë i kësaj çështjeje do të vinte në pah se njerëzimi është larguar nga rruga e Allahut. Bota për në është bërë pikësynimi kryesor për të jetuar, e nuk është kuptuar si urë... kalimi (për në botën tjetër). Malli dhe veglat e ndryshme janë bërë objektivi parësor, e jo si mjete të domosdoshme për të punuar tokën dhe për të jetuar. Pasuria është pronë e Allahut. Askush nuk e posedon atë. Kur të vdesim, mallin e kësaj bote e lëmë në këtë botë. Atëherë pse e kemi ndërruar destinimin e tij dhe e kemi bërë objektivi parësor?

Në këtë mund të përgjigjemi me një fjalë:

1. E tërë kjo botë nuk mund të jetë pikësynim kryesor i jetës, ngase jeta në të është e kufizuar dhe ka mbarim.
2. Gjësendet tona janë të pakta.
3. Mbetja gjallë nuk është e garantuar në të. Njeriu nuk mund ta sigurojë jetën e vet, as për një orë.

Nëse duam ta definojmë misionin e shejtanit me pak fjalë, themi se detyra parësore e tij është që njeriun ta bëjë të harrojë se Allahu ekziston. Ai dëgjon dhe sheh... po qe se i kujtohet në mendje se Allahu e sheh dhe se do ta dënojë atë për veprat e tilla që i bën. Sikur t'i kujtohej njeriut dënimi i Allahut në çastin e kryerjes së krimit, ai nuk do të bënte krim. Por shejtani, misioni i të cilit është të na bëjë që të harrojmë se Allahu ekziston, ai arrin ta bëjë atë. Njeriu që bën mëkat fshehtas mendon se gjersa ai është larguar nag syri i njerëzve, askush nuk e ka parë dhe harron se Allahu dëgjon dhe e sheh dhe asgjë nuk mund të fshihet nga Ai...

Në përfundim të këtij kapitulli po shtojmë edhe këtë: Plani i shejtanit është që të zbulojë pikën e dobësisë së njeriut që përmes saj të depërtojë në të, e me të depërtuar ai na e pasqyron mëkatin në formë (tablo) të dashur për shpirtin tonë. Ai na e largon vëmendjen tonë në mënyrë të shtrembëruar si vepër e mirë. Puna e tij më e madhe është si t'i mashtrojë ata që i përfillin urdhrat e Allahut. Ai kurrë nuk i lë rehat ata. E ngas njeriun dhe nxit mllëfin, i pëshpërit si t'i bëjë më lehtë të këqijat.

Njeriun ai e bën vesvese dhe ia hijeshon mëkatën. E bën të dashurohet bën vete . Nëse ai arrin ta prekë njeriun dhe ta humbë harmoninë e lëvizjeve të tij, sjelljet e tij bëhen një lloj histerie dhe çoroditje.

Shejtani ka metoda të shumta të ngasjes-mashtrimit, por Allahu i madhëruar i ka marrë në mbrojtje të Vet robërit e Vet besimtarë që ata të bëjnë rezistencë dhe ta kundërshtojnë shejtanin, ndërsa ia ka lënë të lirë robërit e Tij jobesimtarë që ai t'i shpijë ata në humbje të pafund dhe në mëkat. Allahu xh.sh, nuk e mbron jobesimtarin as s'e përdhë atë.

Kapitulli i gjashtë

SHEJTANI DHE USHTRIA E TIJ

Me dëshirë që të përfundojmë pasqyrimin e shejtanit po shtojmë edhe këtë: Ekzistojnë ushtri të shejtanit. Ushtri e përbërë nga njerëzit dhe xhindët dhe ushtri jofizike që e angazhon për t'i larguar njerëzit nga rruga e drejtë. Në fillim të shtjellimit të temës, që pasqyrimi të jetë i qartë, duhet cekur se as shejtani e as ushtria e tij nuk mund të dalin nga mbizotërimi faktik i Allahut të madhëruar në gjithësinë e Tij. Allahu xh.sh. na ka vënë në sprovë praktike, të mos u nënshtrohemi shejtanëve, të cilët janë me elemente më të larta si krijesa. Flitet për një njeri Profet i Zotit, e ai është Sylejmani a.s. Ai Profet i detyroi djajtë që ta përfillin urdhrin e tij deh ata (djajtë) nuk mund ta kundërshtojnë. Për këtë lexo fjalën e Allahut të madhëruar në Kur'an:

وَمِنَ الْجِنَّةِ مَن يَعْمَلُ بَيْنَ يَدَيْهِ بِإِذْنِ رَبِّهِ وَمَن يَزِغْ مِنْهُمْ عَنْ أَمْرِنَا نُذِقْهُ مِنْ عَذَابِ السَّعِيرِ .

“... Dhe ia nënshtroam xhindët që punon sipas dëshirës së tij, me lejen e Zotit të tij, e kush largohet prej tyre nga urdhri Jonë, atij do t’ia bëjmë që ta shijojë dënimin e zjarrit”.

(S. Sebe: 12)

Në këtë mënyrë Allahu ia nënshtroi xhindët-shejtanët e tyre dhe besimtarët e tyre, siç thamë, njeriut të krijuar nga dheu,e ai ishte Sylejmani a.s.

Sikur të donte Allahu i madhëruar që shejtanët të na nënshtrojnë neve, ata do të na nënshtroinin. Por allahu nuk e ka bërë një punë të tillë.

Ai iu përgjigj lutjes së Sylejmanit a.s. kur ai e luti Atë duke i kërkuar pushtet që Allahu s'i kishte dhënë askujt pos tij. Për këtë lexo ajetin kur'anor:

قَالَ رَبِّ اغْفِرْ لِي وَهَبْ لِي مُلْكًا لَا يَنْبَغِي لِأَحَدٍ مِّنْ بَعْدِي إِنَّكَ أَنْتَ
الْوَهَّابُ {35}

فَسَخَّرْنَا لَهُ الرِّيحَ تَجْرِي بِأَمْرِهِ رُخَاءً حَيْثُ أَصَابَ {36}

وَالسَّيَاطِينَ كُلَّ بَنَّاءٍ وَعَوَّاصٍ {37}

وَأَخْرَيْنَ مُفْرِّقِينَ فِي الْأَصْفَادِ {38}

“Dhe tha: “O Zot më fal dhe më dhuro pushtet të cilin askush pas meje nuk do ta ketë, vërtetë Ti je dhurues i madh. Pastaj Ne ia nënshtroam erën që sipas urdhrit të tij ajo ecën lehtë kah të dëshirojë ai. Edhe djajtë gjithashtu ia nënshtroam për çdo ndërtim dhe zhytje në ujë dhe të tjerë që ishin të lidhur në pranga.”

(S. Sad: 35,36,37,38)

Pra, Allahu i madhëruar, kur dëshiroi t'ia nënshtrojë shejtanët njeriut, Ai ia nënshtroi ata me dhunë përkundër vullnetit të tyre. Askush mos të mendojë se shejtanët e bëjnë atë që e bëjnë përkundër vullnetit të Allahut. Por, siç thamë, ajo është pikërisht si çështje e kësaj bote që të ketë ngasje... Gjatë jetës në tokë do të ketë luftë të pakompromis ku do të shfaqet besimi. Nëse myslimanët ia dalin të fitojnë më luftërat dhe besimin e tyre nga ngasja e shejtanit, ata do të meritojnë shpërblimin me xhenet.

Siç thamë, shejtani ka ushtri të dukshme (fizike) dhe jofizike.

Nga ushtria më e madhe jofizike është ajo që ndjell vetëmashtrimi.

Kjo ushtri vazhdon t'i sillet përreth gjersa të ndjellë në zemrën e tij vetëmashtrimin.

Orvatet që ta bëtë njeriun të mashtrohet me mallin e tij, dijen, fuqinë e tij apo që njeriu të mashtrohet e të mendojë se ai ia del të bëjë çmos pa ndihmën e Allahut të madhëruar, t'ia atribuojë meritat vetes për çdo sukses që ka rritur në jetë, për çdo gjë dhe në këtë mënyrë të bëjë mëkat dhe të futet në mosbesim.

ORVATJET E SHEJTANIT NË LUFTËN BEDRIT

Tash të shohim se ç'bëri shejtani në Luftën e Bedrit me jobesimtarët në nxitje të tyre për t'i luftuar besimtarët. Kur'ani fisnik na njofton për të këtë ngjarje ku thuhet:

وَإِذْ زَيْنَ لَهُمُ الشَّيْطَانُ أَعْمَالَهُمْ وَقَالَ لَا غَالِبَ لَكُمْ الْيَوْمَ مِنَ
النَّاسِ وَإِنِّي جَارٌّ لَكُمْ فَلَمَّا تَرَآءِ الْفِتْنَانَ نَكَصَ عَلَى عَقْبَيْهِ وَقَالَ
إِنِّي بَرِيءٌ مِّنْكُمْ إِنِّي أَرَىٰ مَا لَا تَرَوْنَ إِنِّي أَخَافُ اللَّهَ وَاللَّهُ شَدِيدُ الْعِقَابِ
{48}

(Dhe kujtoje) kur shejtani ua hijeshoi veprat e tyre e u tha: “S’ka kush prej njerëzve që sot mund t’ju mposhtë, se unë jam afër jush.” E kur u ballafaquan të dy forcat, ai u tërhoq prapa dhe tha: “Unë tërhiqem prej jush. Unë shoh çka nuk shihni ju, unë i frikësohem Allahut sepse, Allahu ndëshkon shumë ashpër”.

(S. El-Enfal: 48)

Ky ishte roli i shejtanit në Luftën e Bedrit. Ai zuri të ndjellë mendjemadhësinë në zemrat e jobesimtarëve dhe u tha: “do të luftoni dhe do të fitoni nga besimtarët... Ju jeni më të fuqishëm për nga pajisja ushtarake dhe me mjete, e ata janë në numër të vogël se ju... dhe ju me siguri do t’i mposhtni. Edhe unë jam me ju dhe do t’ju sjellë fitoren.”

Ai vazhdoi të ndjellë mendjemadhësinë në shpirtrat e jobesimtarëve. Ua hijeshonte se janë më të fuqishëm dhe se gjithsesi do të dalin gjersa ata i besuan atij dhe shkuan të luftojnë të Dërguarin e Allahut a.s. dhe besimtarët që ishin me të.

Kur arritën jobesimtarët në vendin e fushëbetejës aty zhvillohej luftë vendimtare. Shejtani e pa fuqinë e besimit dhe furinë e besimtarëve dhe përkrahjen e Allahut që ua kishte dhënë. Ai ua mbathi këmbëve me të shpejtë dhe ia la të vetmuar ithtarët e vet, të cilëve ju kishte thënë se askush nuk t'i mundë. Ai zuri të ikë larg prej tyre dhe siç na njofton Kura'ni fisnik, ai u tha:

إِنِّي بَرِيءٌ مِّنْكُمْ إِنِّي أَرَىٰ مَا لَا تَرَوْنَ إِنِّي أَخَافُ اللَّهَ وَاللَّهُ
شَدِيدُ الْعِقَابِ .

Unë po shoh atë që nuk e shihni ju dhe i frikohem Allahut se Allahu është shumë i ashpër në dënim”.

Disa studiues këtu bëjnë disa komentime. Shejtani thotë: ”unë i frikohem Allahut...”, e nëse iu frikuaka Allahut të madhëruar, pse atëherë ai bën mëkat dhe është këmbëngulës të bëjë edhe më tej?

Prej çka frikohet shejtani kur ai është i dëbuar nga mëshira e Allahut, është i mallkuar dhe i dënuar me zjarr të xhehenemit përgjithmonë sikurse edhe të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij?

Atyre njerëzve që mendojnë kështu ju përgjigjemi si vijon:

Shejtani i frikohet dënimit që e pret në botën e ardhshme, e kjo frikë e kaplon atë përkundër gjithë asaj që e bën ai në këtë botë... Ai e arsyeton çdo mëkat që e ka nxitur me duar të veta, duke e mohuar dhe i ikur përgjegjesisë para Allahu. Allahu i madhëruar thotë:

كَمَثَلِ الشَّيْطَانِ إِذْ قَالَ لِلْإِنْسَانِ اكْفُرْ فَلَمَّا كَفَرَ

قَالَ إِنِّي بَرِيءٌ مِّنْكَ إِنِّي أَخَافُ اللَّهَ رَبَّ الْعَالَمِينَ { 16 }

“Ata janë të ngjashëm me djallin kur i thotë njeriut: “mos beso” e kur njeriu e mohon Zotin, atëherë ai thotë: “unë jam larg teje, unë vërtetë i frikohem Perëndisë, Zotit të Gjithësisë!”.

Shejtani në këtë mënyrë tenton ta mohojë përgjegjësinë që mban për mashtrimin e njeriut, futjen e tij në mosbesim dhe nxitjen e tij të bëjë mëkate gjer në Ditën e Gjykimit, atë ditë kur do të dalë para Allahut dhe do t’ia hedhë fajin njeriut dhe do të tentojë t’i ikë përgjegjesisë. Për këtë ngjarje se si do të ndodhë. Allahu na e përshkruan në Kur’an, kur thotë:

وَقَالَ الشَّيْطَانُ لَمَّا قُضِيَ الْأَمْرُ إِنَّ اللَّهَ وَعَدَكُمْ وَعَدَ الْحَقَّ وَوَعَدْتُكُمْ فَأَخْلَفْتُكُمْ وَمَا كَانَ لِي عَلَيْكُمْ مِنْ سُلْطَانٍ إِلَّا أَنْ دَعَوْتُكُمْ فَاسْتَجَبْتُمْ لِي فَلَا تَلْمُزُونِي وَلَوْمُوا أَنْفُسَكُمْ مَا أَنَا بِمُصْرِخِكُمْ وَمَا أَنْتُمْ بِمُصْرِخِيَّ

{ 22 } إِيَّيْ كَفَرْتُ بِمَا أَشْرَكْتُمُونِ مِنْ قَبْلُ إِنَّ الظَّالِمِينَ لَهُمْ

عَذَابٌ أَلِيمٌ

“Shejtani do të thotë pasi të kryhet çështja (gjykimi):

“Vërtetë Allahu ju ka premtuar diç të vërtetë, edhe unë ju kam premtuar por ju kam mashtruar. Unë nuk kam pasur pushtetin mbi ju, vetëm t’ju thërras e ju më jeni përgjigjur, prandaj mos më qortoni mua por veten tuaj. Unë e mohoj atë që ju më parë më konsideroni të barabartë me Të. S’ka dyshim se jobesimtarët i pret dënim i dhembshëm.”

(S. Ibrahim: 22)

Shejtani, i cili ia hijeshoi njeriut të gjitha mëkatet dhe mosbesimin, e kur të vijë Dita e Gjykimit ai do ta arsyetojë atë që e ka bërë dhe do të orvatët t’ia hedhë fajin njeriut. Ai do të thotë: unë ju kam ftuar e ju më jeni përgjigjur... e sikur të mos donit mosbesimin dhe mëkatën në zemër dhe anoni kah ato, unë nuk do të mundja t’ju nxisja që të jeni mospërfillës të urdhrave të Allahut. Pra, mos më qortoni mua, por veten tuaj. Ju keni dëgjuar për ngasjen time, e unë nuk kam pasur fuqi që t’jua imponoj kryerjen e mëkateve. Kjo është e vërtetë, se shejtani nuk ka fuqi ta detyrojë njeriun për të mos përfillur urdhrat e Allahut xh.sh.

NUK DO TË PASOJË DËNIMI PËR GJËRAT E IMPONUARA

Nga dëshmitë për mëshirën e Allahut ndaj robërve të Tij, është edhe fakti se çdo gjë që kryhet në mënyrë të detyruar (jo me vullnetin e njeriut) njeriut nuk ia shënon në mënyrë që gjykimi të jetë i drejtë. Pra, për çdo gjë i imponohet njeriut dhe e bën atë përkundër vullnetit të vet ai nuk do të merret në përgjegjësi Dinë e Gjykimit, e këtë e vërteton e vërteton Allahu i madhëruar:

مَنْ كَفَرَ بِاللَّهِ مِنْ بَعْدِ إِيمَانِهِ إِلَّا مَنْ أُكْرِهَ وَقَلْبُهُ مُطْمَئِنٌّ بِالْإِيمَانِ

“Ai që pas besimit e tij mohon Allahun, pos atij që është i shtrënguar, por që zemra e tij është e bindur në besim...”

(S. En-nahl: 106)

Në këtë mënyrë ai që nuk i pëlqen ta shpallë botërisht mosbesimin, zemrën e ka të besimtarit, ai nuk merret në përgjegjësi për atë gjë. Allahu i madhëruar e ka bërë objekt të marrjes atë që e beson zemra, e cila nuk i nënshtrohet asnjë dhune, por njeriu mund ta nënshtrojë atë që të veprojë çka të dëshirojë përkundër bindjes së saj. Por njeriu nuk mund ta detyrojë kurrë zemrën që të dashuroj (dojë) njeriun tjetër që ai e urren, as ta detyrojë zemrën të besojë në atë që nuk do të besojë.

Allahu i madhëruar na njofton se shejtani nuk është mbizotërues ndaj njeriut. Mbizotërimi ose është detyrim që njeriun e shtyn të veprojë diç përkundër tij me dhunë, ose është mbizotërues i arsyes e që njeriu të bindet të punojë diç dhe atë e bën me vullnetin e vet. Shejtani në të rastet nuk posedon fuqi mbizotëruese as fuqi preteksti, por ai, siç kemi thënë, depërton në njeriun përmes pikave të dobëta. Njeriut ia hijeshon atë që e do gjersa të bëjë mëkat. Ajeti kur’anor thotë:

مَا أَنَا بِمُصْرِحِكُمْ وَمَا أَنْتُمْ بِمُصْرِحِيَّ

“Unë nuk mund t’ju ndihmoj juve e as ju mua”.

(S. Ibrahim: 22)

“Mesrihikum” që do të thotë shpejto për t’i ndihmuar atij që ta shpëtosh. Në këtë rast ne patjetër gjejmë fuqi për të dalë në ndihmë...

P.sh. nëse një hajn sulmon ndonjë person dhe ai kërkon ndihmë duke bërë titur, atëherë për shpëtimin e tij nuk mund t’i ofrojmë ndihmë askush pos një njeriu të fortë (fuqishëm), i cili e mposht sulmuesin. Por, nëse njeriu që ka dëgjuar thirrjen është plak i mbetur, atëherë ai nuk mund ta ndihmojë atë njeri ose ta shpëtojë atë.

Shejtani thotë: Unë nuk kam fuqi t’ua heq shkaqet e klithjes suaj nga ndëshkimi se edhe unë do t’i nënshtrohem atij bashkë me ju. Pastaj u arsyetohet atyre që nuk besuan prë shkak të ngasjes së tij. Ai orvatet t’i ikë përgjegjësisë dhe siç na njofton Kur’ani fisnik, ai thotë:

“... Unë mohova atë që më bëtë shok me Zotin”.

Pra, arma e parë e tij është mashtrimi që t'ia pasqyrojë njeriut se ai mund ta realizojë vetë atë që dëshiron dhe e shtyn që njeriu ta dhurojë veten, mendjen, mallin apo të besoj se është më i aftë se Allahu i madhëruar, të vërë legjislacion, ndaj edhe largohet nga rruga e Allahut dhe ligjet e tij. Ai vë ligjet e vetë siç i quajmë ligje të situatës për gjithçka që shohim.

Duhet ta dimë se shejtani ka ushtri të dukshme, e ajo përbëhet nga djajtë e njerëzve dhe të xhindëve. Ata janë, pra, prej radhës së atyre që kanë ndjekur rrugën e tij dhe kanë marrë planprogramin e tij, luftojnë për papunësi, luftojnë të vërteten, i nënshtrijnë besimtarët. E për këta Allahu i madhëruar thotë:

اسْتَحْوَذَ عَلَيْهِمُ الشَّيْطَانُ فَأَنسَاهُمْ ذِكْرَ اللَّهِ أُولَئِكَ حِزْبُ الشَّيْطَانِ أَلَا
إِنَّ حِزْبَ الشَّيْطَانِ هُمُ الْخَاسِرُونَ { 19 }

“Ata i ka nënshtruar shejtani dhe ua ka qitur në harresë porositë e Allahut. Ata janë shoqëri e shejtanit. Vërtetë ihtarët e shejtanit janë më të dëshpëruarit.”

(S. El-Muxhadele: 19)

Partia-shoqëria e djajve është ajo që tenton ta përhapë ateizmin dhe lufton të vërteten, qëndron para librave qiellorë dhe i pengon njerëzit të mos i marrin-kuptojnë ata... debati i tyre vazhdon gjer në shpërthim të konfliktit të armatosur, siç thotë Allahu i madhëruar:

الَّذِينَ آمَنُوا يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ وَالَّذِينَ كَفَرُوا يُقَاتِلُونَ فِي سَبِيلِ
الطَّاغُوتِ

“Ata që besuan luftojnë në rrugën e Allahut, e ata që nuk besuan luftojnë në rrugën e djallit”

(S.En-nisa: 76)

Ka djaj nga radhët e xhindëve dhe njerëzve. Djajtë e njerëzve janë ata që e kanë shejtanin shok, dmth. njeriu i tillë është i mishëruar me ta. Kur shejtani është afër njeriut dhe qëndron gjithnjë me të, atëherë njeriu arrin në vllugun e mëkateve, ngase gjersa shejtani është ngushtë i lidhur me një person, ai kurrë nuk e cytë njeriun të bëjë vepra të mira, por gjithmonë e nxit të bëjë keq, ngase ai është shok i ngushtë i së keqes.

Në këtë mënyrë, shokët e ngushtë të së keqes ndihmohen mes vete; i japin kurajë njëri-tjetrit për të bërë mëkat, vërehen kur të bashkohen në mëkat... Ata çdo natë takohen në shtëpinë e ndonjërit, më vete marrin alkool, femra dhe bëjnë aso vepra, të cilat e hidhërojnë Allahun . Në këtë botë ata janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrit për të bërë mëkate. Por në botën e ardhshme ndryshon gjendja. Ata do të jenë armiq të njëri-tjetrit.

Allahu i madhëruar na ka shpjeguar se çka do t'i bëjë shejtani shokut të vet. Ai në Kur'anin fisnik thotë:

وَأَصْلَنَّهُمْ وَلَا مَنِيْنَهُمْ وَلَا مَرْئُهُمْ فَلْيَبِيْنَنَّ أَذَانَ الْأَنْعَامِ وَلَا مَرْئَهُمْ
فَلْيَعْبِرَنَّ خُلُقَ اللَّهِ وَمَنْ يَتَّبِعِ الشَّيْطَانَ وَلِيًّا مِّنْ دُونِ اللَّهِ فَقَدْ خَسِرَ
خُسْرَانًا مُّبِينًا {119}

“Do t’i shpjerë në rrugë të shtrembër, do të ndjellë në ta shpresa të kota dhe do t’i urdhëroj t’ua presin veshët kafshëve. Si dhe do t’i urdhërojë t’i shëmtojnë krijesat Allahut. E kush e merr djallin për mbrojtës e jo Allahun, ai ka pësuar humbje të mëdha”.

(S. En-nisa’: 119)

Kështu do të veprojnë shejtani me shokët e tij. Ai së pari i humb, dmth. i largon nga rruga e drejtë dhe ua prish këtë planprogram. Shejtanët përgjonin në qiell fjalët që dëgjonin për rrugën e Allahut, para zbritjes së Kur’anit. Kur ndonjëri prej tyre mësonte diç për ta shpejtonte te shokët e tyre prijatarë dhe magjistarë etj. Dhe lajmëronin në mënyrë devijuese se ç’kishte dëgjuar nga programi i Allahut, pasi i shtonin atij atë që i largonte (i çonte në rrugë të gabuar). Ata fshinin çdo gjë që e udhëzonte njeriun. Më pas priftërinjtë me rolin e tyre u shtonin atyre udhëzimeve fjalë me të cilat ata bëheshin mbizotërues në këtë botë duke thënë se ata janë të dërguar të Allahut, e në realitet ata nuk ishin të dërguar të Allahut... në mënyrë që t’i shfrenojë me to në tokë dhe t’i largojnë njerëzit nga rruga e drejtë...

Në këtë mënyrë janë shtrembëruar librat qiellorë dhe u është shtuar ajo që Allahu nuk e ka thënë, as s’e ka zbritur duke shlyer dhe fshehur atë që e ka urdhëruar Allahu. Por ata mundën t’ia arrijnë qëllimit. Kur zbriti Kur’ani fisnik, djajve iu ndalua të përgojnë atë dhe Allahu e ruajtë Kur’anin prej çdo lloj ndryshimi dhe shtrembërimit. Ky është çorientim i djallit.

Sa i përket fjalës së shejtanit “*le-umnijen-nehum*”-do të ndjell *shpresa të kota*”, shejtani ia hijeshon njeriut mëkatet, të cilat ai dëshiron t’i bëjë. Ai ia pasqyron ato jo si mëkate, por si vepra të mira.

Sa i përket çështjes së shtazëve dhe shëmtimit të krijesave të Allahut, themi se e tërë ajo që e ka krijuar Allahu i madhëruar është e përsosur. Çdo gjë që e ka krijuar Allahu ka një rol të vetin në këtë botë. Ajo është krijuar në mënyrë të thjeshtë që ta plotësojë... Ndërrimi i asaj krijese është prishje e këtij roli.

Ata që ua shpojnë veshët kafshëve duke menduar t’i përdorin për idhuj të tyre, e kanë larguar krijesën e Allahut nga roli i saj. Begatia është pasuri e krijuar për shërbim të njeriut. Ai e shfrytëzon atë për të bartur gjësendet e veta, han mishin e tyre, merr leshin e tyre etj., por ato nuk mund të shërbejnë fare si idhuj. Shejtani dëshironte t’i largojë ato nga ai qëllim për të cilin janë krijuar dhe kërkon ndihmën për atë qëllim nga shokët e tij.

Por ai ka ardhur që ta shkatërrojë këtë mision pa bërë gjë, gjithashtu nga të gjitha provat që bëhen del njeriu i shëmtuar, të thuash i shkatërruar, krijesa e Allahut... Sa u përket keqpërdorimeve, të cilat bëhen me qëllim

të dominimit në..., këto shkatërrojnë misionin e njeriut që ka në këtë botë.

Allahu i madhëruar duke vënë në dukje marrëzitë që mund t’i bëjë djalli, na njofton se djalli shfrytëzon si armë të veten frikën e njeriut për ta larguar atë nga rruga e drejtë. Allahu xh.sh. në Kur’anin fisnik thotë:

إِنَّمَا ذَلِكُمُ الشَّيْطَانُ يُخَوِّفُ أَوْلِيَاءَهُ فَلَا تَخَافُوهُمْ وَخَافُوا إِن

كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ {175}

“Po, djalli dëshiron t’jua ndjellë frikën me ihtarët e vet, por ju mos ju frikoni atyre, por Mua nëse jeni besimtarë”.

(S.Ali Imran: 175)

A thua si mund të dominojë shejtani në njeriun me atë të frikës?

Kur njeriu i beson frikës që ia ndjellë shejtani atij në varfëri... kur njeriu do të thotë të vërtetën, shejtani e frikëson atë duke i thënë se do ta shkatërrojë atë prijësit e tij zullumqarë.

Kur njeriu do të falë namazin, shejtani e frikëson duke i thënë se do të humbasë kështu e kështu nga të mirat e jetës. Kur ai zë të luftojë në rrugën e Allahut, shejtani e bën të frikësohet nga fuqia e

jobesimtarëve dhe ia fut frikën në palcë se do të vritet kur të fillojë beteja. Kur njeriu shpejton të bëjë ndonjë të mirë, djalli e frikëson se nëse vepron ashtu do të humbasë kohën dhe interesat e tij. Kur njeriu dëshiron të ndalet nga ndonjë veprim i keq, djalli e frikëson se duke vepruar ashtu, ai veprim do t'i sjellë dëme (telashe).

Në këtë mënyrë çdo e mirë që njeriut i shkon mendja ta bëjë shejtani e frikëson që të mos e bëjë se po të veprojë ashtu do t'i shkaktohen dëme... mallit apo qenies së tij, fëmijëve të tij, aty në vend të punës apo në tregti të tij, apo në njërën nga çështjet vitale të tij. Me këtë frikë djalli ndjell në shpirtin e njeriut trishtimin që të largohet nga të mirat.

Megjithatë, para se ta përfundojmë këtë vepër, medoemos duhet të ndalemi e t'i shtjellojmë me kujdes ca aspekte mbi të dërguarit “*nebij*” dhe të dërguarit “*resul*” dhe mbi shejtanin. Ekzistojnë dispozita të përgjithshme dhe të posaçme për numrin e të Dërguarve “*nebij*” dhe “*resul*” të Allahut. Dispozita e përgjithshme e tyre është fjala e Allahut e Madhëruar:

أَلْقَى الشَّيْطَانُ فِي أُمْنِيَّتِهِ فَيَنْسَخُ اللَّهُ وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ قَبْلِكَ مِنْ رَسُولٍ وَلَا نَبِيٍّ إِلَّا إِذَا تَمَنَّى مَا يُلْقِي الشَّيْطَانُ ثُمَّ يُحْكِمُ اللَّهُ آيَاتِهِ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ
{52}

لِيَجْعَلَ مَا يُلْقِي الشَّيْطَانُ فِتْنَةً لِلَّذِينَ لِلَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ مَرَضٌ وَالْقَاسِيَةِ قُلُوبُهُمْ وَإِنَّ الظَّالِمِينَ لَفِي شِقَاقٍ بَعِيدٍ
{53}

“Ne nuk çuam para teje asnjë Pejgamber e as të Dërguar që kur dëshironte diç (i dërguari) që shejtanit të mos i propozonte (të kundërtën). Allahu mënjanonte atë që e fuste shejtani dhe fuqizonte argumentet e Veta. Allahu është i gjithëdijshëm dhe i urtë, që të bëjë sprovë atë që e hedh shejtani, për atë zemrat e të cilëve janë të sëmura dhe për atë zemrat e të cilëve janë mizore, jobesimtarët janë fare larg nga e vërteta”.

(S.El-Haxh: 52,53)

Çfarë është dëshira e çdo të dërguari?

Dëshira e çdo të dërguari është që ai ta përhap misionin e tij, t'i besojnë njerëzit, të arrijë sukses në përmasimin e kushteve të jetës, t'i tërheqë në besim dhe ata ta lënë (kufrin). Këto janë dëshirat e të

Dërguarit. Por a thua i lë shejtani njerëzit të qetë që t'i dëgjojnë të dërguarit dhe t'u besojnë mesazheve të tyre?

Jo, se ai i pengon ata nga rruga e Allahut. Ai vepron ashtu duke filluar me ata dashamirët e luksit, të cilëve do t'u priset planprogrami i tyre për të arritur rezultate të dëshiruara në jetën e kësaj bote. Ai i bën njerëzit e tillë zëdhënës të tij, të cilët fillojnë t'u bëjnë rezistencë misioneve profetike... vënë pengesa dhe i ndëshkojnë ata që besojnë gjersa t'i detyrojnë të mos besojnë. Ata myslimanë iu nënshtrihen fyerjeve e maltretimeve (të ndryshme).

Por a thua i del përgënjeshtuesi të jetë fitues?

Jo, se Allahu i madhëruar asgjëson çdo gjë që tenton ta bëjë shejtani dhe të Dërguarit të Vet ia përcakton fitoren, thirrja në besimin e drejtë (d'ave-ja) arrin sukses, shtohet numri i besimtarëve. Ky është kuptimi i ajetit kur'anor. Pra i Dërguari dëshiron të arrijë sukses në misionin e vet, por shejtani i nxit mëkatarët dhe jobesimtarët kundër të dërguarit e beteja përfundon me fitoren e të Dërguarit ndaj shejtanit.

Fjalët e shejtanit janë cekur në shumë ajete kur'anore, p.sh. në fjalët e Ejubit a.s.

أَنِّي مَسَّنِيَ الشَّيْطَانُ بِنُصْبٍ وَعَذَابٍ .

“...Djalli më ka goditur me mundime dhe vuajtje”.

(S.Sad: 41)

Fjalët e Jusufit a.s.

“...Pasi shejtani pat futur përçarje mes meje dhe vëllezërve të mi”

Dhe fjalët e Allahut të Madhëruar:

فَأَنسَاهُ الشَّيْطَانُ ذِكْرَ رَبِّهِ فَلَبِثَ فِي السِّجْنِ بِضْعَ سِنِينَ

“ ... Dhe shejtani e bëri të harrojë që t'ia përmendë zotëriut të tij, (Jusufi) qëndroi në burg edhe disa vite”.

(S.Jusuf: 42)

Pastaj në fjalën si vijon:

وَمَا أَنسَانِيهِ إِلَّا الشَّيْطَانُ أَنْ أَذْكُرَهُ

“Askush pos djallit nuk më ka bërë ta harrojë atë”.

(S.El-Kehf: 63)

Më pas gjithashtu edhe fjalën e Musait kur e grushtoi njeriun dhe e mbyti:

هَذَا مِنْ عَمَلِ الشَّيْطَانِ إِنَّهُ عَدُوٌّ مُضِلٌّ مُبِينٌ

“Ai tha: kjo është vepër e shejtanit, se ai është armik që të bën të humbur haptazi”

(S.El-kasas: 15)

Këto ajete kur'anore për shembull... kur te themi se qenia e të dërguarve “*nebij*” është e natyrës që nuk bëjnë mëkate – janë të mbrojtur, por kjo nuk do të thotë se ata e kanë të ndaluar të luftojnë nefsën (emocionet). Megjithatë atyre patjetër duhet t’u mbetet një gjë, të cilën çdonjëri prej tyre duhet ta luftojë. Edhe i Dërguari ka shpirt njeriu, në të lindin konflikte-kundërrthënie dhe shfaqen epshe, por ato ai i mund duke luftuar kundër emocioneve të veta. Përndryshe, po të mos ballafaqoheshin shpirtrat e të dërguarve me gjëra-aspekte të tilla për t’i luftuar, atëherë ata do të ishin engjëj.

Allahu i madhëruar i ka krijuar ata njerëz që të jenë shembuj për besimtarë se si duhet luftuar shejtanin, emocionet dhe si t’i mposhtin ato. Për këtë arsye disa të dërguar “*enbija*” janë quajtur njerëz të vendosur. Fjala “*azm*” këtu nënkuptohet, si vendosmëri në zbatimin e urdhrave të Allahut dhe në luftimin e shejtanit.

ALLAHU UA PËRCAKTOI TË DËRGUIARVE FITOREN

Sa i përket Musait a.s., kur ai e rrahu njeriun dhe e mbyti, atëherë kur ende nuk kishte angazhuar me misionin profetik, por që atëherë kishte besim dhe i druante Allahut, atij iu tërhoq vërejtja se ajo që e kishte bërë është vepër e shejtanit. Musai iu drejtua Allahut të madhëruar duke kërkuar prej Tij ta falë dhe t’ia pranojë pendimin. Ai i tha:

“Atë e bëri shejtani ta harrojë Zotin e vet”.

Kjo do të thotë se shejtani tentoi ta bëjë vesvese e shejtanit, por Musai iu tërhoq vërejtja dhe ai u lirua nga vesvesja e shejtanit.

Sa i përket Jusufit a.s. Allahu i madhëruar thotë:

“... Dhe shejtani e bëri të harrojë që t’ia përmendë zotëriut të tij...”

kjo ka dy kuptime:

a) Aludon në atë se njeriu që doli nga burgu kur shejtani e bëri atë të harrojë që t’ia përmend çështjen e Jusufit mbretit të Egjiptit, kur te Jusufi qëndroi disa vite të tjera.

b) Apo mund të jetë Jusufi ai që kishte harruar...

Por kuptimi i vërtetë i kësaj thënie kur’anore është se shejtani ishte ai që e kishte bërë njeriun që doli prej burgu t’ia përkujtojë Azizit të Egjiptit rastin e Jusufit dhe të kërkojë nga ai ta lirojë atë nga burgu. Mu për këtë arsye Jusufi mbeti në burg edhe disa vite tjera.

Këtë fakt e vërteton fjala e Jusufit drejtuar njeriut të liruar nga burgu: *“Përmende rastin tim zotëriut tënd”*... respektivisht mbretit te i cili do të shkosh dhe thuaj se është një njeri që qëndron në burg e është i pafajshëm dhe i trego se e ka punën kështu”. Nga kjo fjalë mësojmë se ajeti kur’anor nuk lë të kuptohet se shejtani e bëri Jusufin të harrojë të përmendë Allahun e madhëruar.

Sa i përket fjalës së Ejubit a.s.: *“Shejtani më ka goditur me mundime e vuajtje”*-Ejubi i ankohej Zotit se shejtani i bënte vesvese dhe i thoshte: Si

ashtu, ti duke qenë i Dërguar i Allahut *“nebi”* të të kaplojnë këto mundime? Si të sëmuresh e të të ndodhë kjo ty, të humbën bijtë, gruaja jote bëri mëkat etj. A nuk do të duhej që Allahu i madhëruar të nderojë ty se ti je i Dërguar dhe t’i heq të gjitha këto (mundime)?” Por Ejubi a.s. të cilin e kishte lodhur dhe rënduar fjala e shejtanit, nuk ia tërhoqi vëmendjen, por iu drejtua Allahut të madhëruar më tutje duke kërkuar t’ia heqë ato vuajtje. Allahu iu përgjigj lutjes së tij.

Nga ky rast vërejmë se Iblisi tentonte t’u afrohej të të dërguarve të allahut. Ai mori pjesë në komplotin përgatitur kur u tentua të vritet Muahmedi a.s. ditën e shpërnguljes (hixhretit). Por Allahu xh.sh. i ka mbrojtur të dërguarit e Vet *“nebi”* dhe *“resul”* nga shejtani.

Të citojmë një hadith të Muhamedit a.s. ku thotë:

“Shejtani qarkullon në trupin e njeriut mu si gjaku”. Por disa orientalistë tentojnë ta trajtojnë këtë hadith si të dyshimtë. Personat e tillë ë orvaten të gjejnë plasaritje dhe përmes tyre hedhin helmin e tyre, gjë që s’ka të ngjarë, ngase në gjak ka substanca të shumta, siç janë hekuri: fosfati, kalciumi e substanca të tjera që janë konstatuar në saje të analizave bashkëkohore. Por ai (gjaku) mes tjerash përmban mikrobe e viruse,e të cilat janë elemente që shihen, shqyejnë lëkurën

dhe hyjnë në gjak. Ato qëndrojnë në të gjera të shumohen, e mes tyre dhe leukociteve zhvillohet luftë... E, dihet mirëfilli se shejtani nuk është krijuar nga materia (lënda e argjilat-dheut), por është i krijuar nga një materie tejet transparente (tejudkshme), e cila është tejet e bukur dhe e rrallë. Pra si mund ta konsiderojmë të tepërt tezën sipas së cilës lëkura shqyhet dhe shejtani hyn e qarkullon në gjak siç qarkullojnë dhjetëra substanca të lëngëta e ne mos ta hetojmë fare.

Lus Allahun që të na mbrojë nga shkarjet e gojës që të mos e trasojë shejtani përmes tyre rrugën në zemrat tona.

Përmbajtja

MENDIMI I RECENSENTIT	4
<i>Kapitulli i parë</i>	5
KUSH ËSHTË SHEJTANI	5
PËRSHKRIMI I SHEJTANIT	7
ZANAFILLA E MËKATIT	10
E VËRTETA MBI IBLISIN	12
NUK KA PËRPARËSI ELEMENTI NDAJ ELEMENTIT	14
RËNIA E IBLISIT NË NGASJE (Të larguarit e Iblisit nga mëshira e Allahut).....	16
<i>Kapitulli i dytë</i>	18
MËKATI I SHEJTANIT	18
MENDJEMADHËSIA E DJALLIT NDAJ ALLAHUT	20
KJO BOTË ËSHTË VEND SPROVIMI.....	23
TË PENGUARIT E NJERIUT PËR TA FALUR NAMAZIN	25
<i>Kapitulli i tretë</i>	31
ADEMI DHE SHEJTANI	31
AI NUK ËSHTË XHENET I PËRHERSHËM	33
PROGRAMET E PARA HYJNORE	36
SI BËNË ADEMI DHE HAVA MËKAT	39
SI U SHFAQ AVRETI (VENDTURPI I NJERIUT)	41
<i>Kapitulli i katërt</i>	45
MËKATI I ADEMIT DHE MËKATI I IBLISIT	45
LUFTA MES NJERIUT DHE SHEJTANIT GJATË JETËS SË TYRE NË KËTË BOTË.....	51

Kapitulli i pestë..... 58

SHTIGJET E SHEJTANIT... KAH NJERIU (MËNYRAT SE SI SHEJTANI I AFROHET NJERIUT)	58
DALLIMI MES DY VESVESEVE	60
HULUMTIMI I PIKËS SË DOBËT	62
VESVESJA E SHEJTANIT NË NAMAZ	63
MBIZOTËRIMI I ELEMENTIT DJALLËZOR	67
INTEGRIMI NUK ËSHTË PËRSËRITJE.....	69

Kapitulli i gjashtë 72

SHEJTANI DHE USHTRIA E TIJ	72
ORVATJET E SHEJTANIT NË LUFTËN BEDRIT	74
NUK DO TË PASOJË DËNIMI PËR GJËRAT E IMONUARA	76
ALLAHU UA PËRCAKTOI TË DËRGUARVE FITOREN.....	83

Muhamed Mutevel-li Esh-sha' ravi
SHEJTANI DHE NJERIU

Përkthyen: *Arif Emini dhe Burhan Hashani*

Botuesi : *Arif Emini*

Të drejtat e këtij përkthimi u takojnë përkthyesve
Arif Emini dhe Burhan Hashani

PËRKTHYES I PËRHERSHËM GJYQËSOR
PËR GJUHËN ANGLEZE, ARABE DHE GJERMANE
Arif Emini
prof. i orientalistikës
Rr. "MURAT MEHMETI" nr. 11, tel . 044-185 968
Lagja „Tophane“, te shitorja “KONI”, Prishtinë
Email: arifii@hotmail.com